

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Komuniteteve**

**Raport i vlerësimit i të drejtave të komuniteteve**

Dhjetor 2009

# PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	6
1. PARATHËNIE.....	7
2. MJETET JURIDIKE DHE ZBATIMI I LIGJIT.....	9
2.1. Mbledhja e të dhënave për hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve me bazë etnike.....	9
2.2. Mosndëshkimi, ndjekja penale e krimeve me motive etnike dhe raportimi i manifestimeve ditore të jo tolerancës .....	11
2.3. Përfaqësimi dhe rekrutimi në gjykata i personave që u takojnë komuniteteve jo-shumicë .....	13
2.4. Shndërrimi i institucionit të Ombudspersonit në institucion vendor .....	14
3. PROCESI I KTHIMIT DHE SIGURIA .....	15
3.1. Krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm, siguri, ri-posedim të pronës dhe për aktivitete që krijojnë të ardhura.....	15
3.2. Skemat e asistencës për kthimin dhe zgjedhja e lirë e vendit të banimit.....	18
3.3. Integrimi i personave të riatdhesuar .....	19
3.4. Masat për adresim të situatës shëndetësore të romëve në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën veriore .....	20
4. ÇËSHTJET E KULTURËS DHE MEDIAS.....	21
4.1. Mbrojtja dhe rindërtimi i trashëgimisë kulturore: masat e ndarjes së zonave; përfshirja në listën e trashëgimisë kulturore .....	21
4.2. Përkrahja për kulturat e komuniteteve numerikisht më të vogla.....	24
4.3. Kapacitetet dhe masat për të mbështetur transmetimet për dhe nga komunitetet jo-shumicë.....	25
5. PËRDORIMI I GJUHËVE .....	28
5.1. Miratimi, monitorimi dhe implementimi i legjislacionit .....	28
5.2. Përdorimi i gjuhëve jo-shumicë në vendet publike .....	31
6. EDUKIMI .....	33
6.1. Mundësitë për bashkëveprim ndërmjet fëmijëve të komuniteteve shqiptare dhe serbe dhe për eliminim të barrierave linguistike .....	33

6.2. Masat për akomodim të shqetësimeve rreth edukimit të personave që u takojnë komuniteteve jo-shumicë .....	34
6.3. Transporti për fëmijët që u takojnë komuniteteve jo-shumicë.....	35
6.4. Sigurimi i planeve mësimore, teksteve shkollore dhe mësuesve të kualifikuar për komunitetet numerikisht të vogla .....	36
6.5. Masat për përmirësim të qasjes në arsim dhe për kompletim të arsimimit nga fëmijët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane .....	39
6.6. Masat për të siguruar qasje në arsim për komunitetin goran .....	40
7. Pjesëmarrja.....	41
7.1. Regjistrimi i popullsisë dhe pjesëmarrja e komuniteteve jo-shumicë .....	41
7.2. Të dhënat personale në lidhje me përkatësinë në një komunitet .....	42
7.3. Pjesëmarrja e komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës.....	43
7.4. Dialogu ndërmjet Ministrive dhe Komitetit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve në Kuvendin e Kosovës .....	45
7.5. Mekanizmat për pjesëmarrje të komunitetit.....	46
7.6. Pjesëmarrja efektive në jetën ekonomike e sociale .....	48
8. KONKLuzionet.....	52
9. REKOMANDIMET .....	53
ANEKSI 1. Përbërja etnike e Kosovës.....	56

## **LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE**

**Opinion i Komitetit Këshillëdhënës:** Komiteti këshillëdhënës për Konventën kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale, Opinion i për implementim të Konventës kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale në Kosovë

**Komiteti:** Komiteti për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe të kthyerve

**Rekomandimi i Këshillit të Evropës:** Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me implementimin e Konventës kornizë në Kosovë

**Këshilli Konsultativ:** Këshilli Konsultativ për komunitetet

**EULEX:** Misioni i Bashkimit Evropian për sundim të ligjit

**Konventa kornizë:** Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve nacionale

**KKBP:** Komisioni për kërkesa banesore dhe pronësore

**DÇBP:** Drejtoria për çështje pronësore dhe banesore

**KMI:** Këshilli për monitorim të implementimit

**ONM:** Operacioni ndërkombëtar për monitorim

**Komisioni i pavarur:** Komisioni i pavarur për shqyrtim të materialeve mësimore në gjuhën serbe

**Instituti:** Instituti i Kosovës për mbrojtje të monumenteve

**KKTK:** Këshilli i Kosovës për trashëgiminë kulturore

**AKP:** Agjencia Kosovare e Pronës

**AKM:** Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

**Komisioni për Media:** Komisioni i pavarur i mediave të Kosovës

**MMPH:** Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

**MASHT:** Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

**Ministria e Kulturës:** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

**OSBE:** Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni në Kosovë

**APK:** Agjencia e Kosovës për privatizim

**KKKP:** Komisioni i Kosovës për kërkesat pronësore

**IPVQ:** Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes

**Këshilli i shtypit:** Këshilli i shtypit të Kosovës

**Komisioni për rindërtim:** Komisioni për implementim të rindërtimit për objektet religjioze ortodokse serbe

**RTK:** Radio Televizioni i Kosovës

**KOS:** Kisha Ortodokse Serbe

**NPSH-të:** Ndërmarrjet në pronësi shoqërore

**PSSP:** Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së

**Enti Statistikor:** Enti statistikor i Kosovës

**UNHCR:** Komisionari i lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatë

**UNMIK:** Misioni i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

**UNDP:** Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara

**OBSH:** Organizata Botërore e Shëndetësisë

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport fokusohet në progresin e bërë nga institucionet e Kosovës në implementimin e standardeve specifike të Konventës kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve nacionale<sup>1</sup> (Konventa Kornizë) në periudhën janar 2008 – qershor 2009.<sup>2</sup> Raporti bazohet në hulumtimet në terren të zhvilluara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) përmes intervistave me zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal, me komunitetet dhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Raporti gjen që ndonëse është krijuar një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për të siguruar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, implementimi i saj mbetet i pamjaftueshëm apo nuk sjell ndryshime pozitive të mjaftueshme në jetën e përditshme të komuniteteve jo-shumicë.<sup>3</sup> Marrëdhëniet e vështira dhe ndarja ekzistuese ndërmjet komunitetit shqiptar të Kosovës dhe komunitetit serb të Kosovës paraqesin një sfidë thelbësore për zhvillimin e një shoqërie shumë-etnike. Megjithatë, raporti identifikon gjithashtu pengesa të tjera dhe përshkruan fushat ku intervenimi mund të jetë i nevojshëm. Në mënyrë specifike, në sistemet e sigurisë dhe të gjyqësisë, të metat kryesore kanë të bëjnë me mangësitë në klasifikimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve me motive etnike pasi që ndjenja e mosndëshkimit në mesin e komuniteteve jo-shumicë nuk i kontribuon ndërtimit të besimit drejt institucioneve. Në çështjet e kthimit, mungesa e kushteve të duhura për kthim të qëndrueshëm është ende e evidente, veçmas sa i përket kthimit të pronës, rindërtimit dhe integritetit ekonomik. Implementimi i politikave ekzistuese përmes fondeve adekuate dhe masave për akomodim të nevojave të një numri në rritje të personave të riatdhesuar mbetet një sfidë e madhe për autoritetet lokale. Nevojiten më shumë përpjekje dhe resurse për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat kulturore të komuniteteve. Bashkë me përmirësimin e shërbimeve dhe përfaqësimin e komuniteteve në shërbimin e transmetuesit publik, nevojiten hapa të mëtejshme për të siguruar pajtueshmërinë me dispozitat ligjore për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Zvogëlimi shqetësues i resurseve njerëzore dhe financiare të alokuara, vë në rrezik implementimin e Ligjit për përdorim të gjuhëve<sup>4</sup> dhe sigurimin efektiv dhe qasjen në shërbimet publike shumë-gjuhësore. Duhet të rritet pavarësia dhe kapaciteti operacional i Komisionit për Gjuhët, për të monitoruar zbatimin e ligjit dhe për të siguruar ndreqjet në rast të shkeljeve. Ekzistenca e vazhdueshme e sistemeve arsimore të ndara frenon dialogun dhe integrimin ndërmjet komuniteteve shqiptare dhe serbe të Kosovës. Kjo nënvizon urgjencën e reformave arsimore dhe të masave që promovojnë shoqërinë shumë-etnike dhe shumë-gjuhësore. Promovimi i edukimit në të dy gjuhët zyrtare dhe largimi i barrierave linguistike dhe fizike që ndajnë fëmijët të cilët u takojnë komuniteteve të ndryshme mbetet çështje me prioritet. Veç kësaj, duhen

<sup>1</sup> Këshilli i Evropës, Konventa kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale (Konventa kornizë), Strasburg, 1 shkurt 1995, Këshilli i Evropës, Seria e Traktateve, N. 157.

<sup>2</sup> Janë përfshirë disa azhurnime dhe u referohen ngjarjeve që kanë ndodhur pas periudhës së raportimit.

<sup>3</sup> Për qëllimet e këtij raporti, komunitete jo-shumicë janë të gjitha ato komunitete që përbëjnë minoritetet numerik në nivel komunal në Kosovë.

<sup>4</sup> Ligji për përdorimin e gjuhëve, i nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/51 (Ligji për gjuhët), 20 tetor 2006.

miratuar masa të përshtatshme dhe duhen alokuar resurse për adresim të shqetësimeve kryesore rreth edukimit tek komunitetet tjera të cenueshme jo-shumicë, me fokus specifik në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.

Raporti gjen gjithashtu që funksionimi dhe koordinimi i mekanizmave për pjesëmarrje të komuniteteve kërkon përmirësime dhe përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike, veçmas në nivelet e larta duhet të rritet. Zgjerimi dhe implementimi i politikave efektive për integrim të komuniteteve jo-shumicë në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike, si dhe në çështjet publike, është me rëndësi jetike për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe shumë-etnike.

## 1. PARATHËNIE

Në vitin 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar një trup kompleks të legjislacionit që ka të bëjë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve jo-shumicë,<sup>5</sup> që bazohen në Kushtetutën e miratuar nga Kuvendi në po të njëjtën periudhë.<sup>6</sup> Ndërkohë, Misioni i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) ka rikonfiguruar praninë e tij dhe ka bërë reduktimin e stafit nga 5,000 në rreth 500. Në dhjetor të vitit 2008, ka zbankuar Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit (EULEX)<sup>7</sup>, ndërsa KFOR-i, si forcë paqeruajtëse e drejtuar nga NATO, ka mbetur në Kosovë dhe ka vazhduar me ushtrimin e mandatit të tij.

Korniza ligjore në Kosovë definon komunitetet si grupe nacionale, etnike, kulturore, linguistike apo religjioze që janë tradicionalisht të pranishme në Kosovë dhe që nuk janë shumicë, dhe njeh të drejtat specifike për personat që u takojnë atyre komuniteteve.<sup>8</sup> Komunitetet e serbëve të Kosovës, turqve të Kosovës, boshnjakëve të Kosovës, romëve, ashkalive, egjiptianëve dhe të goranëve, janë të njohura në mënyrë eksplicite. Komunitetet tjera (sikur që janë kroatët e Kosovës dhe malazezët e Kosovës) dhe pjesëtarët e një komuniteti në shumicë në Kosovë si tërësi, që nuk janë pjesë e shumicës në një komunë të caktuar (sikur që janë shqiptarët e Kosovës në Mitrovicën e Veriut/Mitrovica, Leposaviq/Leposavić, Zubin Potok, Zvečan/Zvečan, Shtërpçë/Štrpce apo në Mamushë/Mamuša/Mamuša) kanë të drejtë gjithashtu të gëzojnë të drejtat e përmendura në ligj.<sup>9</sup> Legjislacioni për anti-diskriminimin, për përdorimin e gjuhëve, për edukimin, për pjesëmarrjen e garantuar në komuniteteve në çështjet publike, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të lirisë fetare është në

<sup>5</sup> Më 15 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë (ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve), Ligjin për vetëqeverisjen lokale (ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale), Ligjin për kufijtë administrativ të komunave (ligji i zbatueshëm për kufijtë e komunave), Ligji për festat zyrtare në Kosovë (ligji i zbatueshëm për festat zyrtare), Ligjin për edukimin në komunat e Kosovës (ligji i zbatueshëm për edukimin në komuna), dhe Ligjin për zonat speciale të mbrojtura (ligji i zbatueshëm për zonat speciale të mbrojtura).

<sup>6</sup> Më 15 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Kushtetutën (Kushtetuta).

<sup>7</sup> Brenda kuadrit të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së dhe nën autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, EULEX-i ka nisur operacionet e tij më 9 dhjetor 2008. Ai ndihmon dhe mbështet institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, në mënyrë specifike sa i përket policisë, gjyqësisë dhe doganave.

<sup>8</sup> Neni 4 (1), Korniza Kushtetuese, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, 15 maj 2001, dhe amendamentet pasuese; Neni 57(1), Kushtetuta Neni 1(4), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

<sup>9</sup> Neni 1(4), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

fuqi<sup>10</sup> dhe Konventa kornizë si dhe traktatet tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut janë të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë.<sup>11</sup>

Së këndejmi, pas marrëveshjes me Këshillin e Evropës,<sup>12</sup> më 2 qershor 2005, UNMIK-u ka dorëzuar raportin e parë zyrtar për implementim të Konventës kornizë në Kosovë.<sup>13</sup> Në gusht të vitit 2005, Këshilli i Evropës ka pranuar gjithashtu një raport shtesë të përgatitur nga përfaqësuesit e komuniteteve të Kosovës.<sup>14</sup> Më 25 nëntor 2005, Komiteti Këshillëdhënës ka lëshuar një Opinion,<sup>15</sup> dhe më 21 qershor 2006, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka mbështetur Rezolutën për implementim të Konventës kornizë në Kosovë.<sup>16</sup> UNMIK-u ka dorëzuar raportin e progresit më 21 korrik 2008.<sup>17</sup>

Monitorimi, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut paraqesin thelbin e mandatit të OSBE-së. Rrjedhimisht, OSBE mbështet vazhdimisht implementimin e Konventës kornizë dhe kontribuon në raportin e progresit të UNMIK-ut. Veç kësaj, OSBE ka sponsoruar gjithashtu një projekt që i ka mundësuar një paneli të përfaqësuesve të komuniteteve jo-shumicë të Kosovës dorëzimin e një raporti jozyrtar në lidhje me Konventën kornizë në vitin 2005. Më tej, në mes viteve 1999 dhe 2002, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionarit të lartë të OKB-së për Refugjatë, OSBE ka

---

<sup>10</sup> Ligji për anti-diskriminimin i nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32, 20 gusht 2004; Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2002/19, 31 tetor 2002; Ligji për arsimin e lartë në Kosovë i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2003/14, 12 maj 2003; Kapitujt 9.1(3), 9.1(12), 9.1(17) dhe 9.3(5), Korniza Kushtetuese; neni 64(2), 65(2), 96 (3) deri (5); Ligji për trashëgiminë kulturore i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2006/52, 6 nëntor 2006; Ligji për lirinë e religjionit në Kosovë i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2006/48, 24 gusht 2006.

<sup>11</sup> Deklarata Universale për të drejtat e njeriut, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, Konventa kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale, Konventa për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Konventa për të drejtat e fëmijës, Konventa kundër torturës dhe trajtimit tjetër jonjerëzor dhe ndëshkimeve, Karta Evropiane për gjuhët rajonale apo minoritare dhe Karta Evropiane për qeverisjen lokale dhe vetëqeverisjen. Neni 22 dhe 58(2) dhe 123, kushtetuta. Megjithatë, ka shqetësime për faktin që Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore nuk njihet si e zbatueshme.

<sup>12</sup> Marrëveshja ndërmjet Misionit të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Këshillit të Evropës për aranzhimet teknike në lidhje me Konventën kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale, 23 gusht 2004.

<sup>13</sup> Raport i dorëzuar nga UNMIK-u në përputhje me nenin 2.2 të marrëveshjes ndërmjet UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës në lidhje me Konventën kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale, pranuar më 2 qershor 2005.

<sup>14</sup> Raporti jozyrtar për implementimin e Konventës kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale në Kosovë, Prishtinë/Priştina, nëntor 2004 – gusht 2005. Raporti i përgatitur nga grupet punuese të komuniteteve, i koordinuar nga një konsulent i OSBE-së dhe me trajnim nga ekspertët e Këshillit të Evropës dhe të organizatës Minority Rights International.

<sup>15</sup> Komiteti Këshillëdhënës për Konventën kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale në Kosovë, Opinioni për implementim të Konventës kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale në Kosovë (Opinioni i Komitetit Këshillëdhënës), ACFC/OP/I(2005)004, Strasburg, 2 mars 2006.

<sup>16</sup> Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rezoluta ResCMN(2006) për implementim të Konventës kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale në Kosovë (Republika e Serbisë), Komiteti i Ministrave, takimi i 969-të i zëvendës ministrave, 21 qershor 2006, Strasburg.

<sup>17</sup> UNMIK, Raporti i progresit për implementimin e Konventës kornizë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale në Kosovë, dorëzuar nga Misioni i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (Raporti i progresit), pranuar më 21 korrik 2008, ACFC(2008)001. Raporti kryesisht mbulon zhvillimet deri në vitin 2007.



prodhuar dhjetë Raporte vlerësuese për situatën e minoriteteve etnike në Kosovë.<sup>18</sup> Në vitin 2008 dhe 2009, raportet e OSBE-së janë fokusuar në disa fusha relevante për implementim të Konventës kornizë, sikur që është zhvillimi dhe implementimi i politikave që kanë synim krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim, për përdorim të gjuhëve, për lirinë e lëvizjes, për arsim dhe për pjesëmarrje në jetën publike.<sup>19</sup>

Ky raport mbulon periudhën nga janari 2008 deri në qershor 2009. Bazohet në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me implementimin e Konventës kornizë në Kosovë (Rekomandimi i Këshillit të Evropës) në fushat e mjeteve juridike dhe zbatimit të ligjit, procesit të kthimit dhe sigurisë, kulturës dhe medias, përdorimit të gjuhëve, edukimit dhe pjesëmarrjes. Secili nënkapitull përmend rekomandimet relevante në një katror para fokusimit në kornizën normative dhe politikën, implementimin e saj dhe efektin në komunitetet jo-shumicë, dhe vlerëson progresin e arritur dhe sfidat e mbetura. Raporti përfshin konkluzionet dhe rekomandimet.

## 2. MJETET JURIDIKE DHE ZBATIMI I LIGJIT

### 2.1. Mbledhja e të dhënave për hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve me bazë etnike

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 5: Ngritja e sistemit permanent për mbledhje të të dhënave për hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve me bazë etnike.*

#### ***Korniza normative***

Ministria e Drejtësisë ka mandatin për të siguruar informata dhe statistika për sistemin e prokurorisë dhe shërbimin korrektues, dhe për të zhvilluar dhe implementuar politikën që sigurojnë qasjen e drejtë dhe efektive të anëtarëve të të gjitha

<sup>18</sup> Vlerësimi preliminar i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë UNHCR/OSBE, 26 korrik 1999; vlerësimi i dytë i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë, UNHCR/OSBE, 6 shtator 1999; përmbledhje e situatës së minoriteteve etnike në Kosovë, UNHCR/OSBE, 3 nëntor 1999; vlerësimi i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë (periudha që mbulon nëntorin 1999 deri në janar 2000), UNCHR/OSBE, 11 shkurt 2000; Azhurnim i UNHCR/OSBE për situatën e minoriteteve etnike në Kosovë (periudha që mbulon kohën prej shkurtit deri në maj 2000), UNHCR/OSBE 31 maj 2000; Vlerësimi i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë (periudha që mbulon kohën prej qershorit deri në shtator 2000), UNHCR/OSBE, 23 tetor 2000; Vlerësimi i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë (periudha që mbulon kohën prej tetorit 2000 deri në shkurt 2001), UNHCR/OSBE, 26 mars 2001; Vlerësimi i nëntë i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë (Periudha që mbulon kohën prej shtatorit 2001 deri në prill 2002), UNHCR/OSBE, prill 2002; Vlerësimi i dhjetë i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë (Periudha që mbulon kohën prej majit 2002 deri në dhjetor 2002), UNHCR/OSBE, mars 2003.

<sup>19</sup> Në vitin 2008 dhe 2009, Misioni ka publikuar këto raporte: 'Implementimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve nga komunat e Kosovës' (korrik 2008); 'Transportimi humanitar i minoriteteve me autobus' (I, II, III dhe IV gjatë viteve 2007-2008); 'Raport i sfondit: Kontaminimi me plumb në Mitrovicë/Mitrovica nga i cili preket komuniteti rom' (shkurt 2009); 'Komunitetet jo-shumicë të Kosovës në sistemet e arsimit fillor dhe të mesëm' (prill 2009); 'Profile të Komuniteteve të Kosovës' (korrik 2009); 'Implementimi i strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës' (nëntor 2009); 'Raport për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal' (nëntor 2009). Një komponentë përbajtësore për komunitetet dhe veçmas për arsimin, kujdesin shëndetësor, pjesëmarrjen dhe strukturat paralele, është përfshirë në raportin e Misionit për vitet 2007-2008 për 'Të drejtat e njeriut, raportet etnike dhe demokracinë në Kosovë.'

komuniteteve në sistemin e drejtësisë.<sup>20</sup> Policia e Kosovës ka politika specifike dhe definicione për klasifikimit e krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të urrejtjes.<sup>21</sup> Në gusht të vitit 2005, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) kishte përcaktuar kriteret dhe procedurat për raportim të incidenteve potencialisht me motive etnike,<sup>22</sup> sipas të cilave: viktima duhet ti takojë një komuniteti të cenueshëm; shkelësi duhet të jetë i panjohur apo ti takojë një komuniteti të ndryshëm nga ai i viktimës; dhe që rrethanat e veprës duhet të zbulojnë pa dyshim, një motiv etnikisht neutral. Sipas kriterit të fundit, të gjitha rastet me motiv të qartë ekonomik (përfshirë këtu plaçkitjen, vjedhjen dhe vjedhjen me thyerje) apo që rrjedhin nga kontestet ndërmjet fqinjëve, grindjet në gjendje të dehur dhe situatat e ngjashme, nuk klasifikohen më si të motivuara etnikisht.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Ndonëse jo domosdo të kategorizuara si etnikisht të motivuara,<sup>23</sup> incidentet që kanë si cak kryesisht personat që i takojnë komunitetit serb dhe rom vazhdojnë të shfaqen.<sup>24</sup> Ndërsa statistikat e policisë së Kosovës bëjnë klasifikimin e një numri rastesh potencialisht me motive etnike (82 nga shkurti 2008 deri në maj 2009) është vështirë të sigurohen informata për ndjekjen penale të atyre rasteve. Në të vërtetë, librat e regjistrimit të gjykatave të Kosovës përgjithësisht nuk ofrojnë informata për përkatësinë etnike. Për më tepër, nuk mbahen libra special të regjistrimit për incidentet me motive etnike, dhe ato raste regjistrohen kryesisht në mënyrë manuale në librat e regjistrimit, sikurse edhe rastet tjera. Kur kërkohet, nëpunësit bëjnë nxjerrjen e të dhënave për këto incidente nga librat e përgjithshëm të regjistrimit të lëndëve. Ndërkohë, EULEX-i ka dërguar nga dy këshilltarë për krimet ndër-etnike për rajon, për të monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar policinë.

<sup>20</sup> Aneksi XV, (viii) dhe (xii), Rregullorja e UNMIK-ut 2005/53 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 për degën ekzekutive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, 20 dhjetor 2005.

<sup>21</sup> Krimi i urrejtjes: "cilido veprim i paligjshëm i menduar për të frikësuar, dëmtuar, lënduar, trembur apo ngacmuar një individ, në tërësi apo pjesërisht për shkak të motivimit paragjykes kundrejt racës reale apo të perceptuar të viktimës, religjionit, përkatësisë etnike, orientimit seksual apo paaftësisë;" incidentet e urrejtjes: "[...] veprimet nga një individ apo grup që, ndërsa të motivuara nga urrejtja apo paragjykimi, nuk ngrihen në nivelin e veprës penale." Politikat dhe procedurat e Shërbimit Policor të Kosovës, Krimet e urrejtjes dhe krimet etnike, P-4.29, 22 korrik 2002, rishikuar më 19 shkurt 2003, pjesa III. Definicionet A dhe B.

<sup>22</sup> UNMIK PSSP, Kriteret dhe procedurat për raportimin e incidenteve potencialisht me motive etnike, 10 gusht 2005, përfshirë aneksin A deri në C.

<sup>23</sup> Për shembull, në korrik dhe tetor 2008, dy raste të gjuajtjes me gurë të autobusit humanitar të bardhë me logo të OKB-së, që transportonin persona të cilët u takonin komuniteteve jo-shumicë nëpër rajonet e banuara me shqiptarë të Kosovës, kishin ngjarë në rajonin e Pejës/Peć dhe të komunës së Glogovcit/Glogovac, nuk ishin kategorizuar si të motivuara etnikisht. Ndonëse autobusi është lehtësisht i identifikueshëm dhe ka një orar të rregullt, policia nuk ka qenë në gjendje të konstatojë nëse kryesit kanë ditur për përkatësinë etnike të pasagjerëve.

<sup>24</sup> OSBE ka raportuar për një numër në rritje të incidenteve të ngacmimit që kanë pasur si cak serbët e Kosovës në muajt qershor-gusht 2009 (që përfshijnë përdhosjen e varrezave, hyrjen me dhunë në shtëpitë e të kthyerve, gjuajtjen me gurë të veturave, vjedhjet, sulmet, ngacmimin dhe vrasjen), duke përfshirë dy raste serioze në komunën e Klinës/Klina (ku një i kthyer i moshuar është rrahur rëndë gjersa po punonte në arën e tij) dhe në komunën e Gjilanit/Gnjilane (ku një çift i moshuar është vrasur në shtëpinë e tyre). Në muajt korrik-gusht 2009, ashtu si konfirmohet nga zëvendës kryetari shtesë i komunës së Gjilanit/Gnjilane, romët që jetonin në lagjen Abdullah Presheva/Abdula Preševo ishin sulmuar verbalisht dhe fizikisht nga njerëzit që i takonin komunitetit të shqiptarëve të Kosovës. Këto incidente mund të kenë lidhje me çështjet pronësore dhe ndikojnë negativisht në kthimin dhe integrimin e komunitetit në fjalë.

### ***Vlerësim i gjithëmbarshtëm***

Mungesa e një baze të kompjuterizuar e të dhënave në gjykata dhe fakti që të pandehurit nuk klasifikohen sipas përkatësisë etnike, janë njëjloj pengesë për disponueshmërinë e të dhënave për ndjekjen penale të krimeve me motive etnike. Projektet e vazhdueshme të Komisionit Evropian për themelimin e Sistemit informativ për menaxhim të lëndëve, janë një mundësi për përcjelljen e ndjekjes penale të krimeve me motive etnike, nëse policia, prokurorët dhe gjyqtarët mund të këmbëjnë informata për klasifikimin dhe ndjekjen penale të incidenteve të ngjashme.

## **2.2. Mosndëshkimi, ndjekja penale e krimeve me motive etnike dhe raportimi i manifestimeve ditore të jo tolerancës**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 8: Adresimi i mosndëshkimit të perceptuar të krimeve me motive etnike, duke i dhënë atij krimi prioritetin më të lartë brenda organeve të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera të përfshira, dhe ndërmarrja e hapave për të inkurajuar raportimin e manifestimeve të përditshme të jo tolerancës.*

### ***Korniza normative***

Kodi i përkohshëm penal i Kosovës (Kodi Penal) sanksionon nxitjen publike të urrejtjes nacionale, racore, religjioze apo etnike, mospajtimit apo jo tolerancës.<sup>25</sup> Gjobat, burgimi dhe dënime të shtuara janë parashikuar në rastet në të cilat vepra kryhet në mënyrë sistematike, duke shfrytëzuar pozitën e autoritetit, me anë të shtrengimit, rrezikimit të sigurisë, ekspozimit të simboleve nacionale, racore, etnike apo religjioze ndaj përqeshjes, dëmtimit të gjërave personale të një personi tjetër, apo përdhosjes së monumenteve apo varrezave; apo kur vepra shkakton trazira, dhunë dhe pasoja të tjera të rënda.<sup>26</sup> Qarkorja interne e vitit 2006, e nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë<sup>27</sup> i jep prioritet të lartë zgjidhjes së rasteve që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Në disa raste, ndjekja penale e krimeve me motive etnike mbështetet së tepërmi në dëshmitë e dëshmitarëve. Shpesh, ndryshimi i mendimit apo mungesa e bashkëpunimit nga dëshmitarët dëmtojnë ndjekjen penale. Ndonëse deklarojnë që incidentet me motive etnike i trajtojnë gjithëherë me prioritetin më të lartë,<sup>28</sup> gjyqtarët dhe prokurorët shpesh shpërfillin shqyrtimin e motivit etnik pas krimin. Në tetor 2008, në një rast të të shtënave ndaj serbëve të zhvendosur nga Kosova që vizitonin varrezat, i pandehuri shqiptar i Kosovës ishte gjykuar për krimin e përdorimit të paligjshëm të armëve<sup>29</sup> dhe ishte dënuar me gjobë prej 600 eurosh. Faktet e rastit padyshim shtrinin nevojën për akuza më të rënda,<sup>30</sup> mbase edhe për një dënim tjetër,<sup>31</sup> veçmas marrë

<sup>25</sup> Neni 115 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003 me ndryshimet pasuese.

<sup>26</sup> Nenet 64, 115, 147 dhe 260, Kodi penal.

<sup>27</sup> Qarkorja interne e Ministrisë së Drejtësisë Ref. A-062/MD.

<sup>28</sup> Shih raportin 'Katër vite më pas. Përcjellja e rasteve në lidhje me trazirat e marsit 2004 para sistemit të drejtësisë penale në Kosovë,' Misioni i OSBE-së në Kosovë, korrik 2008.

<sup>29</sup> Neni 328(1), Kodi penal.

<sup>30</sup> Sikur që është neni 29(1), Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, në mënyrë kumulative me akuzën nga neni 328, përdorimi i paautorizuar i armëve. Veç kësaj, disa deklarata të grupit të sulmuar për dëgjimin e plumbave që kishin fluturuar shumë pranë tyre, mund të mbështesin gjithashtu akuzën nga neni 20 dhe 146, vrasje në tentativë.

<sup>31</sup> I pandehuri është shpallur fajtor për krijimin e kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve sipas nenit 328(1) të Kodit penal, që dënohet me gjobë deri në 10.000 EURO apo me burgim prej një deri në dhjetë vite.

parasysh motivin etnik të mundshëm mbrapa krimit, që ishte injoruar nga gjykata.<sup>32</sup> Prandaj, prokuroria dhe gjykata me sa duket nuk ka përfshirë në tërësi veprimet e të pandehurit në kualifikimin/padinë e duhur ligjore. Së këndejmi, duke dështuar në marrjen parasysh si duhet të motivit etnik si një faktor rëndues, në fund ata kanë aplikuar një dënim që nuk është proporcional me peshën e veprës, në kundërshtim me atë që kërkon ligji.<sup>33</sup> Ky shembull duket se përfaqëson një trend. Në të vërtetë, një analizë e kohëve të fundit për trajtimin e rasteve nga trazirat e marsit 2004 nga ana e prokurorëve dhe gjyqtarëve të Kosovës, ka treguar ekzistencën e problemeve të ngjashme të akuzimit të pamjaftueshëm dhe ndëshkimit të butë të kryesve të krimeve me motive etnike, dhe të një dështimi të gjerë në marrjen parasysh të motivit etnik si një rrethanë rënduese.<sup>34</sup> Veç kësaj, disa nga prokurorët dhe gjyqtarët e Kosovës nuk e konsiderojnë motivin etnik mbrapa një krimi si një faktor rëndues pasi që të gjithë personat janë të barabartë para ligjit, pa marrë parasysh përkatësinë nacionale apo etnike të tyre. Megjithatë, trajtimi i motivit etnik si një rrethanë rënduese është në linjë me parimet e barazisë dhe me standardet ndërkombëtare.<sup>35</sup>

Një çështje e veçantë e shqetësimit lidhur me mosndëshkimin është situata e gjykatave dhe e zyrave të prokurorisë në komunat veriore të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica,<sup>36</sup> si dhe besimi ndaj policisë. Mungesa e sistemit plotësisht funksional të gjyqësisë dhe prokurorisë në komunat veriore pengon ndjekjen penale efektive të të gjitha krimeve dhe ndihmon krijimin e një atmosfere të mosndëshkimit të gjithmbarshëm. Veç kësaj, shqiptarët dhe komunitetet tjera jo-shumicë që jetojnë në atë zonë nuk ndjehen të sigurt për raportim tek policia e Kosovës të rasteve që mund të jenë me motive etnike.<sup>37</sup> Në Mitrovicën e Veriut/Mitrovica, një rritje e tensioneve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, që ka shkaktuar krime me motive etnike, është raportuar në lidhje me projektin e kthimit në Kroin e Vitakut/Brđani.<sup>38</sup> Më 23 janar

<sup>32</sup> Vendimi i gjykatës ka deklaruar shprehimisht që “nuk është gjetur ndonjë rrethanë veçmas rënduese”.

<sup>33</sup> Neni 64(1), Kodi penal.

<sup>34</sup> Shih raportin ‘Katër vite më pas. Përcjellja e rasteve në lidhje me trazirat e marsit 2004 para sistemit të drejtësisë penale në Kosovë,’ Misioni i OSBE-së në Kosovë, korrik 2008.

<sup>35</sup> Shih vendimet e Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, 24 shkurt 2004, paragrafi 158; *Šečić kundër Kroacisë*, 31 maj 2007; *Cobzaru kundër Rumanisë*, 26 korrik 2007, paragrafi 101; vendimi TPNJ, rasti nr. IT-96-23-T& IT-96-23/1-T, vendimi i 22 shkurtit 2001, paragrafi 867; dhe Zyra e OKB-së e Komisionarit të lartë për të drejtat e njeriut në rekomandimin e përgjithshëm, të tij nr. 30: Diskriminimi kundër jo-qytetarëve në Konventën për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit racor, tetor 2004.

<sup>36</sup> Pas 17 shkurtit 2008, nuk ka gjykata funksionale komunale apo për kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavić. Gjykata e Qarkut e Mitrovicës/Mitrovica dhe Gjykata Komunale (që mbulon edhe Zvečanin/Zvečan) funksionojnë me kapacitete të limituara në hapësiat e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn, duke mbuluar gjithashtu komunat e Skenderajt/Srbica dhe Vushtrrisë/Vučitrn. Zyrat rajonale të prokurorisë operojnë gjithashtu në një shkallë shumë të kufizuar nga ndërtesa e gjykatës në Vushtrri/Vučitrn; prandaj, ato nuk janë në gjendje të procedojnë pjesën më të madhe të krimeve që kanë ndodhur para 21 shkurtit 2008 pasi që dosjet janë të vendosura në gjykatën në Mitrovicën e Veriut/Mitrovica. Dërgimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it (tre për procedimet penale dhe një për ato civile) në ndërtesën e gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica të Veriut në dhjetor 2008, nuk ka përmirësuar situatën. Deri në qershor 2008, EULEX-i ka kompletuar dy lëndë penale, ndërsa çështjet praktike dhe ligjore mund ti pengojnë ata në zëvendësimin e plotë të sistemit gjyqësor të rajonit.

<sup>37</sup> Shih raportin për: ‘Matja e besimit. Siguria dhe perceptimet për sigurinë publike,’ Misioni i OSBE në Kosovë, qershor 2008.

<sup>38</sup> Kroji i Vitakut/Brđani është një lagje me popullatë të përzier në Mitrovicën e Veriut/Mitrovica. Diskutimet lidhur me projektin e kthimit për shqiptarët e zhvendosur ka nisur në tetor të vitit 2008; në pranverë të vitit 2009, ka nisur rindërtimi i shtëpive të tyre dhe ka rezultuar në përlëshje të

2009, policia e Kosovës ka themeluar në të gjitha zonat me popullatë të përzier në Mitrovicë/Mitrovica, një njësi shumetnike të policisë së komunitetit prej 17 anëtarësh. Qëllimi është komunikimi dhe bashkëpunimi përmes masave të ngritjes të besimit me njerëzit e prekur nga shpërthimet e fundit të dhunës etnike, dhe mbledhja e informatave për incidentet e kaluara.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Ndonëse korniza ligjore dhe dokumentet e politikave u japin prioritet të lartë hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve me motive etnike, në disa raste kryesit e veprave nuk mund të identifikohen apo të dënohen si duhet. Për më tepër, ashtu si është përmendur më herët, interpretimi i ngushtë i ligjit nga gjyqtarët dhe prokurorët i kontribuon rritjes së ndjenjës së mosndëshkimit në mesin e komuniteteve jo-shumicë. Në anën tjetër, institucionet nuk kanë ndërmarrë hapa konkretë për ta ndërruar këtë trend dhe për të adresuar perceptimet rreth mosndëshkimit.

### **2.3. Përfaqësimi dhe rekrutimi në gjykata i personave që u takojnë komuniteteve jo-shumicë**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 6: Rritja e përpjekjeve për përmirësim të funksionimit të gjyqësorit dhe për ndërtim të besimit të komuniteteve pakicë në gjykata, inter alia, duke rekrutuar më tej persona që u takojnë minoriteteve dhe duke përmirësuar shpejtësinë me të cilën trajtohen rastet.*

#### ***Korniza normative***

Korniza rregullatore për sistemin e drejtësisë<sup>39</sup> ka futur në përdorim kuotat për të siguruar përfaqësimin prej 15 për qind të komuniteteve jo shqiptare, përfshirë këtu të paktën tetë për qind për serbët, në sistemin e gjyqësisë dhe të prokurorisë, përmes masave të implementuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Megjithatë, kushtetuta kërkon një kuotë prej 15 për qind të gjyqtarëve jo shqiptarë vetëm për gjykatat e apelit.<sup>40</sup> Sa i përket emërimeve në funksionet e prokurorisë, kushtetuta përcakton që preferencë do tu jepet komuniteteve jo-shumicë, për të pasqyruar përbërjen etnike të juridiksionit territorial relevant.<sup>41</sup>

#### ***Implementimi/Situata në terren***

Aktualisht, përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në gjyqësorin e Kosovës (11.4 për qind) dhe në shërbimin e prokurorisë (7.7 për qind) është më i ulët se sa përcaktohet. Nga 298 gjyqtarë, 264 (88.6 për qind) janë shqiptarë, 15 janë serbë, 11 janë boshnjakë, pesë janë turq dhe tre janë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Nga 91 prokurorë, 84 janë shqiptarë (92.3 për qind), dy serbë, dy boshnjakë, dy turq dhe një ashkali.<sup>42</sup> Veç kësaj, funksionimi i gjykatave është prekur në masë të madhe në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica në periudhën pas 17 shkurtit 2008.<sup>43</sup> Më 13 shkurt 2009, ka nisur procesi i verifikimit apo i emërimit, që mund të ndryshojë përfaqësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve që u takojnë komuniteteve jo-shumicë. Më 26 qershor

---

përsëritura ndërmjet dy komuniteteve. Ndërsa rindërtimi po vazhdon, incidentet e kohëpaskohshme vazhdojnë të shfaqen edhe më tej.

<sup>39</sup> Neni 2(4) Rregullorja e UNMIK-ut 2006/25 për Kornizën rregullatore për sistemin e drejtësisë në Kosovë, 27 prill 2006.

<sup>40</sup> Neni 103(3),(6) dhe neni 108(2), i kushtetutës.

<sup>41</sup> Neni 110(2),(3), i kushtetutës.

<sup>42</sup> Shih raportin për 'Pjesëmarrjen e femrave dhe të përfaqësuesve të minoriteteve në sistemin e drejtësisë në Kosovë', Asociacioni i gjyqtarëve të Kosovës, 2009.

<sup>43</sup> Shih fusnotën 36 të këtij raporti.

2009 janë emëruar gjashtë gjyqtarë të gjykatës kushtetuese, përfshirë këtu një turk dhe një serb.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Përpjekjet e sistemit gjyqësor të Kosovës për rekrutim të kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në momente të caktuara vështirësohen nga mungesa e aplikacioneve apo e kandidatëve të kualifikuar. Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë është nën kuotat e parashikuara, ndonëse është relativisht i lartë. Përpjekje të mëtejme nevojiten për ndërtimin e besimit të komuniteteve jo-shumicë në gjyqësi, që mbetet institucioni më të cilin popullata është më së paku e kënaqur.<sup>44</sup> Megjithatë, një analizë komparative e bërë së fundi nga OSBE nuk shfaqë diferenca të mëdha në trajtimin e të pandehurve nga komunitetet e ndryshme nga ana e sistemit të drejtësisë në Kosovë.<sup>45</sup>

## **2.4. Shndërrimi i institucionit të Ombudspersonit në institucion vendor**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 7: Të sigurohet që transferi i institucionit të Ombudspersonit në institucion vendor nuk do të dëmtojë efikasitetin e institucionit apo të shkatërrojë besimin e ndërtuar deri më sot në mesin e komuniteteve pakicë.*

### ***Korniza normative***

Sipas kornizës ligjore,<sup>46</sup> që nga viti 2007 Ombudspersoni vepron si institucion vendor, që nuk ka më juridiksion mbi ankesat kundër UNMIK-ut. Kushtetuta njeh gjithashtu Ombudspersonin si një nga institucionet vendore të pavarura.<sup>47</sup> Projektligji për Avokatin e Popullit është planifikuar të diskutohet në Kuvendin e Kosovës në nëntor 2009. Më 4 qershor 2009, Kuvendi i Kosovës ka emëruar Ombudspersonin vendor.<sup>48</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Qasja në Institucionin e Ombudspersonit është e siguruar përmes zyrës qendrore në Prishtinë dhe zyra rajonale në Gjilan/Gnjilane, Pejë/Peć, Prizren, Graçanicë/Gračanica dhe Mitrovicë/Mitrovica. Kjo e fundit ka një nën-zyrë në pjesën veriore të qytetit. Megjithatë, kjo zyrë ndeshet me probleme të dukshme pasi që një pjesë e madhe e popullatës në Kosovën veriore nuk është e njoftuar për ekzistencën e saj. Që nga 1 prilli 2008, nën-zyra në Videjë/Vidanje, një fshat ky në rajonin e Pejës/Peć, që banohet kryesisht nga serbët, është mbyllur në mungesë të financimit, duke i privuar kështu këto komunitete nga qasja direkte në Institucionin e Ombudspersonit. Për shkaqe të ngjashme, stafi i zyrës në terren në Graçanicë/Gračanica është reduktuar gjithashtu. Veç kësaj, përpjekjet për të përfshirë anëtarë të stafit, në mënyrë specifike ata që merren me rastet e komuniteteve jo-shumicë, në buxhetin e konsoliduar të Kosovës nuk kanë qenë të suksesshme.<sup>49</sup> Avokatët e Institucionit të Ombudspersonit bëjnë vizita të rregullta në komuna, në enklava dhe në zonat e banuara nga komunitetet jo-shumicë. Institucioni gjithashtu cakton rregullisht ditët e hapura gjatë të cilave ankuesit mund të takohen personalisht

<sup>44</sup> Shih Raportin e paralajmërimit të hershëm – Fakte të shpejta #24, UNDP, maj 2009, faqe 2 dhe 5.

<sup>45</sup> Shih Raportin për 'Komunitetet e ndryshme para sistemit të drejtësisë në Kosovë. Një përmbledhje statistikore preliminare e ndëshkimeve dhe e rezultatit të gjykimeve në gjykatat e qarkut, komunale dhe ato për kundërvajtje', Misioni i OSBE-së në Kosovë, dhjetor 2008.

<sup>46</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2007/15 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2006/06 për Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, 19 mars 2007.

<sup>47</sup> Kapitulli XII i Kushtetutës.

<sup>48</sup> Pas skadimit të mandatit të Ombudspersonit ndërkombëtar në dhjetor të vitit 2005, ishte emëruar ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit. Kuvendi i Kosovës ka emëruar Ombudspersonin vetëm pas përpjekjes së pestë.

<sup>49</sup> Shih Raportin e tetë vjetor të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, korrik 2008.

me Ombudspersonin. Statistikat tregojnë që numri i rasteve të dorëzuara nga pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë ka mbetur i lartë deri nga fundi i vitit 2007 (rreth 25 për qind) por ka filluar të shënojë rënie në vitin 2008. Zyrtarisht, në periudhën 2007/2008, 17 për qind (12 për qind serbë dhe pesë për qind të tjerë) dhe në periudhën 2008/2009 vetëm 13 për qind (nëntë për qind serbë dhe katër për qind të tjerë) e rasteve janë dorëzuar nga personat që u takojnë komuniteteve jo-shumicë. Ndërkohë, numri i përgjithshëm i rasteve ka shënuar rënie nga 690 në periudhën 2006/2007 në 523 në periudhën 2007/2008 dhe 411 në periudhën 2008/2009. Megjithatë, Institucioni ka iniciuar më tepër hetime *ex officio*.<sup>50</sup>

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Ndryshimet pas shkurtit 2008 sigurisht që kanë pasur ndikim në numrin e serbëve që dorëzojnë ankesa pranë Institucionit dhe kanë prekur pjesërisht besimin e ndërtuar që nga përcaktimi i pozitës së Ombudspersonit në vitin 2006. Për më tepër, pamundësia e Kuvendit të Kosovës për të emëruar Ombudspersonin për më tepër se tri vite, ka dëmtuar besimin e të gjitha komuniteteve në autoritetin e Institucionit dhe në aftësinë e tij për zgjidhjen e suksesshme të ankesave të tyre. Në fund, vlerësimi në terren i kryer në bazë tremujore nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) tregon që shqiptarët dhe komunitetet tjera jo-shumicë janë përgjithësisht më të kënaqur me Institucionin e Ombudspersonit për dallim nga serbët. Popullata e përgjithshme edhe më tej është përgjithësisht e kënaqur, ndonëse më pak se në të kaluarën.

## **3. PROCESI I KTHIMIT DHE SIGURIA**

### **3.1. Krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm, siguri, ri-posedim të pronës dhe për aktivitete që krijojnë të ardhura**

*Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, rekomandimi nr. 9: Të ndërmerren masa energjike praktike për të larguar pengesat për kthim të qëndrueshëm, duke adresuar seriozisht shqetësimet e sigurisë të serbëve dhe personave të tjerë dhe duke siguruar gjithashtu, përfshirë këtu implementimin e legjislacionit të aprovuar së fundi, ri-posedimin dhe qasjen e papenguar në pronat bujqësore dhe të tjera dhe duke dizajnuar aktivitete të tjera për krijim e të ardhurave.*

### ***Korniza normative***

Korniza ligjore ri-konfirmon të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur për kthim në shtëpitë e tyre në siguri, dhe kthim të pronave të tyre.<sup>51</sup> Ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e pretendimeve në lidhje me pronën private të patundshme<sup>52</sup> ka ri-caktuar autoritetin e UNMIK-ut mbi Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP)<sup>53</sup> tek Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Më tej, Doracaku i ripunuar i

<sup>50</sup> Në periudhën 2008/2009, janë hapur 62 hetime *ex officio*; në periudhën 2007/2008, 10 hetime dhe në periudhën 2006/2007 vetëm dy.

<sup>51</sup> Preambula, nenet 9(c), 11(k), 13 dhe Anekset, Rezoluta 1244 e KS të OKB (1999), 10 qershor 1999; neni 156 i Kushtetutës.

<sup>52</sup> Më 13 qershor 2008 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për zgjidhjen e ankesave lidhur me pronën private të patundshme, përfshirë këtu pronën bujqësore dhe komerciale (ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e ankesave lidhur me pronën private të patundshme).

<sup>53</sup> Për të adresuar kthimin e pronës private të patundshme rezidenciale, komerciale dhe bujqësore, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10, e zëvendësuar më pas me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50, ka themeluar Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) si një organ të pavarur që përfshin Komisionin e Kosovës për Kërkesat Pronësore (KKP), që është pasues i Drejtorisë banesore dhe pronësore (DBP) dhe i Komisionit për kërkesa banesore dhe pronësore (KKBP) i themeluar fillimisht nga UNMIK-ut në vitin 2001.

vitit 2006 për kthim të qëndrueshëm,<sup>54</sup> bazuar në standardet ndërkombëtare, përfshin objektivat kryesore të politikave të azhurnuara të kthimit, të miratuara nga qeveria e Kosovës më 24 maj 2006, si dhe Protokollin për kthim vullnetar dhe të qëndrueshëm.<sup>55</sup> Për të thjeshtuar dhe për ti bërë më të efektshme politikat e kthimit, në tetor të vitit 2008, Ministria e Kthimit ka iniciuar rishikimin e Doracakut dhe është angazhuar në hartimin e strategjisë ministrore për komunitetet dhe të kthyerit.<sup>56</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Në vitin 2008 dhe 2009 ka pasur një rënie të konsiderueshme në numrin e kthimeve vullnetare të personave që u takojnë komuniteteve jo-shumicë.<sup>57</sup> Ndërsa institucionet e Kosovës kanë vazhduar të inkurajojnë kthimin dhe të zhvillojnë strategji të kthimit dhe projekte në nivel komunal, mungesa e financimit dhe kapacitetet e limituara administrative dhe menaxhues të autoriteteve qendrore dhe lokale mbesin pengesa të rëndësishme për implementimin e tyre. Megjithatë, numri i personave të zhvendosur që kanë shprehur dëshirën për tu kthyer në Kosovë është duke u rritur gradualisht. Kjo për shkak të përpjekjeve të përtëritura për identifikim dhe regjistrim të personave të zhvendosur që kanë shprehur interesim për kthim në Kosovë, nga ana e komunitetit ndërkombëtar dhe autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë/Priština në gjysmën e parë të vitit 2009. Policia e Kosovës luan një rol me rëndësi në ofrimin e sigurisë efektive për komunitetet jo-shumicë dhe për të kthyerit/personat e zhvendosur, në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve dhe në sigurimin e lirisë së lëvizjes për të gjitha komunitetet. Njësitë policore shumetnike të komunitetit në tërë Kosovën kanë vazhduar të angazhohen në çështjet e ndryshme të sigurisë së komunitetit dhe në ndërtimin e raporteve me banorët e Kosovës, veçmas në rajonet e banuara nga komunitetet jo-shumicë. Megjithatë, që nga shkurti 2008, puna e këtyre njësive në disa rajone është dëmtuar nga bojkoti i policëve serb. Kthimi në punë i pjesës më të madhe të këtyre policëve në qershor të vitit 2009 paraqet një përmirësim. Në fillim të vitit 2008, ishte krijuar një Departament special për çështje të komuniteteve në kuadër të shërbimit policor, për të mbikëqyrur punën e njësive të policisë së komunitetit. Komitetet lokale të sigurisë publike dhe këshillat komunale të sigurisë së komunitetit mbetet të bëhen plotësisht funksionale dhe të kontribuojnë në mënyrë efektive në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të sigurisë së komunitetit, sigurisë dhe krimin.<sup>58</sup> Transporti humanitar me autobusë vazhdon të ofrojë një shërbim kyç për komunitetet jo-shumicë, përfshirë këtu të kthyerit, duke rritur lirinë e tyre të lëvizjes

<sup>54</sup> Doracaku i ripunuar i UNMIK/IPVQ për kthim të qëndrueshëm, korrik 2006.

<sup>55</sup> Protokollin është nënshkruar më 6 qershor 2006 nga UNMIK-u, Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe qeveria e Serbisë.

<sup>56</sup> Drafti i strategjisë për komunitete dhe kthim 2009-2013 është prezantuar para publikut në qershor të vitit 2009. Si procesi i rishikimit të Doracakut, ashtu edhe procesi i hartimit të strategjisë janë në vazhdim e sipër.

<sup>57</sup> Vetëm 679 pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë janë kthyer në Kosovë në vitin 2008, në krahasim me 1,816 më 2007 dhe 1,669 më 2006 sipas të dhënave të Komisionarit të lartë të OKB-së për refugjatët (UNHCR). Në mes janarit dhe majit 2009, vetëm 240 persona të zhvendosur që u takojnë komuniteteve jo-shumicë janë kthyer vullnetarisht në Kosovë (Pasqyrë statistikore e UNHCR, maj 2009).

<sup>58</sup> Neni 7 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/54 për Kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës, dhe amendamentet pasuese; më 15 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për policinë (ligji i zbatueshëm për policinë), neni 7; Ministria e Punëve të Brendshme, Udhëzimi Administrativ 08/2009 për Këshillat komunale të sigurisë së komunitetit, 20 mars 2009.



dhe qasjen në shërbime.<sup>59</sup> Shërbimi vazhdon të funksionojë relativisht mirë, ku pjesa më e madhe e linjave dhe ndalimeve të autobusit funksionojnë rregullisht dhe pasagjerët janë përgjithësisht të kënaqur me cilësinë e shërbimeve.<sup>60</sup>

Që nga themelimi i saj në vitin 2006 deri në dhjetor 2007, AKP ka pranuar rreth 40,000 kërkesa në lidhje me konfliktin, që kanë të bëjnë me pronën private të patundshme që përfshin pronat bujqësore dhe komerciale. Deri në maj të vitit 2009, Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës (KKPK) ka sjellë vendime në 18,794 raste dhe ka implementuar 1,600 raste. Veç kësaj, AKP ka marrë përgjegjësitë e Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore për administrimin e pronave të banimit, veçmas të pronave që konsiderohen të braktisura.<sup>61</sup> Sipas AKP-së, deri në fund të prillit 2008, 3,848 nga 4,457 prona nën administrimin e saj janë dhënë me qira në emër të pretenduesve. Që nga tetori 2008, AKP bën dërgimin elektronik të vendimeve për pretenduesit jashtë Kosovës dhe ka nisur zbatimin e vendimeve të KPK-së. Për shkak të bartjes së autoritetit të UNMIK-ut mbi AKP-në tek Përfaqësuesi civil ndërkombëtar, më 19 qershor 2008 qeveria serbe ka suspenduar operacionet e zyrave të AKP-së në Serbi, me pretendimin që agjencia nuk arrin në mbrojtje të drejtat e qytetarëve të përkatësisë etnike serbe, pronat e të cilëve janë uzurpuar në Kosovë. Ky vendim ka krijuar probleme serioze për procedimin e rasteve nga AKP-ja, përfshirë këtu verifikimin e dokumenteve, njoftimin e palëve apo dëshmitë vërtetuese. Prandaj, të zhvendosurit që kanë pretendime për pronën duhet të udhëtojnë në zyrat rajonale të AKP-së në Kosovë për procedimin e rasteve të tyre.

Programet ekzistuese të kthimit që mbështeten nga qeveria<sup>62</sup> u ndihmojnë të kthyerve individual dhe të organizuar në çështjet e banimit, zhvillimit të komunitetit, si dhe me masa socio-ekonomike për të mbështetur jetesën e të kthyerve. Në vitin 2008 Ministria për Komunitete dhe Kthim ka marrë drejtimin në implementimin e projekteve për zhvillim dhe stabilizim të komunitetit, dhe në projektet tjera të bashkë-financuara nga Ministria. Megjithatë, integrimi ekonomik afatgjatë i të kthyerve mbetet një sfidë, veçmas në lidhje me shkallën e lartë ekzistuese të papunësisë në Kosovë.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

---

<sup>59</sup> Në përputhje me Aranzhimin operacional për bartje të përgjegjësive për transportin humanitar të komuniteteve pakicë në Kosovë, ndërmjet UNMIK-ut dhe IPVQ-së, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit ka marrë përsipër përgjegjësinë e plotë për këtë shërbim, përfshirë këtu financimin e tij, menaxhimin dhe sigurinë në janar 2007.

<sup>60</sup> Gjatë një vlerësimi të bërë nga OSBE në prill të vitit 2009, pasagjerët janë ankuar për ndërprerjet e përkohshme të shërbimit të transportit për shkak të motit, për numrin e vogël të udhëtimeve vajtje-ardhje për ditë/muaj, dhe për faktin që autobusët kanë qenë të stërmbushur, apo që pagesat e udhëtimit janë rritur. Komiteti këshillëdhënës për transportin që është përgjegjës për transportin humanitar me autobus nuk është takuar ende në vitin 2009, dhe disa kërkesa për linja shtesë të autobusit apo për zgjerimin e itinerarit nuk janë shqyrtuar ende.

<sup>61</sup> Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 për kërkesat në lidhje me pronat e banimit dhe rregullat e procedurës dhe të provave të Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore, dhe të Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore, 31 tetor 2000.

<sup>62</sup> Programi i menaxhuar nga UNDP për partneritete të qëndrueshme për asistencë për kthimin e minoriteteve në Kosovë, i financuar nga qeveria britanike, ofron asistencë multi-sektoriale për kthimet individuale/spontane dhe të organizuara që nga viti 2005. Projekti i kthimit dhe ri-integrimit në Kosovë, i nisur në nëntor të vitit 2008, synon të ofrojë pako gjithëpërfshirëse të kthimit për rreth 180 familje të zhvendosura, që përfshin edhe asistencën socio-ekonomike. Projekti financohet bashkërisht nga Komisioni Evropian, Ministria për Komunitete dhe Kthim, dhe UNDP.

Procesi i kthimit mbetet një sfidë kyçe për institucionet e Kosovës. Qasja e limituar në prona, procedimet e bllokuara apo të vonuara të kthimit të pronës, mungesa e mundësive ekonomike dhe ndjenja e përgjithshme e pasigurisë në mesin e personave të zhvendosur, vazhdojnë të mbesin pengesat kryesore për kthim të qëndrueshëm. Mijëra persona të zhvendosur vazhdojnë të jetojnë në kushte shumë të vështira në qendrat kolektive dhe vendbanimet joformale. Kthimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve është veçmas i vështirësuar nga mungesa e regjistrimit civil dhe e dokumenteve personale. Fushat kryesore të shqetësimit janë: financimi për projektet e kthimit; masat e sigurimit të të drejtave pronësore në projektet e kthimit; masat për përmirësim të banimit të personave të zhvendosur aty ku ata jetojnë aktualisht; implementimi i mandatit të AKP-së në lidhje me kërkesat për pronat private të patundshme në lidhje me konfliktin, dhe zbatimi efektiv i vendimeve të KPK-së; dhe pjesëmarrja efektive e personave të zhvendosur në bërjen e politikave në nivel qendror dhe lokal dhe në implementimin e tyre.

### 3.2. Skemat e asistencës për kthimin dhe zgjedhja e lirë e vendit të banimit

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 10: Ndjekja e planeve për të bërë skemat e asistencës më fleksibile, për të garantuar lirinë e zgjedhjes së vendit të banimit në Kosovë, për personat që u takojnë komuniteteve pakicë.*

#### ***Korniza normative***

Korniza ligjore dhe e politikave për të kthyerit<sup>63</sup> e miratuar në vitin 2006, bazohet në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë këtu Parimet drejtuese të Kombeve të Bashkuara nga viti 1998 për zhvendosjen interne.<sup>64</sup> Ajo rikonfirmon të drejtën e personave të zhvendosur për kthim në vendin e tyre të origjinës dhe për të zgjedhur lirshëm vendin e banimit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Përveç kthimit në vendin e origjinës, korniza ekzistuese e politikave mundëson gjithashtu zgjidhje alternative të qëndrueshme, që përfshin integrimin lokal në vendin e zhvendosjes apo risistemimit në një vend tjetër nga vendi i zhvendosjes apo i origjinës.

#### ***Implementimi/Situata në terren***

Deri më tani, institucionet e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar kanë pasur prioritet kryesisht kthimin në vendin e origjinës. Janë bërë disa përpjekje për të mundësuar dhe ndihmuar risistemimin apo integrimin lokal të personave të zhvendosur në vende të alternative të zgjedhura lirshëm nga ta. Për shembull, në shtator të vitit 2008, një projekt i kthimit për 60 familje të zhvendosura dhe të cenueshme ishte lansuar në Llapllasellë/Laplje Selo (komuna e Prishtinës/Priština) në një vend tjetër nga vendi i origjinës. Punët rreth ndërtimit dhe për identifikimin e përzgjedhjen e përfituesve janë në vazhdim e sipër. Në maj të vitit 2009, Ministria për komunitete dhe kthim ka bërë të ditur qëllimin e saj për ndërtim të dy ndërtesave me 40 apartamente për personat/familjet e zhvendosura në komunën e Shtërpçës/Štrpce, në përpjekjet për integrim lokal të serbëve të zhvendosur që jetojnë në qendrat kolektive. Megjithatë, projekti është ndaluar në mungesë të financimit. Në fund, ndërmjet janarit 2008 dhe qershorit 2009, një numër i individëve të kthyer ka përfituar nga asistenca për rindërtim në vende të tjera nga vendi i origjinës, me programin e UNDP-së të partneriteteve të qëndrueshme për asistencë për kthim të minoriteteve në Kosovë.

<sup>63</sup> Shih paragrafin 3.1 të këtij raporti.

<sup>64</sup> Parimet drejtuese për zhvendosjen interne, 11 shkurt 1998. (UN Doc. E/CN.4/1998/53/Add.2).

Në praktikë, mungesa e procedurave të qarta për alokim të tokës komunale dhe për rindërtim të shtëpive në lokacione të tjera nga vendi i origjinës, limiton aftësinë e personave të zhvendosur për të zgjedhur lirshëm vendin e tyre të banimit dhe në disa instanca ka rrezikuar implementimin e iniciativave për kthim.<sup>65</sup> Problemet kanë të bëjnë kryesisht me procedurat tepër të komplikuar për lëshimin e lejeve të ndërtimit, udhëzimet e paqarta për alokim të tokës komunale dhe mungesa e kriterëve të qarta për përfituesit, veçmas për ata që nuk kanë në pronësi të tyre tokë apo pasuri tjetër, apo që nuk mund të dëshmojnë pronësinë. Në tetor të vitit 2008, Ministria për komunitete dhe kthim ka iniciuar rishikimin e Doracakut të ripunuar nga viti 2006 për kthimin e qëndrueshëm, dhe ka themeluar një grup punues për çështjet ligjore për të adresuar mangësitë e përshkruara.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Përveç përpjekjeve publike për të siguruar kthimin në vendin e origjinës, mbetet të gjenden zgjidhje të qëndrueshme për ata persona që duan të vendosen në një lokacion tjetër apo të integrohen në nivel lokal në komunitetet ku jetojnë aktualisht, veçmas për ata që janë më të cenueshëm dhe që jetojnë në qendrat kolektive dhe në vendbanimet e parregullta.

### **3.3. Integrimi i personave të riatdhesuar**

*Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, rekomandimi nr. 11: Futja në përdorim e masave të asistencës, dhe alokimi më i qartë i përgjegjësisë institucionale, për të siguruar integrimin më të mirë të atyre personave që u takojnë komuniteteve pakicë që janë kthyer me forcë në Kosovë.*

#### ***Korniza normative***

Në vitin 2007, UNMIK-u dhe Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (IPVQ) formuluar Politikën e ri-pranimit<sup>66</sup> dhe strategjinë për ri-integrim të personave të riatdhesuar<sup>67</sup> për të menaxhuar dhe përkrahur kthimin e personave të kthyer me forcë në Kosovë nga vendet pritëse. Në janar 2008, UNMIK-u ka bërë transferimin e kompetencave të limituara të ri-pranimit, sikur që është shoshitja e rasteve potenciale, në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Më 1 nëntor 2008, qeveria e Kosovës ka marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë rreth riatdhesimit nga UNMIK-u dhe ka nisur negociatat bilaterale për marrëveshjet rreth ri-pranimit me disa vende të Evropës Perëndimore.<sup>68</sup>

#### ***Implementimi/Situata në terren***

<sup>65</sup> Për shembull, serbët e zhvendosur në Shtërpçë/Štrpce dhe Graçanicë/Gračanica, dhe romët e zhvendosur në Mitrovicën e veriut/Mitrovica dhe Leposaviq/Leposavić, deri më sot nuk kanë qenë në gjendje të sigurojnë asistencë për integrim në vendin e zhvendosjes apo të risistemimit.

<sup>66</sup> Politika e ri-pranimit e UNMIK-IPVQ, tetor/nëntor 2007.

<sup>67</sup> Strategjia e UNMIK-IPVQ për ri-integrim të personave të riatdhesuar, tetor 2007. Strategjia synon të sigurojë zgjidhje të stabile dhe qëndrueshme për personat e kthyer me forcë në fushat e shëndetësisë, edukimit, punësimit, ri-integrimit ligjor, mirëqenies social, çështjeve të banimit dhe të pronës. Vëmendje e posaçme u është kushtuar nevojave të pjesëve të ndjeshme të shoqërisë dhe komuniteteve jo-shumicë.

<sup>68</sup> Në një letër për Ambasadat dhe Zyrat e ndërlidhjes në Kosovë më 15 tetor 2008, Departamenti i kufirit dhe menaxhimit të kufijve, azilit dhe migrimit në kuadër të Ministrisë së Brendshme, ka kërkuar nga vendet pritëse që të nisin komunikimin direkt me Ministrinë, në vend se me Zyrën e UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe çështje të pakicave, për kërkesat rreth ri-pranimit dhe për komunikimin tjetër në lidhje me ri-pranimin, me fillim nga 1 nëntori 2008.

Ndërmjet janarit dhe majit 2009, 1,143 persona janë riatdhesuar me forcë në Kosovë, nga të cilët 956 janë shqiptarë,<sup>69</sup> në krahasim me 2,495 në vitin 2008, 3,125 në vitin 2007, 3,598 në vitin 2006 dhe 3,745 në vitin 2005.<sup>70</sup> Në prill të vitit 2008, Qeveria e Kosovës ka finalizuar planin e veprimit për implementim të Strategjisë për ri-integrim të personave të riatdhesuar. Plani i veprimit parasheh alokimet buxhetore të nevojshme nga ministritë relevante, përgjegjësitë e autoriteteve relevante qendrore dhe lokale dhe oraret kohore për implementimin e tyre. Megjithatë, deri më sot nuk janë ndërmarrë hapa konkret për implementim të strategjisë, dhe nuk janë alokuar fondet e nevojshme për ofrim të asistencës specifike për ri-integrim për personat e riatdhesuar. Komunitet nuk kanë implementuar masa konkrete për tu ndihmuar personave të riatdhesuar me forcë në fushat e banimit, shëndetësisë, edukimit apo punësimit, dhe nuk kanë themeluar procedura apo nuk kanë alokuar resurse për akomodimin e nevojave specifike të tyre.<sup>71</sup>

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Ri-integrimi i personave të riatdhesuar mbetet një sfidë e madhe. Masat konkrete për adresim specifik të nevojave të tyre sa i përket banimit, çështje pronësore, punësimit dhe edukimit nuk janë krijuar. Implementimi me sukses i strategjisë do të varet nga alokimi i resurseve buxhetore adekuate për të siguruar plotësimin e nevojave speciale të personave të riatdhesuar, si dhe koordinimin më të mirë ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale.

### **3.4. Masat për adresim të situatës shëndetësore të romëve në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën veriore**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 12: Ndërmarrja e masave të mëtejme urgjente për të adresuar situatën shëndetësore alarmante të romëve në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën veriore, duke konsideruar si prioritet mirëqenien dhe shëndetin e romëve, dhe ndërmarrja e masave shtesë për të akomoduar kthimin e romëve dhe për të parandaluar krizat e tilla shëndetësore në të ardhmen.*

### ***Korniza normative***

Legjislacioni dhe politikat e kthimit në Kosovë sigurojnë të drejtën e personave të zhvendosur për kthim dhe ri-posedim të pronës në përputhje me standardet ndërkombëtare.<sup>72</sup> Legjislacioni relevant dhe politikat përcaktojnë përgjegjësitë qendrore dhe në nivel komunal për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të njëjta për të gjithë pa dallim.<sup>73</sup> Ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale atribuon kompetenca të shtuara në kujdesin shëndetësor dytësor për komunitet specifike me shumicë serbe, përfshirë këtu veriun e Mitrovicës/Mitrovica.<sup>74</sup> Veç kësaj, ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve siguron qasje të njëjtë në kujdesin shëndetësor për komunitetet e cenueshme në planin shoqëror e ekonomik.<sup>75</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

<sup>69</sup> Pasqyrë statistikore e UNHCR-it – Azhurnimi i fundit të majit 2009.

<sup>70</sup> Zyra e UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe çështje të minoriteteve.

<sup>71</sup> Për informata shtesë shih raportin 'Implementimi i strategjisë për ri-integrim të personave të zhvendosur në komunitet e Kosovës,' Misioni i OSBE-së në Kosovë, nëntor 2009.

<sup>72</sup> Shih kornizën normative, paragrafi 3.1 i këtij raporti.

<sup>73</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2004/31 për nxjerrjen e ligjit për shëndetësi të Kosovës, 20 gusht 2004; rregullorja e UNMIK-ut 2004/47 për nxjerrjen e ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shëndetësor, 19 nëntor 2004; rregullorja e UNMIK-ut 2004/32 për nxjerrjen e ligjit kundër diskriminimit, 20 gusht 2004.

<sup>74</sup> Neni 20, ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale.

<sup>75</sup> Neni 10(2), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

Rreth 700 romë janë edhe më tej të zhvendosur në kampet në Leposaviq/Leposavić dhe në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Në prill të vitit 2008, testet e gjakut të kryera nga zyra lokale e Institutit serb për shëndet publik dhe mbrojtje kanë treguar kontaminimin e vazhdueshëm të lartë me plumb të romëve të zhvendosur.<sup>76</sup> Në maj 2008, Departamenti i UNMIK-ut për administratë civile ka bartur përgjegjësinë për kampet në Ministrinë për komunitete dhe kthim.<sup>77</sup> Në janar 2009, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka bërë thirrje për zhvendosjen e menjëhershme të personave të zhvendosur dhe për trajtim mjekësor adekuat.<sup>78</sup> Më 7 maj 2009, qeveria e Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për mbylljen e kampeve dhe për kthimin e personave të zhvendosur në lagjen e romëve në jug të Mitrovicës/Mitrovica apo në vendet tjera të origjinës. Më 28 maj 2009, kuvendi komunal i Mitrovicës/Mitrovica ka aprovuar planin rregullues urban me të cilin ka alokuar tokën për ndërtim të 184 njësive të banimit në lagjen e romëve.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Dhjetë vite pas konfliktit, nuk është gjetur zgjidhje për kthimin e qëndrueshëm apo për risistemimin alternativ të 700 romëve të zhvendosur që u nënshtrohen niveleve të larta të helmimit me plumb në kampet në pjesën veriore të Kosovës. Që nga janari 2007, romët e zhvendosur janë lënë pa trajtim shëndetësor specifik për të luftuar efektet e kontaminimit me plumb. Përkundër gatishmërisë së autoriteteve qendrore dhe lokale për mbylljen e kampeve në maj të vitit 2009 dhe alokimit të tokës, deri më tani nuk është zhvilluar apo implementuar ndonjë zgjidhje e qëndrueshme.

## **4. ÇËSHTJET E KULTURËS DHE MEDIAS**

### **4.1. Mbrojtja dhe rindërtimi i trashëgimisë kulturore: masat e ndarjes së zonave; përfshirja në listën e trashëgimisë kulturore**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 13: Zgjerimi i përpjekjeve për mbrojtjen e objekteve religjioze nga incidentet eventuale, duke vazhduar procesin jetik të rindërtimit të kishave ortodokse serbe të dëmtuara.*

#### ***Korniza normative***

Legjislacioni për trashëgiminë kulturore<sup>79</sup> dhe lirinë e religjionit<sup>80</sup> siguron ruajtjen dhe qasjen në trashëgiminë kulturore dhe religjioze. Parimet dhe dispozitat për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë pjesë përbërëse e Kushtetutës<sup>81</sup> dhe e ligjit të zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.<sup>82</sup> Ligji i

<sup>76</sup> Shih raportin për ‘Kontaminimin me plumb në Mitrovicë/Mitrovica që prek komunitetin rom’, Misioni i OSBE në Kosovë, shkurt 2009.

<sup>77</sup> Deri në fund të vitit 2008, Departamenti i administratës civile të UNMIK-ut ka siguruar financim për menaxhim të kampit për Norwegian Church Aid. Në janar 2009, Ministria për komunitete dhe kthim ka kontraktuar Agjencinë Kosovare për Avokati dhe zhvillim për administrim e të dyja kampeve.

<sup>78</sup> Konferenca për shtyp e OBSH në Prishtinë/Priština, 31 janar 2009. Veç kësaj, më 27 mars 2009, Komisionari i Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut ka bërë thirrje për veprime të menjëhershme për romët e zhvendosur. Më 1 prill 2009, Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës ka publikuar një raport *ex officio* për hetimin e kontaminimit me plumb dhe ka bërë thirrje për risistemim të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm të popullatës rome që jeton në kampe.

<sup>79</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2006/52 për nxjerrjen e ligjit për trashëgiminë kulturore (Ligji për trashëgiminë kulturore), 6 nëntor 2006.

<sup>80</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2006/48 për nxjerrjen e ligjit për lirinë e religjionit në Kosovë (Ligji për lirinë e religjionit), 24 gusht 2006.

<sup>81</sup> Neni 9 i Kushtetutës.

<sup>82</sup> Neni 5, ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

zbatueshëm për zonat speciale të mbrojtura themelon zonat e mbrojtura përreth 45 lokacioneve,<sup>83</sup> kryesisht por jo ekskluzivisht<sup>84</sup> serbe ortodokse, dhe ndalon një varg të gjerë aktivitetesh në ato zona.<sup>85</sup> Ligji kërkon bashkëpunimin e komunave dhe të kishës ortodokse serbe për të siguruar mbrojtjen e lokacioneve religjioze ortodokse serbe dhe kushte për zhvillim harmonik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve që banojnë në zonat përreth. Themelimi i Këshillit për monitorim të implementimit (KMI) është nënvizuar për të siguruar konsultimet në lidhje me zonat jo-religjioze të mbrojtura.<sup>86</sup> Ligji i zbatueshëm për planifikimin hapësinor<sup>87</sup> parasheh përfshirjen e zonave speciale të mbrojtura në kuadër të planeve hapësinore të komunave relevante.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Instituti i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve (Instituti) mbikëqyr mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe religjioze përmes zyrave rajonale të tij. Institucionet komunale mund të autorizojnë ndërtimin apo aktivitetet tjera që mund të kenë ndikim në vlerën e zonës së mbrojtur, vetëm me pëlqimin me shkrim të Institutit.<sup>88</sup> Megjithatë, Instituti ka autoritet të limituar për të mbrojtur në mënyrë efektive lokacionet e trashëgimisë kulturore dhe religjioze dhe nuk mund tu ndalojë komunave lëshimin e lejeve të ndërtimit në zonat përreth objekteve të mbrojtura. Sipas observimeve të OSBE-së, 13 kanë dhënë leje ndërtimi që mund të prekin potencialisht mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe religjioze të rëndësisë së konsiderueshme për komunitetet jo-shumicë.<sup>89</sup> Veç kësaj, zyrat rajonale të Institutit kanë staf të limituar të ekspertëve, u mungojnë termat e qarta të referencës dhe së këndejmi kapaciteti për të ushtruar detyrat e mbrojtjes. Për më tepër, që nga shkurti i vitit 2008 Instituti nuk ka mbajtur kontakte me komunitetin serb të Kosovës, dhe ka bashkëpunim të limituar me komunitetet gorane, rome, ashkali, egjiptiane dhe turke (veçmas në Prizren). Ekzistojnë shqetësime për faktin që Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore (KKTK) nuk ka kompletuar ende listën e trashëgimisë kulturore dhe religjioze, në pritje të dorëzimit të listave lokale nga zyrat rajonale të Institutit.

Deri në shkurt 2009, policia e Kosovës ka qenë duke mbrojtur disa nga lokacionet e trashëgimisë kulturore dhe religjioze që më herët janë mbrojtur nga kompanitë private të sigurisë. Me një kërkesë të mëhershme, disa prej lokacioneve serbe ortodokse ruhen

---

<sup>83</sup> Neni 7 dhe aneksi, ligji i zbatueshëm për zonat speciale të mbrojtura.

<sup>84</sup> Për shembull, qendra historike e Prizrenit, Kompleksi i memorialit të Isa Boletinit në Zvečan/Zvečan dhe monumenti i Gazimestanit në Prishtinë/Priština, ura mesjetare e Vushtrrisë/Vučitrn dhe kalaja e Novobërdës/Novo Brdo.

<sup>85</sup> Sikur që është: ndërtimi i ndërtesave më të larta nga objektet nën mbrojtje, hapja e restoranteve, kafeneve, aktiviteteve rekreative, tubimet publike, eksploatimi i resurseve minerare, etj.

<sup>86</sup> Më 15 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për zonat speciale të mbrojtura. Në pajtim me nenin 4, KMI duhet të përbëhet nga shtatë anëtarë që përfshijnë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Institutin për mbrojtjen e monumenteve në Prishtinë/Priština, kishën ortodokse serbe, Institutin për mbrojtjen e monumenteve në Leposaviq/Leposavić, OSBE-në, Këshillin e Evropës dhe UNESCO-n.

<sup>87</sup> Më 17 nëntor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për planifikim hapësinor me të cilin ndryshohet ligji për planifikim hapësinor i nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/30, 10 shtator 2003 (ligji i zbatueshëm për planifikimin hapësinor).

<sup>88</sup> Neni 3(8), ligji për trashëgiminë kulturore.

<sup>89</sup> Kamenicë/Kamenica, Novobërdë/Novo Brdo, Viti/Vitina, Kaçanik/Kaçanik, Han i Elezit/Đeneral Janković, Shtërpçë/Štrpce, Ferizaj/Uroševac, Shtime/Štimlje, Gillogovc/Glogovac, Vushtrri/Vučitrn, Skenderaj/Srbica, Mamuša/Mamushë/Mamuša dhe Dragash/Dragaš.

edhe më tej nga KFOR-i.<sup>90</sup> Në vitin 2008 dhe 2009, janë shfaqur një numër incidentesh në lidhje me lokacionet kulturore dhe religjioze, veçmas ato ortodokse serbe. Dëmet përfshinin dëmtimin e rrethojave, dritareve, mureve të kishës, plaçkitejn e mureve nga bakri dhe gdhendje metali në gurët e varrezave. Në të njëjtën kohë, ka pasur disa shembuj pozitiv të ndjekjes dhe dënimit të kryesve të incidenteve të ngjashme në vitin 2008.<sup>91</sup> Pas trazirave të marsit 2004, Komisioni për implementim të rindërtimit për kishat ortodokse serbe<sup>92</sup> (Komisioni i rindërtimit) është themeluar dhe ka siguruar rehabilitimin e 11 kishave ortodokse serbe. Megjithatë, që nga shkurti i vitit 2008, kisha ortodokse serbe nuk ka bashkëpunuar me institucionet e Kosovës dhe vetëm kohët e fundit ka rinisur bashkëpunimin teknik me Ministrinë e Kulturës, rinisë dhe sporteve të Kosovës. Si rezultat, Komisioni ka publikuar një tender të ri për rindërtim më 8 qershor 2009.

Më 1 korrik 2008, komuna e Gjakovës/Đakovica ka shkelur të drejtat kulturore dhe religjioze të komunitetit serb duke mbuluar dhe transformuar themelet e Katedrales së trinisë së shenjtë në një park publik. Sidomos, katedralja e bërë rrafsh me tokë gjatë trazirave të marsit 2004, është zyrtarisht në listë si lokacion për rindërtim nga Komisioni i rindërtimit. Pas ankesës zyrtare nga kisha ortodokse serbe,<sup>93</sup> më 18 korrik 2008 PSSP kishte kërkuar nga Kryeministri i Kosovës “që të sigurojë respektin për të drejtat pronësore të kishës dhe të mbrojë lokacionin nën kornizën e programit për rindërtim të kishat ortodokse serbe të shkatërruara.” Megjithatë, deri më sot komuna nuk ka ndërmarrë hapa për restaurim të lokacionit të kishës së shkatërruar.

Fakti që Instituti ka aprovuar më 26 qershor 2009 projektin e komunës së Vushtrrisë/Vučitrn për ndërtim të një restoranti brenda zonës speciale të mbrojtur që rrethon urën e vjetër mesjetare Vojnoviq/Vojnović paraqet shqetësime të mëtejme. Ai lloj aktiviteti është i ndaluar në zonat speciale të mbrojtura dhe mund të aprovohet vetëm nga Këshillimi për monitorim të implementimit (KMI). Megjithatë, KMI nuk është themeluar ende dhe mbrojtja e plotë e zonave speciale të mbrojtura përmes masave të planifikimit hapësinor është në pritje të miratimit të planeve hapësinore në komunat përkatëse. Vetëm shtatë komuna kanë miratuar planet hapësinore të aprovuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ku përfshihen zonat speciale të mbrojtura.<sup>94</sup> Është ngritur një grup ndërministror për hartim të ligjit për zonën speciale të mbrojtur të qendrës historike të Prizrenit, që përfshin objektet e trashëgimisë kulturore dhe religjioze që janë me rëndësi të veçantë për komunitetet e

<sup>90</sup> KFOR-i ofron siguri për manastirin e Deçanit/Visoki Dečani, Patriarkanën e Pejës/Pećka Patrijaršija, manastirin e Goriçit/Gorioč në Istog/Istok, manastirin e Budisalcit/Budisavci në Klinë/Klina, manastirin e Graqanicës/Gračanica në Prishtinë/Priština, monumentin e Gazimestanit në Obiliq/Obilić, Shën Arkangjelin dhe Shën Cyriac në Prizren, Manastirin e Deviqit/Devič në Skenderaj/Srbica dhe manastirin e Sokolicës/Sokolica në Mitrovicë/Mitrovica.

<sup>91</sup> Gjykata e Qarkut Pejë/Peć, vendimi për dënim prej 42 muajsh për sulm me granatë dore kundër manastirit të Deçanit/Dečani në vitin 2007. Gjykimi kundër personit të dyshuar për vjedhje të materialit ndërtimor nga kisha ortodokse në Prizren.

<sup>92</sup> Komisioni është themeluar në qershor 2004 me marrëveshjen ndërmjet Institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe kishës ortodokse serbe për të mbikëqyrur procesin e riparimit dhe rindërtimit të objekteve të dëmtuara apo të shkatërruara gjatë trazirave të marsit 2004.

<sup>93</sup> Letra e peshkopit Teodosije për PSSP-në, 12 korrik 2008; dhe letra e përfaqësuesit të kishës ortodokse serbe për PSSP-në, 5 shtator 2008.

<sup>94</sup> Afati për komunat për hartim të planeve hapësinore është zgjatur me ligjin për ndryshim të ligjit për planifikim hapësinor, të nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2003/30, 10 shtator 2003. Këto komuna kanë miratuar planet hapësinore: Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Pejë/Peć, Istog/Istok, Mitrovicë/Mitrovica, Gillogovc/Glogovac, Deçan/ Dečane.

ndryshme. Komuna aktualisht po zhvillon planin e konservimit për qendrën historike të Prizrenit në bashkëpunim me UN Habitat.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Mbrojtja dhe konservimi i objekteve të trashëgimisë kulturore e të gjitha komuniteteve mbetet një sfidë. Implementimi i pamjaftueshëm i kornizës ligjore i ekspozon objektet e trashëgimisë kulturore dhe religjioze ndaj vandalizmit, dëmtimit dhe shkatërrimit, përfshirë këtu ndërtimet e ligjshme dhe të paligjshme pranë tyre. Për shkak të bashkëpunimit të pamjaftueshëm ndërmjet autoriteteve komunale, Institutit, dhe Këshillit të Kosovës për trashëgiminë kulturore, është arritur pak progres në përpilimin e një liste gjithëpërfshirëse të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe religjioze. Ekziston një vetëdijësim i pamjaftueshëm i publikut për trashëgiminë kulturore dhe religjioze të komuniteteve të ndryshme, dhe për detyrimin e qytetarëve për mbrojtjen e saj dhe për vlerën që ka ajo për shoqërinë kosovare.

## **4.2. Përkrahja për kulturat e komuniteteve numerikisht më të vogla**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 14: Rritja e masave për përkrahjen e kulturave të komuniteteve pakicë, përfshirë këtu ato numerikisht më të vogla, dhe sigurimi i pjesëmarrjes së personave që u takojnë komuniteteve pakicë në procesin relevant të vendimmarrjes.*

### ***Korniza normative***

Ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve mbron të drejtën e komuniteteve jo-shumicë për themelimin të shoqatave për shprehjen, ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së tyre. Këto mund të financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.<sup>95</sup> Kushtetuta u bën thirrje institucioneve të Kosovës që të sigurojnë kushte të cilat u mundësojnë komuniteteve ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identiteteve të tyre dhe të mbështesin iniciativat kulturore të komuniteteve përfshirë këtu ofrimin e asistencës financiare.<sup>96</sup> Ligji për institucionet e kulturës<sup>97</sup> rregullon kushtet, kriteret dhe procedurat për themelimin të institucioneve kulturore publike dhe private.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Në vitin 2009, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (Ministria e Kulturës), përmes Divizionit të sak për promovim të kulturës, ka alokuar një buxhet prej 325,000 eurosh në përkrahje të projekteve kulturore, sikur që janë koncertet, festivalet e teatri, filmi dhe folklorit, si dhe programet e TV-së për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ekspozitat. Kriteret e pranueshmërisë janë plotësuar nga 15 prej 39 projekteve që janë dorëzuar nga komunitetet jo-shumicë dhe këto janë financuar si duhet.<sup>98</sup>

Në nivel lokal, komunat nuk kanë themeluar ende institucionet e kulturës. Në aspektin pozitiv, komunat në rajonin e Prizrenit duket të jenë më aktivet në përkrahjen e iniciativave kulturore të komuniteteve jo-shumicë, ndonëse pa përkrahjen e nevojshme qendrore. Propozimi i komunës së Prizrenit për rritjen e buxhetit të saj për kulturën për vitin 2009 nga 103,000 në 260,00 euro është refuzuar nga autoritetet qendrore. Iniciativat kulturore komunale kanë si synim kryesisht komunitetet turke, boshnjake, rome, ashkali dhe egjiptiane. Disa iniciativa komunale janë organizuar për

<sup>95</sup> Neni 5, ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

<sup>96</sup> Neni 58(1) i kushtetutës.

<sup>97</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2006/44 për nxjerrjen e ligjit për institucionet e kulturës, 18 gusht 2006.

<sup>98</sup> Projektet e dorëzuara nga komuniteti serb (4), turk (3), rom (2), shqiptar (1), malazez (1) dhe boshnjak (1). Tri projektet tjera të pranueshme janë konsideruar shumëtnike.



të promovuar kulturën e serbëve të Kosovës, dhe nuk ka pasur ngjarje kulturore për mbështetjen e shqiptarëve që jetojnë në situatat jo-shumicë. Komunat kryesisht i financojnë iniciativat kulturore për shënimin e festave publike dhe religjioze. Organizatat e shoqërisë civile përgjithësisht dorëzojnë projekte përmes komiteteve të komunitetit apo në zyrat komunale të komiteteve.

#### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Me resurset financiare në dispozicion, Ministria e Kulturës përpiqet që përkrahë projektet e dorëzuara nga komunitetet jo-shumicë. Megjithatë, për shkak të qasjes reaguese dhe mungesës së aktiviteteve komunikuese për të informuar komunitetet e cenueshme apo ato më të vogla jo-shumicë, dhe për vlerësim të nevojave të tyre për mbrojtje të kulturës, fondet në dispozicion kanë tendencë të alokohen për asociacionet më të themeluara dhe më të organizuara të komiteteve. Nuk duket të ketë një politikë specifike apo koordinim me Ministrinë e Arsimit për të identifikuar dhe mbrojtur kulturat dhe gjuhët që janë në rrezik të zhdukjes (sikur që është turqishtja në Janjevë/Janjevo apo gjuha rome në pjesën veriperëndimore të Kosovës). Institucionet komunale nuk dedikojnë përpjekje të mjaftueshme dhe resurse, apo nuk sigurojnë përkrahje të mjaftueshme nga niveli qendror për të promovuar kulturat e komiteteve jo-shumicë. Problemet e mëdha si papunësia, çështjet e kthimit dhe pronës, janë më me prioritet nga promovimi i kulturës. Veç kësaj, mungesa apo iniciativat e dobëta nga komunitetet ndikojnë negativisht në zhvillimin e iniciativave domethënëse shumë-kulturore. Ndonëse buxhetet komunale përfshijnë alokime për kulturën, rininë dhe sportet, nuk ka dispozita normative që sigurojnë shpërndarjen e barabartë të këtyre fondeve për komunitetet jo-shumicë dhe për kulturat e tyre. Për të organizuar iniciativa që mundësojnë shprehjen dhe ruajtjen e kulturave të tyre, komunitetet jo-shumicë kryesisht mbështeten në kontributet financiare të organizatave ndërkombëtare. Kërkesat ligjore për themelim të institucioneve të kulturës duket se kërkojnë shumë në kontekst të resurseve dhe kapaciteteve të limituara.

#### **4.3. Kapacitetet dhe masat për të mbështetur transmetimet për dhe nga komunitetet jo-shumicë**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 15: Procedimi i shpejtë i aplikimit të vonuar për radio dhe TV licenca me qëllim të zgjerimit të shtrirjes dhe diversitetit të transmetimeve për dhe nga komunitetet pakicë, dhe ndërmarrja e hapave të mëtejshme për të siguruar që të gjitha komunitetet kanë qasje të barabartë në shërbimet e transmetuesve publik.*

#### ***Korniza normative***

Kushtetua dhe ligji i zbatueshëm për të drejtat e komiteteve u japin të drejtë komiteteve jo-shumicë që të kenë qasje në informata në gjuhën e tyre në mediat e shkruara dhe elektronike, të themelojnë mediat e tyre, të kenë qasje në një numër të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike, dhe qasje në përfaqësim të barabartë në mediat e transmetimit publik.<sup>99</sup> Radio Televizioni publik i Kosovës (RTK), është i obliguar tu ofrojë të gjitha komiteteve shërbime në gjuhët e tyre, me jo më pak se 10 për qind të buxhetit të saj për programet dhe 15 për qind të kohës së tij të programeve.<sup>100</sup> Transmetuesi publik duhet të mbulojë mbi 90 për qind të territorit dhe 90 për qind të zonave të banuara nga komunitetet jo-shumicë.<sup>101</sup> Pesë për qind e tarifës së transmetuesit publik duhet të alokohet për Fondin në mbështetje të medieve

<sup>99</sup> Neni 59(10) dhe (11), i Kushtetutës; neni 6(1) dhe (2), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komiteteve.

<sup>100</sup> Neni 6(6), Ligji për Radio Televizionin e Kosovës i nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/14, 11 prill 2006.

<sup>101</sup> Neni 8, Ligji për komisionin e pavarur të medias dhe për transmetimin.

për minoritetet, mediat multi-etnike dhe personat me paaftësi,<sup>102</sup> operimi dhe menaxhimi i të cilave është rregulluar nga Kryeministri në dhjetor 2008.<sup>103</sup> Qeveria është e obliguar të sigurojë një plan të frekuencës ndërkombëtare që i lejon komunitetit të serbëve të Kosovës qasje në një kanal të licencuar dhe të pavarur që operon në gjuhën serbe në tërë territorin e Kosovës.<sup>104</sup>

Komisioni i Pavarur për Media (Komisioni për Media) rregullon frekuencat e transmetimit, licencon transmetuesit publik dhe privat dhe zhvillon politikat e transmetimit, përmes një këshilli që duhet të përfshijë një përfaqësues të komuniteteve jo shqiptare dhe jo serbe të Kosovës.<sup>105</sup> Këshilli i medieve të shkruara të Kosovës<sup>106</sup> (Këshilli i medieve të shkruara) është asociacion i regjistruar i media të shkruara të Kosovës, që promovon dhe monitoron respektimin e Kodit të medieve të shkruara të Kosovës,<sup>107</sup> përfshirë këtu shqyrtimin e hollësishëm të ankesave dhe shqiptimin e gjobave në rast të shkeljeve sikur që janë fjalimet e urrejtjes dhe shpifjet.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Sinjali i shërbimit të transmetuesit publik mbulon prej 75<sup>108</sup> deri në 78<sup>109</sup> për qind të rajoneve të banuara dhe nuk është në dispozicion në komunat me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës (të banuar gjithashtu nga shqiptarët), rajonet e banuara nga komunitetet gorane dhe boshnjake në komunat e Dragashit/Dragaš dhe Prizrenit, që shkakton ankesa dhe pakënaqësi në mesin e këtyre komuniteteve.<sup>110</sup> Sipas raportit monitorues të Komisionit për Media për shërbimin e transmetuesit publik,<sup>111</sup> më pak se 12 për qind të programit ditor në RTK Radio dhe TV është në gjuhët jo-shqipe. Në kundërshtim me ligjin,<sup>112</sup> Radio Kosova nuk transmeton programe në gjuhët jo-shqipe në frekuencat e njëjta që përdoren për programet në gjuhën shqipe.<sup>113</sup> Programet për komunitetet jo-shqiptare transmetohen në frekuenca që nuk përdoren shpesh, pa sinjal të cilësisë së zërit dhe pa mbulim universal. Në pritje të qasjes në një plan të frekuencës ndërkombëtare, kanali televiziv në gjuhën serbe që mbulon tërë Kosovën nuk është siguruar dhe qeveria po shqyrton zgjidhjet alternative (televizioni kabllor).

Sipas Regjistrimit të Komisionit për Media për transmetuesit e licencuar në Kosovë, nga 114 transmetues të radios dhe TV-së (92 radio dhe 22 TV stacione), 77 transmetojnë

<sup>102</sup> Neni 20(11), Ligji për Radio Televizionin e Kosovës.

<sup>103</sup> Rregullorja e Kryeministrit Nr. 01/2008 për funksionim të fondit për përkrahjen e medieve të komuniteteve, atyre shumetnike dhe për personat në situatë të pafavorshme.

<sup>104</sup> Neni 59(11), i Kushtetutës; neni 6(5), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

<sup>105</sup> Neni 2 dhe 4(1), (4), (8), Ligji për Komisionin e pavarur për media dhe transmetimin, i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2005/34, 8 korrik 2005; neni 141 i Kushtetutës.

<sup>106</sup> Statuti i Këshillit të medieve të shkruara të Kosovës, Prishtinë/Priština, 10 gusht 2005. Tetë media të shkruara në gjuhën shqipe dhe katër në gjuhën jo-shqipe kanë nënshkruar statutin e tij.

<sup>107</sup> Kodi i shtypit për Kosovën, Prishtinë/Priština, 18 mars 2005.

<sup>108</sup> Raport i progresit të UNMIK-ut, 21 korrik 2008, fq. 27.

<sup>109</sup> Europe Aid, Doracak për të drejtat e minoriteteve, prill 2009, fq.16.

<sup>110</sup> Më 6 mars 2009, Këshilli i intelektualëve boshnjakë të Kosovës ka shprehur shqetësim specifik lidhur me tryezat e rumbullakëta të organizuara në luginën e Zhupës/Župa (Prizren) dhe në rajonin goran të Dragashit/Dragaš.

<sup>111</sup> Shih raportin për 'Monitorim të programit një mujor të transmetuesit publik të Kosovës – skema programore – pajtueshmëria me ligjin për RTK-në dhe rregullimi i reklamave,' Komisioni i Pavarur për Media, qershor 2009, fq 3.

<sup>112</sup> Neni 8, Ligji për Radio Televizionin e Kosovës.

<sup>113</sup> Programet në gjuhën shqipe transmetohen në valë të gjata FM dhe programet në gjuhët jo-shqipe transmetohen në valë të mesme 549.0 KHz./AM.

vetëm në një gjuhë (50 në gjuhën shqipe, 22 në gjuhën serbe, tri në gjuhën boshnjake, dhe nga një në gjuhën turke dhe gorane); 35 në më tepër se një gjuhë; dhe vetëm y në gjuhën shqipe dhe serbe (me program shtesë në gjuhën rome). Në korrik 2009, Komisioni për Media ka finalizuar lëshimin e licencave afatgjate të transmetimit. Ndërsa licencat afatgjate bëjnë zëvendësimin e licencave afatshkurtra për të gjithë transmetuesit aktiv, tre nga transmetuesit e medias në gjuhën serbe<sup>114</sup> nuk kanë aplikuar për këto licenca në mungesë të resurseve financiare. Prandaj, Komisioni për Media ka ndërprerë licencat e këtyre transmetuesve.<sup>115</sup>

Më 23 qershor 2009 Këshilli i medievetë shtypura të Kosovës ka gjobitur gazetën në gjuhën shqipe 'InfoPress' për nxitje të dhunës, rrezikim të lirisë së shprehjes dhe për shkaktim të kërcënimit ndaj gazetarit që pa argumente objektive, është përshkruar si "shërbëtor i policisë sekrete serbe" dhe ka kërcënuar me shkrim që ajo ka zgjedhur "të mos jetojë gjatë."<sup>116</sup> Artikujt e përshkruar përcjellin gjithashtu një ndjenjë të vazhdueshme të armiqësisë kundër komunitetit të serbëve të Kosovës dhe janë në kundërshtim me frymën e raporteve paqësore ndëretnike. Në një njoftim për shtyp të 10 qershorit 2009, Komisioni për Media i ka quajtur këto kërcënime si të papranueshme dhe shumë të dënueshme në një shoqëri demokratike dhe u ka bërë thirrje të gjitha institucioneve të Kosovës që të merren seriozisht me incidentin.

Më 9 qershor 2009, Fondi për mbështetje për mediat minoritare, multi-etnike dhe të grupeve të tjera speciale<sup>117</sup> ka njoftuar përzgjedhjen e 15 projekteve në fushat me prioritet që nuk janë të mbuluara nga shërbimi i transmetuesit publik. Projektet e nominuara, të dorëzuara nga mediat në gjuhën serbe (7), boshnjake (3) dhe rome (1), iniciativat multi-etnike (3) dhe mediat që i përfaqësojnë personat me nevoja speciale (1), presin aprovimin final nga Kryeministri.

### ***Vlerësim i gjithëmbarshtëm***

Nevojiten masa të mëtejme konkrete për implementim të kornizës normative dhe për të përkrahur shërbimin multi-kulturor të transmetuesit publik. Pagesat mujore të mbledhura nga Korporata Energjetike e Kosovës për ofrimin e shërbimeve të RTK-së janë vënë edhe për komunitetet që nuk mbulohehen nga ky shërbim. Transmetimi publik në radio në gjuhët jo-shqipe është joadekuat. Mungesa apo shërbimet e pakënaqshme të transmetuesit publik rrisin ndjenjën e diskriminimit. Këshilli i medievetë shtypura dhe Komisioni për Media kanë reaguar në mënyrë adekuate kundër artikujve në shtyp me të cilët kërcënohet liria e shprehjes së gazetarëve dhe që janë në kundërshtim me frymën e një shoqërie demokratike ndëretnike.

---

<sup>114</sup> Radio Indeksi (Kamenicë/Kamenica), Radio M (Babimoc/Babin Most, Prishtinë/Priština), TV 3K (Mitrovicë/Mitrovica).

<sup>115</sup> Shih <http://www.imc-ko.org/index.php?id=624&l=a&p=7>.

<sup>116</sup> Vendim i Këshillit të medievetë shtypura të Kosovës në ankesën e parashtruar nga znj. Jeta Xharra, kundër gazetës InfoPress, 23 qershor 2009. Shih <http://www.presscouncil-ks.org/?cid=2,15,216>. Vendimi u referohet artikujve të InfoPress: "Lushtaku: Jeta Xharra është shërbëto e policisë sekrete serbe" – citim i deklaratës së kryetarit të komunës së Skenderajt/Srbica (2 qershor 2009) dhe "Katër tradhtitë e Jetës" (4 qershor 2009).

<sup>117</sup> Komisioni i fondit përbëhet nga përfaqësuesit e qeverisë, medias, Komisionit për Media dhe Këshillit të medievetë shtypura (katër shqiptarë, një serb dhe një komisionar boshnjak).

## 5. PËRDORIMI I GJUHËVE

### 5.1. Miratimi, monitorimi dhe implementimi i legjislacionit

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 16: Miratimi i legjislacionit të ri për gjuhët për të përmirësuar qartësinë dhe sigurinë ligjore sa i përket përdorimit të gjuhëve, në raportet me autoritetet administrative, shenjat topografike, dhe regjistrimin e emrave personal, dhe monitorimi nga afër i pajtueshmërisë me kërkesat për gjuhët në sektorët relevant, duke përfshirë gjyqësinë.*

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 17: Sigurimi që miratimi i legjislacionit të ri për gjuhët do të përcillet me kapacitetet adekuate të implementimit dhe që procedurat, përfshirë këtu procedurat gjyqësore, janë në vend në rast të mos pajtueshmërisë me kërkesat për gjuhët, përfshirë këtu ndryshimet e paligjshme të emrit të vendeve.*

#### **Korniza normative**

Gjuha shqipe dhe serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë.<sup>118</sup> Kushtet për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve të komuniteteve të tjera para autoriteteve komunale janë specifikuar me ligj.<sup>119</sup> Kushtetuta siguron të drejta gjuhësore të gjera<sup>120</sup> për komunitetet. Ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve<sup>121</sup> kërkon masa afirmative për të siguruar ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve jozyrtare. Disa komuna kanë miratuar rregullore komunale për përdorimin e gjuhëve.<sup>122</sup> Ligji i zbatueshëm për kufijtë e komunave definon emrat zyrtarë të zonave kadastrale, të komunave, qyteteve dhe fshatrave. Në pajtim me ligjin e zbatueshëm për kartat e identitetit, kartat e identitetit duhet të lëshohen edhe në gjuhët zyrtare shtesë të komunave.<sup>123</sup> Emrat personal duhet të regjistrohen sipas alfabetit dhe shkrimit të gjuhës amtare apo zyrtare të zgjedhur.<sup>124</sup> Procedimet në gjykata zhvillohen në gjuhë(t) zyrtare<sup>125</sup> të zgjedhura nga palët,<sup>126</sup> me asistencë pa pagesë për interpretim/përkthim nëse kërkohet.<sup>127</sup> Personat që u takojnë komuniteteve kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirshëm në të gjitha kontaktet me gjyqësorin; përfshirë këtu dorëzimin dhe pranimin e dokumenteve, gjatë seancave dhe kudo në gjykata apo zyrat e prokurorisë.<sup>128</sup> Të gjitha shenjat, njoftimet dhe buletinet e gjykatës duhet të jenë në gjuhët zyrtare, dhe kostoja e përkthimit duhet të merret përsipër nga gjykatat dhe zyrat e prokurorisë.<sup>129</sup> Miratimi i ligjit për gjykatat pritet të bëhet. Këshilli Gjyqësor i

<sup>118</sup> Neni 2(1), Ligji për gjuhët; neni 5 i Kushtetutës.

<sup>119</sup> Neni 2(3) dhe (4), Ligji për gjuhët. Nenet 7 dhe 9 specifikojë të drejtat e personave gjuha e të cilëve është gjuhë zyrtare dhe neni 8 përcakton të drejtat e personave gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar.

<sup>120</sup> Nenet 59(5),(6),(8) dhe (9) të Kushtetutës.

<sup>121</sup> Neni 4(9), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

<sup>122</sup> Rregulloret që kërkohen me nenin 2(4), të ligjit për gjuhët dhe nenin 9(2), të ligjit të zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale.

<sup>123</sup> Më 13 tetor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për kartat e identitetit (ligji i zbatueshëm për kartat e identitetit). Neni 9, ligji i zbatueshëm për kartat e identitetit.

<sup>124</sup> Neni 27, Ligji për gjuhët; neni 6, Ligji për emrat personal i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2008/11, 22 shkurt 2008.

<sup>125</sup> Gjuha shqipe, serbe, angleze, dhe në rajonet ku jeton komuniteti turk, gjuha turke. Neni 5, rregullorja e UNMIK-ut 2006/25 për kornizën rregullatore për sistemin e drejtësisë në Kosovë, 27 prill 2006; neni 2 dhe 12, Ligji për gjuhët; neni 5 i kushtetutës.

<sup>126</sup> Neni 13, Ligji për gjuhët.

<sup>127</sup> Nenet 13, 15 dhe 16, Ligji për gjuhët; neni 15, rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 për Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, i ndryshuar (KPPK); dhe neni 30(1) dhe (4), i Kushtetutës.

<sup>128</sup> Neni 5, rregullorja e UNMIK-ut 2006/25 për kornizën rregullatore për sistemin e drejtësisë në Kosovë; neni 14, Ligji për gjuhët; neni 15, KPPK, për procedimet penale, 6 korrik 2003; neni 6, ligji i zbatueshëm për procedurën kontestimore, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 29 korrik 2008, për procedimet civile.

<sup>129</sup> Neni 5, rregullorja e UNMIK-ut 2006/25 për kornizën rregullatore për sistemin e drejtësisë në Kosovë, 27 prill 2006.

Kosovës organizon përkthimet në gjykata dhe angazhimin e përkthyesve<sup>130</sup> por nuk ka iniciuar akte nënligjore për të rregulluar kushtet minimale dhe ekzaminimin e rregullt. Qeveria ka themeluar tri organe për monitorim të përdorimit të gjuhëve.<sup>131</sup> Komisioni për gjuhët ka autoritetin për të shqiptuar sanksione administrative ndaj shkeljeve të ligjit<sup>132</sup> dhe është i obliguar të dorëzojë një raport vjetor para Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për masat ligjore dhe masat tjera të ndërmarra për implementim të ligjit.<sup>133</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Nuk ka një sistem adekuat të koordinuar për të monitoruar implementimin e ligjit për gjuhët dhe nuk janë alokuar resurse adekuate njerëzore dhe financiare. Sistemet ekzistuese të edukimit nuk mundësojnë mbajtje të mësimin në të dy gjuhët zyrtare. Studentët që ndjekin plan programet serbe mbajnë mësim në gjuhën serbe dhe nuk parashihet mësimi i gjuhës shqipe, ndërsa nxënësit që mësojnë sipas plan programeve të Kosovës kryesisht ndjekin mësimin në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhët boshnjake apo turke, por nuk parashihet mësimi i gjuhës serbe.

Zvogëlimi shqetësues i numrit të asistentëve gjuhësor rrezikon implementimin e ligjit për gjuhët.<sup>134</sup> Dhjetë komuna nuk kanë fare asistentë të gjuhës, ndërsa komunat me numër të mjaftueshëm të asistentëve të gjuhës kanë shënuar rënie nga 11 (në vitin 2008) në 4 (në qershor 2009), për shkak të mos zëvendësimit të stafit të largua apo për shkak të mos zgjatjes apo skadimit të kontratave. Mungesa e trajnimit të rregullt sistematik për asistentët e gjuhës në administratën publike ndikon në cilësinë e shërbimeve të tyre.

Komisioni për gjuhët nuk ka buxhetin e tij, resurset dhe hapësirat për zyra, dhe duhet të sigurojë implementimin e mandatit të tij. Përbërja e Komisionit nuk siguron pjesëmarrjen efektive e të gjitha komuniteteve linguistike.<sup>135</sup> Deri në qershor 2009, qeveria duhet të zhvillojë fushatën e informimit publik që kërkohet menjëherë pas shpalljes së ligjit për gjuhët.<sup>136</sup>

Deri në qershor 2008 vetëm një komunë (Klinë/Klina) ka miratuar rregulloren komunale për përdorim të gjuhëve, ashtu si kërkohet me ligj. Pas shpalljes së ligjit të zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale, deri në korrik 2009, 16 komuna kanë miratuar

---

<sup>130</sup> Neni 1(4), rregullorja e UNMIK-ut 2005/52 për themelimin të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 20 dhjetor 2005.

<sup>131</sup> Neni për përfshirje të komuniteteve dhe për përdorim të gjuhëve zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Shërbimeve Publike, Udhëzimi Administrativ Nr. 2006/10 për rregullat dhe procedurat e punës të Njësisë së monitorimit për përdorim të gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore të Kosovës; Udhëzim Administrativ i Zyrës së Kryeministrit Nr. 03/2007 Përbërja dhe kompetencat e Komisionit për gjuhët. Komisioni ka mbajtur takimin e parë të tij në maj të vitit 2007.

<sup>132</sup> Ministria e Shërbimeve Publike, Udhëzimi Administrativ nr. 2007/01 për përcaktimin e sanksioneve administrative për shkeljen e ligjit për gjuhët.

<sup>133</sup> Neni 32(11), Ligji për gjuhët.

<sup>134</sup> Të 33 komunat kanë punësuar 40 asistentë gjuhësorë në qershor 2009 për dallim nga 54 në shtator 2007, ndërsa asistentët gjuhësorë nëpër ministri janë reduktuar nga 40 në 37 pas krijimit të dy ministrive të reja. Në 63 gjykatat dhe zyrat e prokurorisë, janë vetëm 58 asistentë gjuhësorë shqip/serbisht.

<sup>135</sup> Ndërsa neni 32(10) i Ligjit për gjuhët kërkon që përbërja e Komisionit të vendoset “duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve gjuhësore në Kosovë, dhe duke marrë parasysh nevojën për të pasqyruar diversitetin linguistik të komuniteteve në Kosovë,” Udhëzimi Administrativ i Kryeministrit nr. 2003/07 rezervon nominimin dhe përfaqësimin në gjashtë ministri dhe në Kuvendin e Kosovës, pa konsultim të komuniteteve linguistike.

<sup>136</sup> Neni 36(2), Ligji për gjuhët.

rregulloret komunale për gjuhët dhe gjashtë tjera kanë qenë duke i përpiluar ato. Megjithatë, shumica e rregulloreve komunale nuk përmbajnë procedura konkrete për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve, për mekanizmat e implementimit, monitorimit dhe të raportimit, dhe për mjetet juridike.<sup>137</sup>

Megjithatë komunat e ndryshme<sup>138</sup> kanë njohur gjuhët zyrtare shtesë në statutet e reja të komunave apo me vendimet tjera komunale në vitin 2007 dhe 2008. Komuna e Gjilanit/Gnjilane dhe ajo e Mitrovicës/Mitrovica, Prishtinës/Priština dhe Vushtrria/Vučitrn, kanë njohur gjuhën turke si gjuhë në përdorim zyrtar, dhe një kërkesë tjetër për njohje të tillë është në pritje të vendimit në Lipjan/Lipljan.<sup>139</sup>

Ministria e Punëve të Brendshme nuk lëshon karta të identitetit në gjuhën turke si gjuhë zyrtare në Prizren dhe Mamushë/Mamuša/Mamuša. Emrat personal regjistrohen automatikisht vetëm në gërmat latine dhe nganjëherë nuk respektojnë sistemin e shkrimit apo alfabetin e gjuhës zyrtare apo të komunitetit që është zgjedhur nga personi në kartat e identitetit, dokumentet e udhëtimit dhe në certifikatat e gjendjes civile.

Komunat e ndryshme vazhdojnë të pranojnë dokumente nga institucionet qendrore vetëm në gjuhën shqipe, apo me përkthim të dobët në gjuhën serbe.<sup>140</sup> Një numër i komunave<sup>141</sup> nuk i kanë përkthyer të gjitha apo pjesën më të madhe të rregulloreve dhe vendimeve të tyre në gjuhën serbe. Si shembull pozitiv, në Prizren, Dragash/Dragaš, Pejë/Peć dhe Mamushë/Mamuša/Mamuša, aktet komunale janë përkthyer gjithashtu në gjuhët zyrtare shtesë. Me përjashtim të Pejës/Peć dhe Dragashit/Dragaš, vendimet komunale për emrat e rrugëve, emrat e pjesës më të madhe të rrugëve dhe të shesheve publike janë vetëm në një nga gjuhët zyrtare. Ministria e Transportit dhe Komunikacionit përgjithësisht siguron shfaqjen e shenjave topografike në të dy gjuhët zyrtare përgjatë rrugëve rajonale, por nuk është gjithëherë proaktive në pastrimin apo zëvendësimin e shenjave të bëra të palexueshme. Ka një trend të disa ueb faqe të ministrive dhe në raportet qeveritare për ti përdorur emrat shqiptarë jozyrtar të vendeve.<sup>142</sup>

Procedimet e gjykatave kryesisht zhvillohen në gjuhën shqipe, me interpretimin/përkthimin që sigurohet për palët që e kërkojnë atë. Përkthyesit normalisht u sigurojnë palëve përkthimet me shkrim të dokumenteve më relevante të

<sup>137</sup> Të gjitha rregulloret nuk përfshijnë procedura për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve në përdorim zyrtar, të përcaktuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

<sup>138</sup> Gjuha boshnjake është njohur si zyrtare në Pejë (vendimi i komunës nga viti 2003), Prizren (statuti i komunës i vitit 2008), Dragash/Dragaš (statuti i komunës) dhe si gjuhë në përdorim zyrtar në Istog/Istok (statuti i komunës i vitit 2008). Turqishtja është njohur si gjuhë zyrtare në Prizren (neni 2(3), ligji për gjuhët dhe statuti i komunës) dhe Mamushë/Mamuša/Mamuša (statuti i komunës).

<sup>139</sup> Më 14 korrik 2009, komuniteti turk i Kosovës që jeton tradicionalisht në Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljan) ka kërkuar njohjen e gjuhës së tij si gjuhë në përdorim zyrtar.

<sup>140</sup> Shih raportin për 'Implementim të ligjit për gjuhët nga komunat e Kosovës', Misioni i OSBE-së në Kosovë, qershor 2008, fq. 8.

<sup>141</sup> Han i Elezit/Đeneral Janković, Kaçanik/Kaçanik, Novobërdë/Novo Brdo, Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn, Junik, Glogoc/Glogovac, Shtime/Štimlje, Malishevë/Mališevo, Suharekë/Suva Reka.

<sup>142</sup> Qershor 2009, raporti i qeverisë për vitin 2008 nga Zyra e Kryeministrit ([http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/raporti\\_vjetor\\_i\\_punes\\_se\\_qeverise\\_2008.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/raporti_vjetor_i_punes_se_qeverise_2008.pdf)), portali i qeverisë (<http://www.rks-gov.net/sq-AL/Pages/InstitucioneteKosoves.aspx#>) dhe ueb faqet e Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal (<http://www.ks-gov.net/mapl/Komunat.aspx>) kanë përmbajtur emrat jozyrtar si Dardana/Kamenica, Artana/Novobërda, Kastriot/Obiliq, Drenas/Gllgoc, Istog/Burim, Podujeva/Besiana dhe Theranda/Suharekë.

dosjes së lëndës. Kapaciteti i pamjaftueshëm për përkthimin e dokumenteve të tjera mund të shkaktojë vonesa procedurale.

Në 63 gjykatat funksionale të Kosovës dhe në zyrat e prokurorive, janë 58 poste të përkthyesve/interpretuesve në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Shumica e gjykatave dhe e zyrave të prokurorisë kanë një asistent gjuhësor për gjuhët shqipe dhe serbe. Në gjykatën e qarkut në Prizren, është buxhetuar vetëm një pozitë e përkthyesit shqip-turqisht. Gjykatat dhe zyrat e prokurorisë pa asistentë gjuhësor shqip-serbisht, u drejtohen aranzhimeve *ad hoc* sikur që është huazimi i përkthyesve nga zyrat tjera, apo kërkojnë nga nëpunësit e gjykatës që të ofrojnë përkthime/interpretime kur ka nevojë. Këto janë joadekuate, veçmas në komunat në të cilat banojnë komunitetet më të mëdha jo-shumicë.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Kërkesat ndërkombëtare lidhur me të drejtat linguistike të komuniteteve jo shqiptare plotësohen me kornizën rregullatore. Megjithatë, institucionet e Kosovës nuk kanë siguruar implementimin e mjaftueshëm. Implementimi minimal i standardeve të përdorimit të gjuhëve, qasja e barabartë në shërbimet publike shumë-gjuhësore dhe pjesëmarrja efektive nga përdoruesit e gjuhëve jo-shumicë, mund të rrezikohet nëse nuk sigurohen resurse adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar cilësinë e përkthimit në gjykata dhe në shërbimin civil qendror dhe komunal. Shkurtime të vazhdueshme të buxhetit janë duke ndikuar negativisht në implementimin e ligjit për gjuhët. Mungesa e përkrahjes logjistike dhe financiare dhe e bashkëpunimit nga institucionet e degës ekzekutive dhe legjislativë, nuk i mundësojnë Komisionit për gjuhët që të bëhet një mekanizëm efektiv i monitorimit dhe zhvillimit të politikave. Korniza ligjore dhe plan programet e diplomimit janë të nevojshme për të siguruar trajnimin, ekzaminimin dhe standardet profesionale në përkthyesve në gjykata dhe në administratën publike.

## **5.2. Përdorimi i gjuhëve jo-shumicë në vendet publike**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 18: Të siguroarit që miratimi i legjislacionit të ri për gjuhët do të përcillet me kapacitete adekuate për implementim dhe që procedurat, përfshirë këtu procedurat gjyqësore, do të jenë në vend në rast të mos pajtueshmërisë me kërkesat rreth gjuhës, përfshirë këtu ndryshimet e paligjshme të emrave të vendeve.*

### ***Korniza normative***

Ligji për gjuhët dhe ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve promovojnë dhe mbrojnë krijimin e një mjedisi ku të gjitha komunitetet mund të shprehin lirshëm dhe të ruajnë identitetin linguistik të tyre, dhe lirinë e shprehjes linguistike.<sup>143</sup>

### ***Implementimi /Situata në terren***

Më apo menjëherë para vitit 2008 dhe 2009, janë raportuar disa incidente lidhur me përdorimin e gjuhëve jo-shumicë në vendet publike. Megjithatë, incidentet vazhdojnë ti kenë si cak dhe të krijojnë pasiguri në mesin e komunitetit të serbëve të Kosovës (dhe kohët e fundit tek romët). Herë pas here, edhe shqiptarët e Kosovës bëhen cak i këtyre incidenteve.<sup>144</sup> Ndërsa përdorimi publik i gjuhëve jo-shumicë mbizotëron në të

<sup>143</sup> Neni 4(2), ligji për të drejtat e komuniteteve; neni 1(1) (iii), 3(1), 29(1) Ligji për gjuhët.

<sup>144</sup> Më 18 gusht 2009, në urën kryesore në Mitrovicë/Mitrovica, dy shqiptarë kosovarë duke kaluar urën nga jugu në veri, gjoja janë ndaluar nga një oficer i policisë që u ka thënë se pjesa veriore është

gjitha apo në shumicën e komunave multi-etnike të rajoneve të Prishtinës/Priština,<sup>145</sup> Prizrenit dhe Gjilanit/Gnjilane, instancat e përmirësimit gradual nuk vlejnë njëlloj për të gjitha komunitetet. Në Gjilan/Gnjilane, përdorimi i gjuhëve serbe apo turke në publik është përmirësuar, përfshirë edhe nga ana e romëve, por disa serbë kanë shqetësime sa i përket sigurisë dhe kufizojnë lëvizjet dhe përdorimin e gjuhës në disa zona, apo ndeshen me vështirësi për të komunikuar me shqiptarët e rinj që nuk flasin gjuhën serbe.

Disa komuna kanë ndërmarrë iniciativa të lavdërueshme për të riinstaluar shenjat topografike dygjuhësore të dëmtuara të Manastirit të Deçanit/Dečani dhe kanë lëshuar deklarata publike me të cilat kërkojnë respekt për komunitetet jo-shumicë, dhe për serbët e Kosovës në veçanti (Deçan/Dečani dhe Klinë/Klina).

Përkundër mungesës së incidenteve të raportuara, në disa raste dhe lokacione komunitetet jo-shumicë përmbahen nga përdorimi i gjuhëve të tyre në publik. Për shembull, në Viti/Vitina, serbët, kroatët dhe romët limitojnë përdorimin e gjuhëve të tyre në zonat e banuara nga popullata shumicë në minimumin e domosdoshëm. Situata është edhe më alarmuese kur bëhet fjalë për shfaqjen e simboleve dhe të shkrimeve, të cilat këto komunitete i shmangin në tërësi në zonat e banuara nga popullata shumicë. Përvojat negative nga e kaluara ushqejnë ende ndjenjën e pasigurisë. Hezitimi për të përdorur gjuhët serbe dhe boshnjake është i dukshëm në komunat e Malishevës/Mališevo dhe të Suharekës/Suva Reka.

Serbët dhe shqiptarët e Kosovës që jetojnë në vendbanime të ndara mono-etnike rrallëherë i vizitojnë qytezat apo fshatrat e banuara nga shumica. Serbët që jetojnë në fshatrat e largëta të Bajës/Banja dhe Syrganës/Suvo Grlo (Skenderaj/Srbica) dhe në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn janë të izoluar dhe rrallëherë udhëtojnë në qytetet e banuara kryesisht nga shqiptarët. Vizitat në qytetin e Ferizajt/Uroševac nga serbët e kthyer në fshatrat fqinje janë kryesisht të limituara në ndërtesën e komunës apo pranë saj. Gjoja, incidentet e kohëpaskohshme (përgjithësisht të pa raportuara) të kërcënimit verbal, frenojnë përdorimin në publik të gjuhës serbe apo shtyjnë kthimin në gjuhën shqipe, nëse kjo gjuhë flitet nga personat në fjalë. Në komunat me shumicë serbe të Zubin Potokut dhe Zveçanit/Zvečan, popullata e fshatrave të banuara me shqiptarë nuk merr pjesë në jetën publike dhe ka pak ose aspak bashkëveprim me shumicën serbe. Zyrtari shqiptar komunal për komunitetet i shoqëron shpesh shqiptarët gjatë vizitave të rralla të tyre në komunën e Zveçanit/Zvečan.

Ka më tepër bashkëveprim në qytezën e Shtërpçës/Štrpce, ku në ditët e punës, shqiptarët lëvizin dhe përdorin lirshëm gjuhën e tyre, ndonëse ata komunikojnë në gjuhën serbe me serbët lokal. Në komunën me popullatë të përzier të Novobërdës/Novo Brdo, serbët janë në gjendje të komunikojnë në gjuhën e tyre në tërësi komunën. Serbët dhe romët vazhdojnë të shfrytëzojnë linjat e autobusit humanitar, ndonëse në masë më të vogël në disa nga rrugët e reja që përdoren

---

tokë serbe dhe që vetëm gjuha serbe apo angleze janë të lejuara. Raporti javor për sigurinë, Misioni i OSBE-së në Kosovë, qendra e situatave, 12–18 gusht 2009.

<sup>145</sup> Banorët nga të gjitha komunitetet e përdorin gjuhën e tyre gjatë ditës së tregut në qendër të Lipjanit/Lipljan. Banorët serbë, boshnjakë dhe romë nga vendbanimet e ndryshme të komunës dalin për shitblerje për çdo ditë në qendër të qytetit dhe në tregun e Obiliqit/Obilić, dhe përdorin gjuhët serbe, boshnjake dhe rome veçmas nëpër dyqane. Pas zhvendosjes së tregut multi-etnik të Bresjes/Bresje në qytetin e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, serbët dhe romët vazhdojnë ta vizitojnë tregun e ri dhe ta përdorin lirshëm gjuhën e tyre.



kryesisht nga shqiptarët që udhëtojnë drejt Prishtinës/Priština. Megjithatë, pasagjerët dhe nxënësit serbë që i përdorin këto linja flasin lirshëm në serbishte me vozitësit dhe nuk duket se ndjejnë pasiguri apo shqetësime.

Në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, boshnjakët përdorin përgjithësisht gjuhën shqipe. Turqit flasin lirshëm turqishten në publik por kryesisht përdorin gjuhën shqipe në komunikim me shumicën shqiptare. Në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, turqit kufizojnë përdorimin e gjuhës së tyre në lagjet etnikisht të përziera, jashtë të cilave dalin rrallë.

Në Prizren dhe Rahovec/Orahovac, serbët përdorin lirshëm gjuhën e tyre në publik, njëlloj si turqit dhe boshnjakët në Prizren dhe goranët e boshnjakët në Dragash/Dragaš. Gjuha romë përdoret vetëm në sferat private dhe të komunitetit në Prizren, por me sa duket edhe publikisht në Suharekë/Suva Reka dhe në Mamushë/Mamuša/Mamuša.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Ndërsa periudha e raportimit është karakterizuar nga një numër i vogël i incidenteve që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës, frikësimet e nivelit të ulët mund të kalojnë të pa raportuara dhe përmbajtja nga përdorimi i gjuhëve jo-shumicë është e pranishme në rajonet specifike. Incidentet vazhdojnë ti kenë si cak serbët dhe në disa raste komunitetin rom. Ekziston nevoja për iniciativa më proaktive dhe konsistente nga autoritetet komunale për dënim të incidenteve dhe për promovim të tolerancës dhe besimit, veçmas në komunat një etnike dhe në lokacionet ku kthimet janë të limituara. Dalja më e shpeshtë e policisë së Kosovës në komunitetet jo-shumicë dhe ndërjegjësimi mund të ndihmojnë raportimit e rasteve të kërcënimeve të nivelit të ulët të cilat mund të kenë ndikim në përdorimin publik të gjuhëve jo-shumicë. Ekziston nevoja për të siguruar që kërcënimet në lidhje me përdorimin e gjuhëve të klasifikohen, të hetohen dhe të ndiqen penalisht si incidente apo krime potencialisht me motive etnike, në vend se si kundërvajtje të përgjithshme.

## **6. EDUKIMI**

### **6.1. Mundësitë për bashkëveprim ndërmjet fëmijëve të komuniteteve shqiptare dhe serbe dhe për eliminim të barrierave linguistike**

*Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë, rekomandimi nr. 19: Shqyrtimi i mënyrave për krijim të mundësive për bashkëveprim ndërmjet nxënësve nga komunitetet serbe dhe shqiptare, dhe dizajnimi i një plani gjithëpërfshirës që do të largonte gradualisht barrierat, përfshirë këtu ato linguistike, ndërmjet nxënësve nga komunitetet e ndryshme.*

#### ***Korniza normative***

Mundësitë për edukim multi-lingual, që përfshin të mësuarit e të dy gjuhëve zyrtare nuk janë siguruar me kornizën normative. Nxënësit mund të marrin arsimimin në gjuhën zyrtare të zgjedhur nga ta në të gjitha nivelet,<sup>146</sup> por nuk kanë mundësi apo obligim të mësojnë gjuhën tjetër, që zvogëlon mundësitë për komunikim ndërmjet nxënësve shqiptarë dhe serbë. Fëmijët gjuha e të cilëve nuk është zyrtare kanë të

<sup>146</sup> Neni 4(4b), Korniza kushtetuese; neni 19(1) i ligjit për gjuhët; neni 8(1) i ligjit të zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve; neni 59(2) i Kushtetutës.

drejtë në edukimin fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre amtare dhe janë të obliguar të mësojnë një nga gjuhët zyrtare sipas zgjedhjes së tyre.<sup>147</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Në praktikë, operojnë dy sisteme të ndara arsimore në Kosovë, ku njëri i raporton Ministrisë së Kosovës për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT) dhe tjetra Ministrisë serbe të Arsimit. Përmes ndarjes fizike (shkollat e ndara) dhe linguistike, të dy sistemet arsimore bëjnë dhe forcojnë ndarjen ndërmjet nxënësve shqiptarë dhe serbë. Nxënësit e komuniteteve të tjera gravitojnë përreth sistemit kosovar apo tij serb, varësisht nga faktorët gjeografik, linguistik dhe të identitetit. Shumë pak shkolla bëjnë kombinimin e nxënësve shqiptarë dhe serbë në ndërrime të veçanta dhe me pak ose aspak bashkëveprim.<sup>148</sup>

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Ekziston nevoja për iniciativa të qëndrueshme për adresim të barrierave që vazhdojnë të pengojnë integrimin dhe bashkëveprimin e nxënësve dhe mësimit të plan programit mësimor kosovar dhe atij serb. Plan programet mësimore serbe dhe kosovare nuk sigurojnë të mësuarit e të dy gjuhëve zyrtare.<sup>149</sup> Prandaj, gjeneratat e ardhshme nuk do të jenë në gjendje të komunikojnë me njëra tjetrën, shërbimit civil të Kosovës do ti mungojnë shërbuesit civil dygjuhësor, dhe implementimi i ligjit për gjuhët do të jetë në rrezik.

## **6.2. Masat për akomodim të shqetësimeve rreth edukimit të personave që u takojnë komuniteteve jo-shumicë**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 20: Akomodimi i shqetësimeve të personave që u takojnë komuniteteve pakicë dhe fëmijë në përdorim e masave që do të mund të zvogëlonin kërkesën për ruajtjen e sistemit arsimor paralel.*

### ***Korniza normative***

Legjislacioni i miratuar në vitin 2008<sup>150</sup> u mundëson shkollave që ofrojnë edukimin në gjuhën serbe që të përdorin plan programin dhe tekstet shkollore, me aprovim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Komisioni i pavarur për shqyrtim të materialeve mësimore në gjuhën serbe<sup>151</sup> (Komisioni i pavarur) është themeluar në prill të vitit 2009. Përmes Komisionit të pavarur, MASHT-i synon të zhvillojë një plan program mësimor në gjuhën serbe deri në vitin 2010/11. Korniza ligjore e zbatueshme<sup>152</sup> i atribuon kompetenca të shtuara për edukimin terciar

<sup>147</sup> Neni 21(1), Ligji për gjuhët; neni 8(10), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Udhëzimi Administrativ nr. 10/2007 për të mësuarit në gjuhën zyrtare të zgjedhur.

<sup>148</sup> Shih raportin për 'komunitetet jo-shumicë të Kosovës brenda sistemeve të arsimit fillor dhe të mesëm,' Misioni i OSBC-së në Kosovë, prill 2009, faqe 15 deri në 17.

<sup>149</sup> Përjashtimi i vetëm është i dukshëm në Dragash/Dragaš, ku nxënësit goranë që mësojnë me plan programet serbe mbajnë dy orë opsionale të gjuhës shqipe në javë për klasat 3-8.

<sup>150</sup> Në rast se tekstet shkollore sipas plan programit serb nuk aprovohen nga Ministria, Komisioni i pavarur bën ndryshimet e nevojshme. Shih nenet 12 dhe 13 të ligjit për arsimin në komunat e Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 15 qershor 2008 (ligji i zbatueshëm për arsimin në komunat e Kosovës); neni 8(5), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

<sup>151</sup> Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë që emërohen nga MASHT-i (3), nga anëtarët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë vendet e rezervuara për komunitetin serb (3), dhe nga Përfaqësuesi civil ndërkombëtar në Kosovë (1).

<sup>152</sup> Neni 21, ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale; neni 14, ligji i zbatueshëm për arsimin në komuna; neni 8(6), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

komunës së Mitrovicës/Mitrovica së veriut ku sigurohet edukimi i lartë publik në gjuhën serbe.

### ***Implementimi /Situata në terren***

Deri në korrik 2009, Komisioni i pavarur nuk ka nisur të operojë dhe nuk është nxjerrë ndonjë udhëzim administrativ për termet e tij të referencës dhe procedurat. Pasi që dy nga të emëruarit e Ministrisë i takojnë kabinetit të Ministrit të Arsimit, pavarësia e këtij trupi nuk është e siguruar. Veç kësaj, një nga anëtarët serb duhet të zëvendësohet pas emërimit të tij si gjyqtar i gjykatës kushtetuese. Përpjekjet e mëhershme për të zhvilluar një plan program kosovar në gjuhën serbe që janë të pranueshme për komunitetin e serbëve të Kosovës kanë qenë të prekura nga mungesa e pjesëmarrjes së ekspertëve serb të arsimit, për shkak të mosnjohjes nga ta të institucioneve të Kosovës. Pas shkurtit 2008, universiteti në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica ka ndaluar njohjen e diplomave të shkollës së mesme që lëshohen nga ministria e arsimit të Kosovës, duke e bërë qasjen në arsimin terciar në gjuhën serbe të vështirë për nxënësit e plan programit Kosovar.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Përpjekjet e intensifikuara janë të nevojshme për të siguruar veprimtarinë dhe efikasitetin e Komisionit të pavarur, si dhe pjesëmarrjen dhe konsultimin e komunitetit të serbëve të Kosovës dhe të ekspertëve të planeve mësimore në gjuhën serbe. Ky proces duhet të përfshijë gjithashtu konsultimet me publikun dhe publikimin e teksteve mësimore në bazë të plan programit mësimor për të gjitha klasat. Ndërkohë, përdorimi i vazhdueshëm i materialeve të plan programit mësimor serb duhet të sigurohet. Ekziston nevoja për bashkëpunim në nivel teknik ndërmjet institucioneve relevante në Prishtinë/Priştina dhe Beograd, për të hequr pengesat që pengojnë qasjen në edukimin publik terciar në gjuhën serbe për nxënësit me plan program mësimor të Kosovës.

## **6.3. Transporti për fëmijët që u takojnë komuniteteve jo-shumicë**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 21: Adresimi si një gjë urgjente i çështjes së transportit të sigurt të nxënësve nga komunitetet pakicë në objektet arsimore.*

### ***Korniza normative***

Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm i ngarkon komunat me obligimin për aranzhim të transportit shkollor së sigurt, efikas dhe pa pagesë për nxënësit në arsimin e detyrueshëm (klasat 1-9). Komunitet nuk kanë obligim të sigurojnë transportin për nxënësit e arsimit të mesëm (klasat 10-13).<sup>153</sup> Qeveria është përgjegjëse për të ofruar zgjidhje alternative për fëmijët që jetojnë në zonat ku arsimit në gjuhën zyrtare të zgjedhur<sup>154</sup> apo në gjuhën amtare jozyrtare<sup>155</sup> nuk është i siguruar, përfshirë këtu subvencionimin e transportit për në shkollat ku ofrohet ai arsimim.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Shqetësimet lidhur me transportimin e sigurt të nxënësve që u takojnë komuniteteve jo-shumicë janë zvogëluar në periudhën e raportimit Nxënësit serb që udhëtojnë drejt universitetin në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica transportohen në mënyrë të

<sup>153</sup> Neni 22, Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2002/19, 31 tetor 2002, (Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm).

<sup>154</sup> Neni 19(4), Ligji për gjuhët; Art. 8.2, ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

<sup>155</sup> Neni 8(2), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

sigurt përmes shërbimit të transportit humanitar me autobus që menaxhohet nga Ministria e Transportit dhe Komunikacionit.<sup>156</sup> Praktikant e një numri të komunave me shumicë shqiptare<sup>157</sup> për të siguruar transportin pa pagesë për nxënësit serbë dhe romë që mbajnë mësim sipas plan programeve serbe, janë veçmas pozitive. Për dallim nga këta, komunat veriore me shumicë serbe<sup>158</sup> nuk mbështesin transportin për nxënësit shqiptarë që udhëtojnë drejt pjesës jugore të Mitrovicës/Mitrovica; fëmijët shqiptarë që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës transportohen privatisht apo duhet të ecin nëpër zona të pasigurta për të shkuar në shkollë në jug të Mitrovicës. Nxënësit boshnjakë, që vijnë në shkollën e mesme, kanë mbi vete koston e udhëtimit dhe të transportit që nuk mbulohet nga komunat. Në Podujevë/Podujevo, nxënësit ashkali dhe romë që jetojnë në zonat e largëta nuk kanë qasje në transportin për shkollë.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Shqetësimet rreth sigurisë kanë shënuar rënie dhe autoritetet komunale që veprojnë sipas planeve mësimore të Kosovës përgjithësisht sigurojnë transportin edhe për nxënësit që mësojnë sipas planeve mësimore serbe. Ekzistenca e vazhdueshme e shërbimit të transportit humanitar mbetet esenciale për të rritur qasjen në universitetin në veri në Mitrovicës/Mitrovica për nxënësit serbë që jetojnë në pjesën jugore të Kosovës. Përkundrazi, komunat veriore me shumicë serbe nuk sigurojnë transportimin e nxënësve shqiptarë që mësojnë me planet mësimore të Kosovës.

## **6.4. Sigurimi i planeve mësimore, teksteve shkollore dhe mësuesve të kualifikuar për komunitetet numerikisht të vogla**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 22: Adresimi i nevojave ekzistuese për edukimin në gjuhët e komuniteteve pakicë, duke qartësuar prapën për hapjen e klasave me mësimdhënie në gjuhën e minoritetit, duke synuar akomodimin e kërkesave të bëra nga komunitetet numerikisht më të vogla dhe duke ndërmarrë masat për sigurimin e teksteve shkollore shtesë dhe të mësimdhënësve të kualifikuar për mësimdhënie në gjuhën amtare.*

### ***Korniza normative***

Korniza ligjore siguron mundësinë për arsimim në gjuhën amtare në gjuhët jozyrtare të komuniteteve nga niveli parashkollor deri në shkollimin e mesëm.<sup>159</sup> Kosova ka hartuar planet mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm edhe në gjuhët boshnjake dhe turke. Klasat për arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhët jo-shumicë duhet të kenë të paktën 15 nxënës për mësimdhënës (krahasuar me 21 kur edukimi është në gjuhën shqipe).<sup>160</sup> MASHT-i është i obliguar të sigurojë tekstet shkollore pa pagesë për të gjitha klasat e shkollimit të detyrueshëm<sup>161</sup> dhe tekstet shkollore adekuate në gjuhët amtare të nxënësve.<sup>162</sup> Planet mësimore dhe tekstet shkollore specifike për komunitetet janë paraparë për ‘lëndët nacionale’ që mbulojnë gjuhën, historinë, artin dhe muzikën e komuniteteve.<sup>163</sup> Legjislacioni i zbatueshëm<sup>164</sup> kërkon më tej që

<sup>156</sup> Shih raportet për transportimin humanitar të minoriteteve me autobus në Kosovë (Nëntor-dhjetor 2006; janar-mars 2007; prill-qershor 2007; dhe qershor 2008), Misioni i OSBE-së në Kosovë. Linja e transportit humanitar me autobus që lidh Kamenicën/Kamenica, Ranillugun/Ranilug, Shillovën/Šilovo, Gjilanin/Gnjilane dhe Mitrovicën/Mitrovica.

<sup>157</sup> Vushtrri/Vučitrn, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan dhe Gjilan/Gnjilane.

<sup>158</sup> Ky është rasti me komunat e Zveçanit/Zvečan, Zubin Potokut dhe Leposaviqit/Leposavić.

<sup>159</sup> Neni 4(4b), Korniza kushtetuese; neni 3(2c), Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm; neni 20(1), Ligji për gjuhët; neni 8(1), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve neni 59(3) i Kushtetutës.

<sup>160</sup> Neni 2, Udhëzimi Administrativ i MASHT-it Nr. 16/2002 për përcaktim të proporcioneve mësimdhënës - nxënës, 17 tetor 2002.

<sup>161</sup> Neni 3(2b), Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm.

<sup>162</sup> Neni 7(6), Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm.

<sup>163</sup> Neni 8(12), Ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

edukimi në gjuhët jo-shumicë të zhvillohet nga folësit amtarë apo të kualifikuar; personeli i mjaftueshëm i kualifikuar të jetë në dispozicion për trajnim të mësimdhënësve të gjuhës së komuniteteve; dhe që trajnimi profesional ekzistues apo shtesë dhe edukimi i lartë në gjuhët jo-shumicë të mbahet apo të sigurohet në përputhje me nevojat e shprehura dhe zbatueshmërinë financiare. Menaxherët dhe mësimdhënësit e institucionit publik të arsimit që operojnë në gjuhët jo-shumicë duhet të jenë kryesisht përfaqësues të komuniteteve apo të jenë tërësisht të familjarizuar me këto komunitete.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës, janë hartuar planet mësimore në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake. Nxënësit boshnjakë dhe turq<sup>165</sup> kanë qasje në edukimin në gjuhën amtare por u mungojnë tekstet shkollore të bazuara në planin mësimor për arsimin e mesëm dhe në disa raste për arsimin fillor. Në vitin shkollor 2008/2009, nxënësit boshnjakë dhe turq kanë marrë tekste shkollore pa pagesë por jo të plota për klasat 1-5 nga MASHT-i. Librat për 'lëndët nacionale' specifike për komunitetet që janë në dispozicion të nxënësve boshnjakë dhe turq importohen nga Bosnja dhe Hercegovina apo nga Turqia dhe nuk pasqyrojnë planin mësimor të Kosovës dhe identitetet specifike të komuniteteve të tyre. Këta libra janë shpesh të vjetruara, të ngrëna nga përdorimi intensiv apo nxënësit përdorin shënime me dorë që ofrohen nga mësimdhënësit.

Nxënësit rom kanë qasje në klasat e limituara në gjuhën e tyre amtare vetëm në disa shkolla me plane mësimore serbe, ndërsa tekstet shkollore në gjuhën rome nuk pasqyrojnë specifikat linguistike dhe kulturore të komunitetit rom në Kosovë. MASHT-i ka iniciuar një projekt për hartim të planeve mësimore dhe teksteve shkollore të Kosovës për lëndët në gjuhën rome në vitin 2009. Nxënësit shqiptarë në pjesën veriore të Kosovës kanë qasje në arsimin fillor në gjuhën e tyre amtare, por komunitatet në të cilat banojnë ata nuk mbështesin sigurimin e atij arsimit. Arsimi me plane mësimore serbe që ofrohet për nxënësit boshnjakë në pjesën veriore të Kosovës nuk përmban përshtatjen e nevojshme që i përgjigjet diversitetit kulturor të tyre.

Kosova siguron një varg të limituar të mundësive për shkollim të lartë në gjuhët jozyrtare.<sup>166</sup> Nxënësit e komuniteteve jo-shumicë shpesh migrojnë<sup>167</sup> për të zgjeruar opsionet e tyre. Në vitin 2009 MASHT-i ka thjeshtësuar procesin dhe ka zvogëluar koston e njohjes së kualifikimeve të siguruar jashtë Kosovës.<sup>168</sup> Kjo ka ndikuar veçmas në studentët turq të Kosovës që kanë siguruar diploma të shkollimit të lartë në Turqi. Universiteti i Prishtinës/Priştina ofron vende të rezervuara për arsimim në

---

<sup>164</sup> Neni 8, Ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve.

<sup>165</sup> Në Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn dhe Janjevë/Janjevo, turqit e Kosovës ndjekin mësimet në gjuhën shqipe dhe nuk kërkojnë mësimdhënie apo klasa në gjuhën e tyre amtare. Megjithatë, disa prej tyre vazhdojnë arsimin e mesëm në një shkollë në Prishtinë/Priştina që mban mësimet në gjuhën turke.

<sup>166</sup> Universiteti i Prishtinës/Priştina ofron disa kurse në gjuhët boshnjake dhe turke për filologjinë turke (50 vende), gjuhën boshnjake dhe turke për mësimdhënësit (nga 35 vende secili), në teknologjinë informative (në gjuhën boshnjake, 35 vende) dhe në administrim të biznesit (në gjuhën boshnjake, 80 vende).

<sup>167</sup> Nxënësit turq, boshnjakë, goranë, romë, kroatë dhe shqiptarë e serbë. Nxënësit turq kanë qasje në bursat që sigurohen nga qeveria turke.

<sup>168</sup> MASHT, Udhëzimi Administrativ nr. 8/2009 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të siguruar nga shkollat e larta të aftësisht profesional dhe nga universitetet jashtë Kosovës.

gjuhën shqipe vetëm për komunitetet specifike.<sup>169</sup> Që nga viti 2008/2009, universitetet nën administrimin serb nuk i njohin diplomat e marra në shkollat e mesme që punojnë me plane mësimore të Kosovës, gjë që ndikon në nxënësit boshnjakë që duan qasje në arsimin e lartë në gjuhën serbe.<sup>170</sup> Nevoja për të trajnuar një numër të mjaftueshëm të profesorëve universitar të kualifikuar në gjuhën boshnjake dhe turke është e ngutshme. Profesorët që ofrojnë kurse të diplomës për mësimdhënësit e ardhshëm boshnjakë dhe turq për arsimin fillor dhe të mesëm janë numerikisht të pamjaftueshëm, dhe në shumicën e rasteve nuk posedojnë kualifikimet akademike të nevojshme. Alternativa e gjetjes së profesorëve vizitues nga jashtë është e shtrenjtë. Qeveria turke financon një numër të caktuar të profesorëve të jashtëm për të mbajtur mësim në Fakultetin e Edukimit në Prizren, ndonëse shkalla e kurseve të diplomës që ofrohen në gjuhën turke është e limituar. Në maj të vitit 2009, Universiteti i Prishtinës/Priština ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me Universitetet e Sarajevës, Tuzllës, Zenicës dhe Mostarit. Rrjedhimisht, Fakulteti i Edukimit në Prizren planifikon hapjen e kurseve të reja për mësimdhënësit e ardhshëm në gjuhën boshnjake, përfshirë këtu matematikën dhe teknologjinë informative. Kurset universitare në gjuhën boshnjake që janë në dispozicion aktualisht në Kosovë nuk sigurojnë trajnimin e mësimdhënësve në gjuhën boshnjake për të gjitha lëndët në arsimin e mesëm. Trajnimi për zhvillim profesional gjatë shërbimit për mësimdhënësit boshnjak dhe turq ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe, dhe përkthimi simultan nganjëherë nuk është adekuat. Qasja në trajnimin për zhvillim profesional është e limituar për mësimdhënësit që punojnë me planet mësimore serbe, pasi që ky ofrohet jashtë Kosovës, dhe nuk ofrohet ndonjë trajnim specifik për mësimdhënësit në gjuhën rome.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Duhet alokuar mjete financiare adekuate për të siguruar subvencione për publikimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore në gjuhët boshnjake dhe turke për të gjitha klasat dhe lëndët në arsimin fillor dhe të mesëm, për të përmirësuar cilësinë e librave për lëndët nacionale dhe për të siguruar përkthimin profesional të librave për lëndët e përgjithshme. Ekziston nevoja e vazhdueshme për të caktuar si prioritet zhvillimin me pjesëmarrje të planeve mësimore për 'lëndët nacionale' për komunitetet specifike, në fushën e gjuhës, historisë, artit dhe muzikës për komunitetet më të cenueshme. Përpjekjet për zgjerim të mëtejshëm të studimeve të diplomës në gjuhët jozyrtare janë të nevojshme për të rritur numrin e mësimdhënësve të kualifikuar dhe për të forcuar trajnimin për zhvillim profesional për këta mësimdhënës. Zhvillimi i lëndës ndërdisiplinore për edukimin ndërkulturor duket të jetë i këshillueshëm për të rregulluar çështjet lidhur me komunitetet dhe të drejtat e komuniteteve, dhe për të promovuar edukimin dhe mirëkuptimin ndërkulturor.

---

<sup>169</sup> Në vitin akademik 2008/2009, Universiteti i Prishtinës/Priština ka rezervuar 134 vende për studentë në gjuhën shqipe vetëm për kandidatët turq, boshnjakë, romë, ashkali dhe egjiptianë. Fakti që aplikantët nga jashtë Kosovës dhe nga komunitetet jo-shqiptare mund të aplikojnë vetëm në kuadër të kuotave të përcaktuara për ta dhe përkatësia në një komunitet mund të provohet vetëm me një deklaratë të organizatës që përfaqëson komunitetin, shkakton disa shqetësime.

<sup>170</sup> Në vitin akademik 2008/2009 MASHT-i ka autorizuar lëshimin e kopjeve të certifikatave me vulë të UNMIK-ut, që u mundësojnë një numri të studentëve boshnjakë që të regjistrohen në universitetet në Mitrovicën/Mitrovica e veriut dhe në Serbi. Megjithatë, në vitin akademik 2009/2010 Ministria nuk është duke e autorizuar këtë praktikë dhe pohon që vulat e UNMIK-ut më nuk janë në dispozicion.

## 6.5. Masat për përmirësim të qasjes në arsim dhe për kompletim të arsimit nga fëmijët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 23: të siguruarit që do të ndërmerren hapa të vendosur për adresimin e nevojave arsimore të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, duke përfshirë të siguruarit e qëndrueshmërisë së programeve të dizajnuara për tu ndihmuar nxënësve nga këto komunitete për tu integruar dhe për të qëndruar në sistemin e edukimit.*

### ***Korniza normative***

Me qëllim të rritjes së integritimit arsimor të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, strategjitë<sup>171</sup> e miratuara nga MASHT-i dhe na Qeveria në vitet 2007 dhe 2009 kërkojnë ndërmarrjen e masave konkrete për: të ndaluar braktisjen e shkollimit dhe përjashtimin; trajnimin e mësimit të këtyre komuniteteve në të gjitha nivelet; sigurimin e transportit pa pagesë dhe të teksteve shkollore për familjet në gjendje më të vështirë; hartimin e planit mësimor në gjuhën rome dhe përfshirjen e mësimit për kulturën dhe historinë e këtyre komuniteteve në planin mësimor të përgjithshëm; ofrimin e përkrahjes për fëmijët me vështirësi në nxënien e mësimit; dhe ngritjen e ndërgjegjësimit tek prindërit lidhur me rëndësinë e edukimit formal.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Strategjia e qeverisë për integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nuk është implementuar në mungesë të planeve të veprimit dhe buxhetit, ndërsa strategjia e MASHT-it mbështetet së tepërmi në donacionet. Në kuadër të të dyja sistemeve arsimore<sup>172</sup> romët, ashkalitë dhe egjiptianët janë të integruar në shkollë të pamjaftueshme. Fëmijët e këtyre komuniteteve, dhe veçmas vajzat, janë të prekura nga shkalla e ulët e regjistrimit në shkollë, shkollët e larta të braktisjes së shkollimit dhe përjashtimi edukativ. Masat sistematike efektive me të cilat adresohen varfëria dhe përjashtimi edukativ mungojnë. Masat e ndërmarra<sup>173</sup> ku përfshihen bursat<sup>174</sup> janë kryesisht të një natyre *ad hoc* apo lokale dhe furnizimi pa pagesë me libra bëhet me ndërprerje. Ndërsa një projekt i MASHT-it për zhvillim të një lënde në gjuhën rome vazhdon edhe më tej në vitin 2009, lëndët arsimore për komunitetet specifike që u mundësojnë këtyre komuniteteve ruajtjen e identitetit të tyre dhe kulturës nuk janë përfshirë në planin mësimor të Kosovës. Nxënësit romë kanë qasje në klasat në gjuhën e tyre amtare vetëm në disa shkolla me plane mësimore serbe. Nuk ka asnjë plan mësimor në universitet për të siguruar trajnimin e mësimit të kualifikuar në gjuhën rome. Shumë pak nxënës nga këto komunitete kompletojnë shkollimin e

<sup>171</sup> Strategjia e MASHT-it për integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë – Komponenti i arsimit 2007-2017, korrik 2007; Strategjia për integrim të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë 2009-2015, fq. 34-44, Prishtinë/Priština, shkurt 2009.

<sup>172</sup> Romët që jetojnë pranë apo në zonat e banuara kryesisht nga serbët zakonisht mësojnë me planet mësimore serbe; ndërsa romët që jetojnë në lagjet shqiptare, dhe ashkalitë e egjiptianët përgjithësisht mësojnë me planet mësimore të Kosovës.

<sup>173</sup> Shih raportin për 'Komunitetet jo-shumicë të Kosovës në kuadër të sistemeve arsimore filllore dhe të mesme,' Misioni i OSBE-së në Kosovë, prill 2009, fq.14. Klasat për zënie të mësimit, aktivitetet përkrahëse për nxënësit që braktisin shkollën, apo fushatat e ndërgjegjësimit të organizuara nga disa komuna, shkolla dhe OJQ, dhe donacionet *ad-hoc* të teksteve shkollore nga ministria kosovare apo ajo serbe e arsimit, OJQ-të ndërkombëtare.

<sup>174</sup> Gjashtëdhjetë bursa vjetore prej 50 eurosh janë dhënë në vitin 2009 nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe 39 bursa për shkollim nga Programi i OKB-së për zhvillim janë shpërndarë në Prizren dhe Ferizaj/Uroševac.

mesëm dhe kanë mundësinë e përfitimit nga kuotat e regjistrimit<sup>175</sup> të rezervuara për komunitetet e tyre nga Universiteti i Prishtinës/Priština.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Pak progres është arritur në rritjen e qasjes në arsim për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian. Strategjitë dhe politikat e miratuara nuk janë implementuar ende dhe mungon përkrahja financiare adekuate nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, dhe mbështeten kryesisht në financimin nga donatorët. Masat e ndërmarra në bazë *ad hoc*, shpesh nga organizatat e shoqërisë civile, duhet të integrohen në kuadër të një qasjeje më sistematike nga institucionet përgjegjëse.

## **6.6. Masat për të siguruar qasje në arsim për komunitetin goran**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr 24: Të lejohet fleksibilitet në implementimin e reformave në edukim në lidhje me ata nxënës nga komuniteti goran që nuk janë integruar ende në sistemin e ri arsimor.*

### ***Korniza normative***

Korniza ligjore mbron qasjen në edukim në gjuhën zyrtare të zgjedhur, në të gjitha nivelet dhe për të gjitha komunitetet në Kosovë.<sup>176</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Në kuadër të planeve mësimore në dispozicion, nxënësit që i takojnë komunitetit goran nuk kanë qasje në lëndët arsimore specifike për komunitetin që do tu mundësonte ruajtjen e identitetit të tyre. Në Dragash/Dragaš, një pjesë e madhe e komunitetit ka vendosur të vijojë mësimin në gjuhën serbe, që ofrohet me planin mësimor serb. Që nga viti 2006, mësuesit goranë kanë refuzuar të nënshkruajnë kontrata me komunën e Dragashit/Dragaš për shkak të kontratave të tyre me Ministrinë serbe të arsimit. Prandaj, në shtator të vitit 2008 komuna ua ka ndaluar mësuesve goran hyrjen në shkollën fillore të drejtuar nga komuna në Dragash/Dragaš. Si rezultat i kësaj, nga shtatori deri në dhjetor, 135 fëmijë goranë nuk kanë qenë në gjendje të hyjnë në ndërtesën e shkollës dhe të mbajnë mësim në gjuhën serbe. Në janar 2009 nxënësit dhe mësuesit goranë kanë shkuar në shkollat satelite në fshatrat fqinje, duke i ashpërsuar kontaktet me stafin dhe nxënësit që mësojnë me planet mësimore të Kosovës. Megjithatë, në mungesë të hapësirës dhe për shkak të distancës ndërmjet fshatrave, organizimi i edukimit të rregullt është penguar seriozisht. Më 3 mars 2009, pas një marrëveshjeje të mundësuar nga Komisionari i lartë i OSBE-së për minoritetet nacionale dhe nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, pjesa më e madhe e mësuesve dhe nxënësve goranë<sup>177</sup> janë kthyer përkohësisht në shkollë. Më 17 mars 2009, për të shkak të nxjerrjes së rregullave të shkollës dhe gjoja ndërhyrjes nga drejtori i shkollës në sistemin arsimor që punon në bazë të planeve mësimore serbe, mësuesit goranë janë tërhequr përsëri. Ndonëse komuna ka anuluar rregullat e kontestuara, negociatat tjera për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme nuk kanë rezultuar në kthimin e stafit dhe nxënësve që punojnë me planet mësimore serbe. Përkundër ndërmjetësimit të vazhdueshëm nga OSBE-ja, autoritetet arsimore serbe

<sup>175</sup> 38 vende të rezervuara në vitin shkollor 2008/9 dhe 58 në vitin 2009/10. Universiteti i Prishtinës/Priština, njoftimet për regjistrim të studentëve në vitin e parë të studimeve në vitet akademike 2008/9 dhe 2009/10.

<sup>176</sup> Shih kornizën normative, paragrafët 6.1, 6.2, 6.3, 6.4 të këtij raporti.

<sup>177</sup> Fëmijët dhe mësuesit e klasave 5-8 janë kthyer në shkollë nga datat 3 deri 16 mars 2009. Fëmijët e klasave 1-4 nuk janë kthyer për shkak se drejtori i shkollës ka ndaluar kthimin e disa mësuesve goranë dhe ka bërë përpjekje për të marrë kontrollin mbi procesin arsimor në bazë të planeve mësimore serbe.



nuk kanë ndërmarrë hapa për të siguruar kthimin e mësimdhënësve në listën e tyre të pagave. Mosmarrëveshjet lidhur me aranzhimet kontraktuese dhe propozimet e reja që synojnë ndarjen fizike apo të ndërrimeve për nxënësit e planit mësimor serb, kërcënojnë kthimin dhe qasjen në arsimin adekuat në gjuhën serbe për fëmijët goranë në vitin shkollor 2009/2010.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Në vitin shkollor 2009/2010 palët e përfshira në planet mësimore kosovare dhe ato serbe kanë rastin dhe obligimin që të sigurojnë që fëmijët goranë do të kthehen në hapësirat shkollore të përbashkëta dhe që do të gëzojnë edukim adekuat në gjuhën zyrtare të zgjedhur nga ta. Konflikti ndërmjet planeve mësimore kosovare dhe serbe nuk duhet të rrezikojë të drejtën e fëmijëve goranë për edukim. Pozicionet e polarizuara shkaktojnë ndarje ndërmjet përfaqësuesve të komunës së Dragashit/Dragaš, mësuesve goranë dhe Ministrisë serbe të arsimit; për më tepër, nxënësit goranë janë aktualisht të ndarë nga moshatarët e tyre shqiptarë dhe boshnjakë. Ndërsa mësuesit goranë dhe drejtori i shkollës që punon me planet mësimore serbe tani vonë kanë ndaluar së propozuari zgjidhjet për kthim që bazohen në ndarjen fizike, sikur që është përdorimi i ndërtesave të veçanta apo ndërtimi i mureve apo ndërrimet e veçanta, nuk janë bërë përpjekje konkrete për të siguruar kthimin dhe ri-integrimin e fëmijëve goranë në shkollën shumetnike.

## **7. PJESËMARRJA**

### **7.1. Regjistrimi i popullsisë dhe pjesëmarrja e komuniteteve jo-shumicë**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 3: Shtyrja e organizimit të fazës së regjistrimit të popullatës dhe e regjistrimit të ekonomive familjare deri në sigurimin e nivelit maksimal të pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe që regjistrimi i popullsisë të bëhet në përputhje me të standardet ndërkombëtare.*

#### ***Korniza normative***

Ligji për regjistrim të popullsisë dhe të ekonomike familjare në Kosovë<sup>178</sup> ia beson këtë detyrë Entit statistikor të Kosovës (Enti statistikor) dhe Komisionit qendror për regjistrimin, si organet kryesore ekzekutive për zhvillim të regjistrimit të ardhshëm.<sup>179</sup> Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe UNMIK-u (në emër të Ministrisë së Shërbimeve Publike) kanë nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit<sup>180</sup> për themelimin të Operacionit të monitorimit ndërkombëtar (OMN), që është përgjegjës për përgatitjen e regjistrimit.

#### ***Implementimi/Situata në terren***

Si plotësim i pilot testimit të zhvilluar në vitin 2006, një test në terren është bërë ndërmjet 27 tetorit dhe 10 nëntorit 2008 në zonat e caktuara të numëruara<sup>181</sup> me qëllim të testimit të materialeve të regjistrimit, përfshirë këtu pyetësorët, doracakët dhe procedurat, me fokus special në komunitetet etnike të ndryshme. Ndërsa Enti statistikor ka përmirësuar kapacitetin teknik të tij, testi në terren ka konfirmuar që edhe më tej ka nevojë për progres. Enti statistikor duhet të bëjë një analizë të thellë të shkaqeve të bojkotit të pilot testimit të vitit 2006 nga komunitetet e serbëve dhe

<sup>178</sup> Ligji për regjistrimin e popullsisë në Kosovë, i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2004/53, 9 dhjetor 2004.

<sup>179</sup> Neni 5 dhe 12, Ligji për regjistrim të popullsisë në Kosovë.

<sup>180</sup> Memorandumi i mirëkuptimit, që ka hyrë në fuqi më 24 mars 2006.

<sup>181</sup> Në komunat Dragash/Dragaš, Lipjan/Lipljan, Mamushë/Mamuša/Mamuša, Prishtinë/Priština, Prizren dhe Vushtrri/Vučitër.

romëve të Kosovës dhe nuk ka zhvilluar një plan konkret dhe një strategji për ti inkurajuar të gjitha komunitetet për të marrë pjesë në regjistrim.<sup>182</sup> Për shkak të “karakterit miqësor dhe jo reprezentativ të mostrës së komunave”<sup>183</sup> pjesëmarrja e suksesshme e komuniteteve jo-shumicë në testimin në terren, nuk tregojnë që janë krijuar kushtet që promovojnë pjesëmarrjen e serbëve dhe të romëve. Me qëllim të arritjes së një mirëkuptimi të përbashkët për datën e mundshme të regjistrimit të popullsisë, dhe për kushtet që duhen plotësuar para bërjes së regjistrimit të plotë, Komisioni Evropian, më 24 mars 2009, ka organizuar një tryezë të rumbullakët duke kërkuar nga të gjitha grupet e interesit<sup>184</sup> prezantimin e opinioneve të tyre. Në fund, më 25 qershor 2009, qeveria e Kosovës ka njoftuar që regjistrimi i popullsisë do të mbahet ndërmjet 30 marsit dhe 11 prillit 2011.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Disponueshmëria e të dhënave “të besueshme [...] është një parakusht esencial [...] për të inkurajuar barazinë e komuniteteve jo-shumicë,”<sup>185</sup> veçmas marrë parasysh tendencën për të miratuar politika dhe legjislacione që bazohen në pragjet numerike etnike.<sup>186</sup> Megjithatë, institucionet e Kosovës ende nuk i plotësojnë kushtet për të zhvilluar një regjistrim të popullsisë që është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Së pari, rruga qorre politike<sup>187</sup> nuk lejon arritjen e parimit të mbulimit të plotë dhe universalitetit brenda një territori të definuar<sup>188</sup> Së dyti, pjesëmarrja e plotë e të gjitha komuniteteve, përfshirë këtu refugjatët dhe personat e zhvendosur është mjaft e dyshimtë dhe mbetet ligjërisht problematike.<sup>189</sup> Së treti, plotësimi i kushteve të tjera, p.sh. gjuha dhe mbrojtja e të dhënave<sup>190</sup> apo vetë-identifikimi etnik mbetet të adresohet.

## **7.2. Të dhënat personale në lidhje me përkatësinë në një komunitet**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 5: Ndërmarrja e masave për të siguruar mbrojtjen efektive të të dhënave personale në lidhje me përkatësinë në një komunitet.*

### ***Korniza normative***

Kushtetuta garanton mbrojtjen e të dhënave personale dhe autorizon rregullimin e modaliteteve për mbledhjen e tyre, ruajtjen, qasjen në to, korrigjimin dhe përdorimin me ligj.<sup>191</sup> Megjithatë, ai ligj është ende në fazën e hartimit. Ai definon të dhënat

<sup>182</sup> Raport për testimin në terren të mbajtur nga 27 tetori deri më 10 nëntor 2008, dorëzuar nga kryesuesi i grupit menaxhues, IMO, Komiteti drejtues, 11 dhjetor 2008, paragrafi 67.

<sup>183</sup> Ibid, paragrafi 11.

<sup>184</sup> Që përfshin: UNMIK-un, Këshillin e Evropës, Divizionin e statistikave të OKB-së, Komisionin ekonomik të OKB-së për Evropën, Fondin për popullsi të OKB-së, Zyrën ndërkombëtare civile.

<sup>185</sup> Komente për pjesëmarrjen efektive të personave që u takojnë minoriteteve nacionale në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në çështjet publike (Komente për pjesëmarrjen), Komiteti këshillëdhënës për Konventën Kornizë, 27 shkurt 2008, fq. 4.

<sup>186</sup> Neni 64(2), i Kushtetutës; neni 12(6), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve; neni 54 dhe 61, ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale; neni 2(3), 2(4), Ligji për gjuhët.

<sup>187</sup> Përfshirë mungesën e autoritetit *de facto* të institucioneve të Kosovës mbi shumicën e popullsisë serbe të Kosovës që banojnë në tri komunat në veri të lumit Ibër/Ibar (Leposaviq/Leposavić, Zvečan/Zvečan dhe Zubin Potok) si dhe bojkotin nga serbët dhe romët të institucioneve të Kosovës pas ngjarjeve politike të vitit 2008.

<sup>188</sup> Parimet dhe rekomandimet e OKB-së për regjistrim të popullsisë dhe të ndërtesave të banimit, Rishikimi 2, 2008, Tiparet esenciale, fq. 8.

<sup>189</sup> Definicioni i ‘popullsisë rezidente’ sipas nenit 3(a) lë të hapur çështjen e përfshirjes së refugjatëve dhe të personave të zhvendosur.

<sup>190</sup> Shih paragrafin 7.2 të këtij raporti.

<sup>191</sup> Neni 36(4) i Kushtetutës.

lidhur me përkatësinë në një komunitet si “të dhëna personale të ndjeshme” dhe kërkon masa ligjore adekuate mbrojtëse, veçmas lidhur me përpunimin e tyre,<sup>192</sup> në linjë me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe jurisprudencën e tij.<sup>193</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Ndonëse hartimi i legjislationit ka nisur në korrik 2007 dhe është shtyrë vazhdimisht më 19 shkurt 2009, Ministria e Punëve të Brendshme ka themeluar një grup punuese për hartim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, me asistencë nga Komisioni Evropian. Një grup punues ndërministror, i përbërë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe nga grupet tjera të interesit vendore dhe ndërkombëtare, do të diskutojë më tej së shpejti projektligjin e ri. Projektligji i tanishëm bazohet në Aktin e Sllovenisë për mbrojtjen e të dhënave.<sup>194</sup>

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Mbrojtja e të dhënave personale dhe vetë-identifikimi vullnetar janë kushte esenciale në një shoqëri demokratike funksionale. Kjo ka rëndësi të posaçme në Kosovë, ku komunitetet jo-shumicë janë të cenueshme në aspektin social dhe ekonomik. Komiteti këshillëdhënës për Konventën kornizë njih nevojën për mbledhje të të dhënave komparative për situatën socio-ekonomike dhe arsimore të personave që u takojnë komuniteteve jo-shumicë, ndonëse duke respektuar në tërësi standardet ndërkombëtare.<sup>195</sup> Në të njëjtën kohë, e drejta për të mos u trajtuar si person që i takon një minoriteti nacional duhet të mbrohet njëjloj, dhe personat në fjalë duhet të informohen vazhdimisht që sigurimi i të dhënave për përkatësi në një komunitet është vullnetar.<sup>196</sup> Zakonisht, institucionet e Kosovës, veçmas në nivel komunal, mbledhin të dhëna për përkatësinë e një individit në një komunitet në kontekste të ndryshme, nga edukimi tek punësimi, pa pëlqimin paraprak të personit të prekur. Institucionet e Kosovës duken të përkushtuara për të plotësuar boshllëkun ligjor aktual lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, implementimi në administratën publike i një sistemi të mbrojtjes së të dhënave që kërkon teknologji të sofistikuar, të kuptuar gjithëpërfshirës të kornizës ligjore dhe politika përkatëse, mbetet një sfidë.

## **7.3. Pjesëmarrja e komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 26: bërja e përpjekjeve të mëtejme për të siguruar pjesëmarrjen e shtuar të personave që u takojnë komuniteteve pakicë në strukturat dhe proceset e IPVQ-së.*

### ***Korniza normative***

Korniza ligjore promovon karakterin shumetnik të Kosovës, përfaqësimin e barabartë të të gjitha komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës dhe pjesëmarrjen e barabartë

<sup>192</sup> Neni 8 i Direktivës së BE-së 95/46 për mbrojtjen e individëve sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të atyre të dhënave, 23 nëntor 1995.

<sup>193</sup> Neni 22(2) dhe 53 i Kushtetutës. Konventa është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë dhe mbizotëron mbi dispozitat ligjore vendore kundërshtuese dhe aktet e institucioneve publike. Të drejtat e njeriut që garantoohen me kushtetutën e vitit 2008 duhet të interpretohen në pajtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>194</sup> Akti për mbrojtjen e të dhënave personale (ZVOP-1), Nr. 001-22-148/04, Republika e Sllovenisë, 15 korrik 2004.

<sup>195</sup> Koment për pjesëmarrjen, Komiteti Këshillëdhënës për Konventën kornizë, 27 shkurt 2008, fq. 4.

<sup>196</sup> Opinioni i Komitetit këshillëdhënës, 02 mars 2006, fq. 13-14.

gjinore.<sup>197</sup> Ajo garanton gjithashtu pjesëmarrjen e komuniteteve në gjyqësi dhe në shërbimin e prokurorisë.<sup>198</sup> Përbërja e policisë së Kosovës duhet të pasqyrojë përbërjen etnike të popullsisë së komunës në masën më të madhe të mundur.<sup>199</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Komunat e Kosovës zakonisht mbajnë të dhëna të shpërndara për numrin e punonjësve meshkuj dhe femra dhe për përkatësinë etnike të tyre, ndonëse klasifikimet etnike nuk janë konsistente apo në disa raste nuk respektojnë identifikimet e komuniteteve përkatëse.<sup>200</sup> Përgjithësisht, të dhënat për gjininë apo etninë nuk kategorizohen sipas nivelit të vjetërsisë, duke penguar kështu vlerësimin e qasjes diferenciale në postet menaxhuese. Sipas një studimi të OSBE-së të shkurtit 2009, nga numri prej 35,188 shërbyesve civil komunal 0.69 për qind (242) ishin klasifikuar si romë, ashkali apo egjiptianë; 0.05 për qind (19) kroatë; 1.49 për qind (525) boshnjakë; 0.85 për qind (299) turq dhe 0.66 për qind (232) goranë. Qasja e komuniteteve në pozitat e larta është e limituar.<sup>201</sup> Ndonëse buxhetet e shumicës së komunave në vitin 2009 nuk parashohin reduktime të stafit, ka rrezik që shkurtime/ristrukturimet në të ardhmen mund të ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e komuniteteve në shërbimin civil komunal. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë është relativisht i lartë në gjyqësi dhe në shërbimin e prokurorisë.<sup>202</sup> Në shërbimin civil qendror, ajo ka rënë nga 12 për qind në vitin 2006 në 9 për qind në vitin 2009,<sup>203</sup> dhe mbetet veçmas e ulët në nivelet e larta.<sup>204</sup> Në qershor 2009, 85 për qind (6,109) e stafit të policisë së Kosovës kanë qenë shqiptarë, 9.7 për qind (700) serbë, dhe 5.3 për qind (386) u kanë takuar komuniteteve të tjera.<sup>205</sup> Ka një përfaqësim të ulët të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve veçmas në pozitat e larta. Ndonëse pas zhvillimeve politike të vitit 2008 policët serbë kanë

<sup>197</sup> Neni 61 dhe 101 i Kushtetutës; neni 9(5) dhe (6), ligji i zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve; neni 2, rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin civil të Kosovës, 22 dhjetor 2001; neni 2a, Udhëzimi Administrativ Nr. 2003/01 për procedurat e rekrutimit; neni 3, Udhëzimi Administrativ 2003/02 për implementim të rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin civil të Kosovës; neni 2(b), Ligji për anti-diskriminim; neni 3, Ligji për barazinë gjinore, i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/18, 7 qershor 2004.

<sup>198</sup> Shih kapitullin 2.3 të këtij raporti.

<sup>199</sup> Nenet 128(2) dhe (4) të Kushtetutës; neni 2(1) dhe 34(4), ligji i zbatueshëm për policinë; Doracak për politikën dhe procedurat e shërbimit policor të Kosovës, politika P -1.13, neni IV A (4), Aspektet organizative dhe të politikave, Shërbimi Policor i Kosovës, Zhvillimi i Politikave, shkurt 2007.

<sup>200</sup> Të dhënat e krahasuara përfshijnë administratën komunale, sektorin e kujdesit shëndetësor primar, dhe institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, shërbyesit civil komunal të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë janë regjistruar si 'RAE', ndërsa komuna e Dragashit/Dragaš nuk bën dallim në mes të punonjësve boshnjakë dhe atyre goranë, dhe i shfrytëzon të dy termat në mënyrë të këmbëshme. Malazezët e Kosovës nuk janë të regjistruar veçmas.

<sup>201</sup> Katër (meshkuj) rom, ashkali dhe egjiptianë nga 242; një (femër) nga 9 kroatë të Kosovës; 18 (12 meshkuj dhe 6 femra) nga 525 boshnjakë; 10 (9 meshkuj dhe 1 femër) nga 299 turq dhe 11 (meshkuj) nga 232 goranë.

<sup>202</sup> Shih kapitullin 2.3 të këtij raporti.

<sup>203</sup> Shih 'Doracak për të drejtat e minoriteteve,' përkrahja e mëtejme për institucionet e drejtësisë në Kosovë, Human Dynamics, prill 2009, fq. 11.

<sup>204</sup> Në mars 2008, shërbyesit civil që u takojnë komuniteteve jo-shumicë kanë përfaqësuar 4 për qind të menaxhmentit të lartë dhe 3.16 për qind të menaxhmentit të mesëm. Burimi: Ministria e Shërbimeve Publike, Departamenti i administratës civile.

<sup>205</sup> Gjithsej, 208 boshnjakë, 84 turq, 38 goranë, 20 romë, 20 ashkali, shtatë egjiptianë, pesë çerkezë, tre kroatë dhe një maqedonas.

ndalur raportimin në punë,<sup>206</sup> dhe ishin suspenduar me pagesë, pjesa më e madhe e tyre (318 nga 325) janë kthyer në postet e tyre deri në fund të qershorit 2009.<sup>207</sup>

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve në shërbimin civil komunal mbetet edhe më tej një sfidë. Kjo vlen gjithashtu për shërbimin civil qendror dhe për gjyqësinë e shërbimin e prokurorisë. Duhet bërë më tepër përpjekje për të rritur pjesëmarrjen e komuniteteve jo-shumicë, që përfshin implementimin e programeve edukative, të trajnimit profesional dhe këshillimit, veçmas për të barazuar mundësitë për komunitetet e pa përfaqësuar sa duhet sikur që janë romët, ashkallitë dhe egjiptianët. Institucionet e Kosovës duhet të shtojnë gjithashtu përpjekjet e tyre për komunikim me përfaqësuesit e komunitetit serb dhe të komuniteteve të tjera jo-shumicë në gjyqësi dhe prokurori, veçmas në kontekst të procesit të vazhdueshëm të rekrutimit dhe verifikimit.

## **7.4. Dialogu ndërmjet Ministrive dhe Komitetit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve në Kuvendin e Kosovës**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 27: Shfrytëzimi i dialogut të rregullt dhe domethënës ndërmjet Ministrive relevante të Qeverisë dhe Komitetit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve në Kuvendin e Kosovës.*

### ***Korniza normative***

Korniza kushtetuese dhe Kushtetuta i kanë besuar Komitetit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe për kthim (Komiteti) mandatin për të këshilluar Kuvendin e Kosovës lidhur me të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Komiteti merret me shqyrtimin e projekt legjislacionit, mund të propozojë ligje, të lëshojë rekomandime dhe opinione.<sup>208</sup> Kushtetuta ka ndryshuar përbërjen e tij.<sup>209</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Me përjashtim të raporteve me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim,<sup>210</sup> nuk ka një dialog të rregullt ndërmjet Komitetit dhe ministrive. Nuk ka një bashkëpunim formal sa i përket shqyrtimit apo hartimit të projekt legjislacionit apo të politikave. Komunikimet e rralla më tepër u referohen çështjeve specifike, që dalin kryesisht nga vizitat në terren të Komitetit. Kohë pas kohe, Komiteti fton ministrinë kompetente në seanca konsultuese,<sup>211</sup> apo dorëzon kërkesa formale për informata, ndonëse niveli i

<sup>206</sup> Vetëm në rajonin e policisë së Mitrovicës/Mitrovica, që në atë kohë ka qenë ende nën Komandantin rajonal të Policisë së UNMIK-ut, oficerët serb të policisë kanë vazhduar punën e tyre.

<sup>207</sup> Kjo gjithashtu ka qenë rezultat i vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të nxjerrë në prill 2009 në pritjen që oficerët që nuk janë lajmëruar në punë do të suspendoheshin pa pagesë pas 15 majit, apo kontratat e tyre do të ndërpriteshin pas 30 qershorit.

<sup>208</sup> Neni 9(1)(12) to (17) i kornizës kushtetuese; neni 78 i Kushtetutës.

<sup>209</sup> Sipas neni 9(1)(12) të kornizës kushtetuese, të gjitha komunitetet kanë pasur përfaqësim të barabartë. Neni 78(1) i Kushtetutës parasheh përfaqësimin me 1/3 të serbëve dhe shqiptarëve, ndërsa të gjitha komunitetet tjera duhet ti ndajnë ulëset e mbetura. Megjithatë, prej korrikut 2009, Komiteti ruan përbërjen e mëhershme të tij: dy shqiptarë, dy serbë, dy turq, dy ashkali, dy boshnjakë, një rom, një egjiptian dhe një goran.

<sup>210</sup> Kryesuesi i Komitetit dhe Ministri për Komunitete dhe Kthim i takojnë një partie politike.

<sup>211</sup> Për shembull, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, kanë marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët për përfaqësim të komuniteteve në shërbimin publik më 29 qershor 2009. Më 17 qershor 2009, Ministri për Komunitete dhe Kthim, sipas kërkesës formale, ka marrë pjesë në takimin e Komitetit duke ofruar informata për zhvillimin e bazës së të dhënave për kthimin.

përfaqësimit të ministrive dallon nga rasti në rast.<sup>212</sup> Megjithatë, përgjithësisht nuk ka një punë pasuese konsistente për të siguruar masa ekzekutive konkrete dhe rezultate të politikave.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Progres i caktuar është arritur në aspekt të bashkëpunimit reciprok përmbajtësor ndërmjet Komitetit dhe ministrive, por kjo mbetet edhe më tej një sfidë. Fakti që kryesuesi i Komitetit i takon koalicionit qeveritar në pushtet<sup>213</sup> aktualisht ofron mundësinë për prezantim të procedurave për bashkëpunim përmbajtësor në fazën e hartimit të legjislacionit/politikave dhe në implementimin e tyre. Megjithatë, deri tani Komiteti nuk ka ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për ti bërë sistematike marrëdhëniet me degën ekzekutive. Aktivitetet e Komitetit janë të prekura gjithashtu nga fakti që anëtarët serb përfaqësojnë në mënyrë të pamjaftueshme apo gëzojnë përkrahje të limituar nga komuniteti i tyre për shkak të bojkotit të vazhdueshëm të institucioneve të Kosovës. Komiteti përgjithësisht ndeshet me vështirësi në komunikimin me rajonet me shumicë serbe për shkak të situatës politike. Anëtarët boshnjakë që u takojnë partive rivale,<sup>214</sup> dhe anëtarët e komuniteteve të tjera nuk duken të jenë proaktiv.

## **7.5. Mekanizmat për pjesëmarrje të komunitetit**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 28: shqyrtimi i mënyrave për përmirësim të përfaqësimit dhe efikasitetit të komiteteve të komunitetit në komuna.*

### ***Korniza normative***

Për të mundësuar mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të komuniteteve në nivel komunal, ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale parasheh formimin e komiteteve të komunitetit në të gjitha komunat. Zëvendësit e kryesuesve të kuvendit komunal dhe zëvendësit e kryetarit të komunës për komunitetet duhet të themelohen vetëm në komunat ku komunitet jo-shumicë përbëjnë të paktën 10 për qind të popullsisë së komunës. Që nga viti 2005, janë themeluar këshillat komunale të sigurisë së komunitetit dhe komitetet lokale të sigurisë publike.<sup>215</sup> Mandati i zyrave komunale të komuniteteve dhe i zyrtarëve komunal për kthimin nuk janë rregulluar me ligj apo me legjislacionin sekondar, por në disa raste me statutet e komunës. Grupet punuese komunale për kthimin operojnë në përputhje me Doracakun e ripunuar për kthim të qëndrueshëm.<sup>216</sup> Në nivel qendror, me Kushtetutë parashihet themelimi i Këshillit

<sup>212</sup> Letra zyrtare e korrikut 2007 për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit për kushtet e jetës së egjiptianëve në vendbanimin joformal Kolonia në Gjakovë/Đakovica nuk ka marrë përgjigje. Veç kësaj, në përgjigje ndaj letrës së muajit maj 2009 për Ministrin e Punëve të Brendshme në lidhje me mungesën e implementimit të ligjit për gjuhët (mos përdorimi i gjuhës turke në kartat e identitetit), Ministri e ka arsytuar këtë me mungesën e fondeve.

<sup>213</sup> Kryesuesi i Komitetit, Ministri për Komunitete dhe Kthim, dhe Ministri i Punës e Mirëqenies Sociale, të gjithë vijnë nga Partia e pavarur liberale. Kryesuesi i Komitetit është gjithashtu kryesues i Këshillit Konsultativ për Komunitetet.

<sup>214</sup> Partia Demokratike Vakut dhe grupi parlamentar 7+ në një anë dhe Partia e Veprimit Demokratik (SDA) në tjetrën.

<sup>215</sup> Këshillat komunale të sigurisë së komunitetit dhe në zonat e banuara nga komunitetet numerikisht më të vogla edhe komitetet lokale të sigurisë publike, kanë mandatin për ngritje të besimit ndërmjet policisë dhe komunitetit, të rrisin ndërgjegjësimin në nivel lokal, të identifikojnë shqetësimet lokale lidhur me sigurinë publike dhe të propozojnë plane të veprimit që synojnë adresimin e atyre shqetësimeve. Neni 7, rregullorja e UNMIK-ut 2005/54 për kornizën dhe parimet drejtuese të shërbimit policor të Kosovës, 20 dhjetor 2005; neni 7(2) deri në (5), ligji i zbatueshëm për policinë.

<sup>216</sup> Doracakun e ripunuar i vitit 2006 për kthim të qëndrueshëm, UNMIK-IPVQ, korrik 2006, fq. 13.

Konsultativ për Komunitete<sup>217</sup> (Këshilli Konsultativ), konfirmohet mandati i Komitetit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve,<sup>218</sup> dhe sigurohet përfaqësimi i barabartë i komuniteteve në kuadër të ministrive.<sup>219</sup> Ministria për Komunitete dhe Kthim është themeluar me rregullore të UNMIK-ut,<sup>220</sup> ndërsa Zyra për çështje të komuniteteve është themeluar me një vendim ekzekutiv të Kryeministrit.<sup>221</sup>

### ***Implementimi/Situata në terren***

Në nivel komunal, komitetet e komunitetit përgjithësisht janë të themeluara në mbarë Kosovën; por ndërsa përbërja shumetnike e organit është e siguar gjerësisht,<sup>222</sup> performansa e tij është përgjithësisht e dobët. Pa marrë parasysh prapen shumë kërkues prej 10 për qind, 12 komuna ku jeton një numër më i madh i komuniteteve jo-shumicë kanë emëruar zëvendës kryesuesit e kuvendeve komunale dhe 14 prej tyre kanë emëruar zëvendës kryetarin e komunës për komunitete. Këshillat komunale të sigurisë së komunitetit janë themeluar në 23 nga 33 komuna, ndonëse përfaqësimi i drejtë i të gjitha komuniteteve nuk sigurohet gjithëherë. Ndërsa zëvendës kryetarët e komunave janë efektiv në një masë në përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve,<sup>223</sup> e njëjta nuk mund të thuhet për zëvendës kryetarët e kuvendeve komunale. Përkundër mungesës së dispozitave eksplicite në ligjin e zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale, mekanizmat jo të detyrueshëm (zyrat komunale të komuniteteve, zyrtari komunal për kthim dhe grupi punues komunal për të kthyerit), janë të themeluara mirë në shumicën e komunave dhe sigurojnë pjesëmarrjen e komuniteteve në jetën publike. Megjithatë, jo gjithëherë të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara, dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët janë komunitetet më pak të përfaqësuara.

Në nivel qendror, më 23 dhjetor 2008, janë emëruar anëtarët e Këshillit Konsultativ. Nga mandati dhe përbërja,<sup>224</sup> Këshilli Konsultativ mund të shtojë pjesëmarrjen e komuniteteve dhe konsultimet. Megjithatë, qasja publike në takimet e tij nuk është e siguar<sup>225</sup> dhe emërimet fillestare kanë provokuar kritika sa i përket përfaqësimit të vërtetë të komuniteteve specifike.<sup>226</sup> Pas një kërkesë formale, është emëruar një përfaqësues i malazezve të Kosovës. Me mbështetjen nga Qendra Evropiane për

<sup>217</sup> Dekreti Presidencial Nr. CCC-001-2008, për themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitetet, 15 shtator 2008. Këshilli Konsultativ është trup këshillëdhënës në kuadër të Zyrës së Presidentit.

<sup>218</sup> Shih paragrafin 8.4 të këtij raporti.

<sup>219</sup> Neni 60, 78 dhe 96 i Kushtetutës.

<sup>220</sup> Aneksi XII, rregullorja e UNMIK-ut 2005/15 me të cilën ndryshohet rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 për degën ekzekutive të IPVQ-së në Kosovë, 16 mars 2005. Mandati i saj përfshin zhvillimin dhe promovimin e policisë që mbron të drejtat e komuniteteve, përfshirë këtu të drejtën e kthimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për dialog dhe pajtim ndërmjet komuniteteve.

<sup>221</sup> Zyra e Kryeministrit, Vendimi nr. 030, 15 korrik 2008.

<sup>222</sup> Përfaqësimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nuk është i kënaqshëm, por edhe i malazezëve dhe i kroatëve, ndonëse për shkaqe të tjera.

<sup>223</sup> Për shembull në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të ndihmuar serbët e Kosovës.

<sup>224</sup> Neni 12(6), ligji i zbatueshëm për vetëqeverisjen lokale.

<sup>225</sup> Neni 7.3 i Statutit parashihet që takimet e Këshillit janë publike përveç nëse Këshilli vendos ndryshe. Megjithatë, në praktikë takimet nuk janë të hapura për publikun dhe dispozitat kundërtënëse që janë përfshirë në draftin e rregullave të procedurës së Këshillit përcaktojnë që "takimet e Këshillit dhe të organeve ndihmëse të tij do të jenë të mbyllura përveç nëse Këshilli vendos ndryshe apo nëse shihet nga dispozitat relevante të mandatit që takimi duhet të jetë publik" (Rregulla 32).

<sup>226</sup> Sipas disa përfaqësuesve të komuniteti boshnjak, emërimi i Këshillit konsultativ për komunitete nuk është bërë në mënyrë transparente dhe ka qenë arbitrar. Veç kësaj, përfaqësimi i komuniteteve më të vogla (sikur që janë kroatët) nuk është siguar.

Çështjet e Minoriteteve, Këshilli Konsultativ ka definuar objektivat strategjike dhe operacionale për vitin 2009, dhe është duke zhvilluar rregullat e procedurës dhe ka themeluar grupet punuese për arsimin dhe për njohjen me ligj të komunitetit malazez të Kosovës. Për më tepër, Këshilli Konsultativ ka adresuar fushat specifike të shqetësimeve të komuniteteve.<sup>227</sup> Në prill të vitit 2009, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë emëruar përfaqësuesit e tyre. Në korrik 2008, Kryeministri i Kosovës ka themeluar Zyrën për çështje të komuniteteve.<sup>228</sup> Zyra ka një mandat shumë të gjerë,<sup>229</sup> dhe duhet ngritur kapacitetet e stafit. Me mbështetjen nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Zyra për çështje të komuniteteve ka zhvilluar një hulumtim për të vlerësuar nivelin dhe cilësinë e përfaqësimit të komuniteteve në shërbimin civil. Megjithatë, rezultatet nuk janë publikuar ende. Ministria për Komunitete dhe Kthim po kalon në një fazë të ristrukturimit, që përfshin rishikimin e Doracakut të ripunuar të vitit 2006 për kthim të qëndrueshëm, dhe hartimit e strategjisë ministrore 2009 për komunitetet.<sup>230</sup>

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Në nivel lokal, pragjet ligjore kërkuese për themelimin të mekanizmave të rëndësishëm për pjesëmarrjen e komuniteteve deri më tani janë interpretuar në mënyrë fleksibile dhe do të duhej zvogëluar. Ndonëse korniza ligjore themelon mekanizma të rinj për të siguruar pjesëmarrjen efektive të komuniteteve në vendimmarrje, implementimi i mandateve të tyre është i pamjaftueshëm. Fakti që ekzistenca e mekanizmave të vjetër si zyrat komunale të komuniteteve nuk parashihet më me ligj, vazhdimësinë e tyre e bën të varur nga vullneti politik lokal dhe duhet ndrequr. Kjo mund të zvogëlojë edhe më shumë besimin e komuniteteve në institucionet e Kosovës.<sup>231</sup> Përkundër përpjekjeve të bëra nga disa prej komunave për të siguruar pjesëmarrjen e drejtë e të gjitha komuniteteve, disa komunitete edhe më tej refuzojnë bashkëpunimin dhe angazhimin me institucionet e Kosovës. Në nivel qendror, Këshilli Konsultativ do të mund të ofronte mundësi për pjesëmarrje të shtuar të komuniteteve në jetën publike por duhet të sigurojë përfaqësimin e komuniteteve më të vogla, funksionimin e duhur, transparencën dhe informimin publik lidhur me aktivitetet e tij. Përveç nëse sigurohet harmonizimi dhe koordinimi i aktiviteteve të tyre, shtimi i organeve përfaqësuese të komuniteteve me mandate që mbulojnë njëra tjetrën shteron mundësitë për pjesëmarrje efektive të komuniteteve. Koordinimi, shpërndarja e qartë e përgjegjësiive dhe vendimmarrja transparente janë të nevojshme.

## **7.6. Pjesëmarrja efektive në jetën ekonomike e sociale**

*Këshilli i Evropës, Konventa kornizë, rekomandimi nr. 29: rritja e përpjekjeve për të siguruar që personat të cilët u takojnë të gjitha komuniteteve mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në jetën ekonomike dhe sociale të Kosovës, duke monitoruar mënyrën se si procesi i privatizimit dhe përfundimet e tij ndikojnë në komunitetet pakicë.*

<sup>227</sup> Më 27 prill 2009, pikat e diskutuara të agjendës kanë përfshirë mosnjohjen e diplomave të Universitetit të Prishtinës/Priştina të lëshuara nga viti 1991 deri më 1998; mosveprimin në pajtim me ligjin për përdorim të gjuhëve; rastet e mos implementimit të ligjit të zbatueshëm për të drejtat e komuniteteve; përfshirjen e komunitetit malazez në Kushtetutë; mos pasqyrimi i interesave speciale të komunitetit egjiptian në strategjinë e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

<sup>228</sup> Vendimi i Kryeministrit Nr. 030, 15 korrik 2008.

<sup>229</sup> Shih Zyra e Kryeministrit për çështje të komuniteteve, dokument informues, gusht 2008.

<sup>230</sup> Shih paragrafin 3.1 të këtij raporti.

<sup>231</sup> Kryesisht serbë të Kosovës, dhe në shkallë më të ulët, komuniteti goran, romë, ashkali dhe egjiptian.



### ***Korniza normative***

Në shtator 2008, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)<sup>232</sup> ka marrë përsipër përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).<sup>233</sup> Ajo administron privatizimin e asetëve dhe resurseve ekonomike të ndërmarrjeve shoqërore (NSH-të), duke siguruar pagesat e parashikuara me ligj (20 për qind e të ardhurave nga privatizimi)<sup>234</sup> për punonjësit e mëparshëm dhe të tanishëm. Punonjësit e NSH-ve janë të përshtatshëm për ti marrë këto pagesa nëse “në kohën e privatizimit” është konstatuar “që janë në listën e pagave të NSH-së për jo më pak se tri vite.”<sup>235</sup> Punonjësit mund të ushtrojnë ankesë pranë Odës speciale të Gjykatës Supreme nëse mund të vërtetojnë që: janë përjashtuar nga lista e punëtorëve të NSH-së pa arsye; apo, për shkak të diskriminimit, nuk kanë qenë në gjendje të vazhdojnë punën në NSH për të paktën tri vite.<sup>236</sup>

Përmes UNMIK-ut, Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Vjenës për vendbanimet joformale në Evropën Juglindore.<sup>237</sup> Ashtu si parashihet me kornizën normative, autoritetet qendrore dhe komunale janë të obliguara ti përfshijnë vendbanimet joformale në planet hapësinore përkatëse të tyre për të siguruar rregullimin e tyre.<sup>238</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) aktualisht po harton strategjinë për vendbanimet joformale, për të parandaluar rritjen e numrit të vendbanimeve joformale dhe për rregullimin e atyre ekzistuese.

Më 24 dhjetor 2008 qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkalive dhe egjiptianevë (2009-2015) për të përmirësuar përfshirjen e tyre në shoqërinë e Kosovës, veçmas në fushat e edukimit, punësimit, shëndetësisë, banimit, kthimit, si dhe në qasjen në shërbime dhe pjesëmarrjen në jetën publike.

### ***Implementimi/Situata në terren***

Me vetëm mbi një të pestën e pagesave të aprovuara që nga fillimi i procesit të privatizimit, ka shqetësime që një nivel proporcionalisht i vogël i pagesave janë bërë për ish punëtorët serbë deri më sot.<sup>239</sup> Fakti që vetëm personat në listën e punëtorëve të NSH-ve në kohën e privatizimit kanë të drejtë të marrin pjesën e tyre nga të ardhurat e privatizimit, perceptohet si diskriminuese nga shumë punëtorë prej komuniteteve jo-shumicë, veçmas nga ata që janë të zhvendosur. Këta të fundit

<sup>232</sup> Më 15 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për agjencinë e privatizimit të Kosovës.

<sup>233</sup> AKM është themeluar nën autoritetin e UNMIK-ut, për të administruar ndërmarrjen publike dhe shoqërore (NSH-të) dhe asetet e tyre. Rregullorja e UNMIK-ut 2008/27, me të cilën ndryshohet rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për themelimin të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, 27 maj 2008.

<sup>234</sup> Neni 10, rregullorja e UNMIK-ut 2004/45, për ndryshim të rregullores së UNMIK-ut 2003/13, për transformimin e së drejtës për shfrytëzim të pronës së patundshme shoqërore, 19 nëntor 2004. Rregullorja është implementuar me Udhëzimin Administrativ nr. 2005/12.

<sup>235</sup> Neni 10(4), Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 për transformimin e së drejtës për shfrytëzim të pronës së patundshme shoqërore, 9 maj 2003.

<sup>236</sup> Neni 4(1), Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 për themelimin të Odës speciale të Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me AKM-në, 13 qershor 2002.

<sup>237</sup> Më 17 mars 2005, UNMIK-u ka nënshkruar Deklaratën e Vjenës për vendbanimet joformale në Evropën juglindore.

<sup>238</sup> Më 17 nëntor 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin me të cilin ndryshohet ligji për planifikimin hapësinor i nxjerrë me rregulloren e UNMIK-ut 2003/30, 10 shtator 2003.

<sup>239</sup> Sipas AKP-së, më 12 dhjetor 2008 numrat total të punëtorëve që kanë marrë pjesën prej 20% nga privatizimi janë 10,293, nga të cilët 426 janë serbë të Kosovës.

pretendojnë që nuk kanë qenë në gjendje të lajmërohen në punë për një mori shkaqesh, përfshirë këtu pasigurinë e perceptuar. Pasi që AKP nuk ka zyra jashtë Kosovës, aftësia e punëtorëve të komuniteteve jo-shumicë për të sfiduar përjashtimin nga lista e punëtorëve të përshtatshëm shpesh është e limituar për shkak të zhvendosjes, lirisë së limituar të lëvizjes dhe qasjes joadekuate të informatat relevante elektronike dhe nga mediat.<sup>240</sup> Vonesat e konsiderueshme në pagesën e të ardhurave nga privatizimi i prekin të gjithë punëtorët. Historia e komplikuar e pronave të patundshme që nga viti 1945, e pasuar me privatizimin nga AKM-AKP, ka gjeneruar një ortek ankesash<sup>241</sup> që i janë adresuar Odës speciale të Gjykatës Supreme.<sup>242</sup> Ankuesit janë persona që kanë humbur të drejtat pronësore të siguruara gjatë privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, që është bërë sipas ligjit të vitit 1991 për restitucionin.<sup>243</sup> Ndonëse UNMIK-u nuk ka bërë asnjëherë abrogimin e ligjit të vitit 1991,<sup>244</sup> AKM, pas vitit 1999, shpesh nuk ka marrë parasysh procesin e mëhershëm të privatizimit dhe ka ecur me privatizimin e po të njëjtave asete.

Romët, ashkallitë dhe egjiptianët shpesh jetojnë në vendbanime joformale margjinale, pa qasje në infrastrukturë adekuate, energji elektrike, ujë të pastër, kanalizim, dhe shërbime të largimit të mbeturinave. Mungesa e licencave urbane apo të ndërrimit dhe e titujve të nevojshëm të pronës, apo transaksionet e paregjistruara dhe/apo zaptimi i tokës,<sup>245</sup> i privojnë shpesh banorët e këtyre lagjeve nga siguria e zotërimit të atyre pronave. Në disa raste, banorët romë, ashkali dhe egjiptianë të vendbanimeve joformale u nënshtrohen rreziqeve për shëndetin sikur që është ndotja, banesat me struktura të paqëndrueshme dhe faktorët tjerë negativ të ambientit.<sup>246</sup> Deri më sot vetëm disa prej komunave kanë bërë identifikimin e vendbanimeve joformale në planet e tyre zhvillimore komunale apo kanë nisur procesin e rregullimit.<sup>247</sup> Në vend të kësaj, strategjitë komunale kryesisht synojnë frenimin e rritjes së vendbanimeve

<sup>240</sup> Neni 64, Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut 2006/17, 6 dhjetor 2006. AKP fillimisht duhet të publikojë listën e përkohshme të punëtorëve që kanë të drejtë në kompensim. Ankesat në lidhje me listën duhet të dorëzohen në AKP brenda 20 ditësh dhe i nënshtrohen kërkesës për prova apo dëgjime për provat. Vetëm pas përshtatjes dhe publikimit të listës finale, ankesat mund të dorëzohen në Odën speciale të Gjykatës Supreme.

<sup>241</sup> Raporti për 'Shqyrtimin gjyqësor të çështje të AKM-së nga oda speciale e Gjykatës Supreme të Kosovës,' Misioni i OSBE-së në Kosovë, maj 2008.

<sup>242</sup> Neni 1, Udhëzimi Administrativ 2005/7 për implementim të rregullores së UNMIK-ut 2002/13 për themelimin e odës speciale të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, 2 qershor 2005.

<sup>243</sup> Ligji për metodën dhe kushtet e njohjes së të drejtave dhe për kthim të tokës të shndërruar në pronësi shoqërore, për qëllimet e fondit të tokës bujqësore dhe të tokës së konfiskuar për shkak të dështimit në plotësimin e obligimeve në lidhje me blerjen e detyrueshme të produkteve bujqësore, Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 18/90, 27 mars 1991.

<sup>244</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 1999/10 për anulim të legjislacionit diskriminues që prekë banimin dhe të drejtat mbi pronën, 13 tetor 1999, në mënyrë eksplicite ka anuluar ligjin për ndryshimet dhe plotësimet në limitimin e transaksioneve në pronat e patundshme, gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 22/91, 18 prill 1991; dhe ligji për kushtet, mënyrat dhe procedurat e dhënies së tokës bujqësore për qytetarët që duan të jetojnë dhe punojnë në territorin e Krahinës autonome të Kosovës e Metohisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 43/91, 20 korrik 1991.

<sup>245</sup> MMPH ka organizuar konferenca dhe punëtori në komunat e ndryshme, në bashkëpunim me OSBE-në dhe UN Habitat, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të banorëve të vendbanimeve joformale.

<sup>246</sup> Vendbanimi Kolonia në Gjakovë/Đakovica, i banuar nga egjiptianët, është i vendosur afër deponisë së mbeturinave të qytetit.

<sup>247</sup> MMPH aprovon planet zhvillimore të komunës dhe siguron që komunat do të përfshijnë vendbanimet joformale në këto plane

joformale ekzistuese përmes planeve rregullatore urbane<sup>248</sup> dhe sistemimit të banorëve në banesat kolektive apo sociale. Fakti që shumë vendbanime joformale okupojnë toka në pronësi shoqërore, vonon apo pengon procesin e rregullimit. Iniciativa e komunës së Istogut/Istok për të mundësuar kthimin e egjiptianëve të zhvendosur dhe për të rregulluar vendbanimin joformal të shkatërruar të Rudeshit/Rudeš<sup>249</sup> përmes shkëmbimit të tokave, është pezulluar në qershor 2008.<sup>250</sup> Vetëm në qershor 2009 personave të zhvendosur u është ofruar alternative e sistemimit në një program të banimit social në Serbobran/Srbobran (Istog/Istok).<sup>251</sup> Rasti i vendbanimit joformal Kristali<sup>252</sup> në Pejë/Peć ilustron më tej barrierat institucionale dhe sociale me të cilat ndeshen komunitetet jo-shumicë në ushtrimin e së drejtës së tyre për tu kthyer në vendin e origjinës.

Ndonëse përfaqësuesit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptiant kanë marrë pjesë në hartimin e strategjisë së integritimit, disa nga rekomandimet e tyre nuk janë përfshirë në dokumentin final. Me përjashtim të disa iniciativave nga Ministria e Arsimit dhe Teknologjisë, qeveria e Kosovës nuk ka finalizuar planet e veprimit dhe nuk ka ndarë buxhet për implementim të strategjisë. Komunitetet pranuese nuk janë konsultuar në këtë drejtim.

### ***Vlerësim i gjithmbarshëm***

Proceset e vazhdueshme të privatizimit nuk sigurojnë transparencë të mjaftueshme, komunikim dhe mundësi të barabarta për sigurim e të ardhurave për të gjithë ish punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, veçmas për punëtorët jo-shumicë dhe për ata të zhvendosur. Sfidat potenciale rreth pronësisë në lidhje me procesin e privatizimit mund të priten, veçmas nga përfituesit serb të Kosovës nga procesi i privatizimit i viteve 1989-1999. Kur trajtohen vendbanimet joformale dhe lokacionet e kthimit<sup>253</sup> të vendosura në tokën në pronësi shoqërore, privatizimi i NSH-ve duhet të akomodojë gjithashtu nevojën për të siguruar rregullimin e vendbanimeve joformale, sigurinë e zotërimit dhe kushtet më të mira të jetesës për banorët e tyre.<sup>254</sup>

---

<sup>248</sup> Planet rregullative urbane nuk kërkojnë aprovimin nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

<sup>249</sup> Në vitin 2005, komuna ka iniciuar një projekt të kthimit për 70 familje të zhvendosura egjiptiane nga Rudeshi/Rudeš, vendbanimi i të cilëve ishte shkatërruar tërësisht si pasojë e konfliktit.

<sup>250</sup> PSSP nuk ka aprovuar shkëmbimin e tokës ndërmjet komunës dhe AKM-së sepse në qershor 2008 vendbanimi Rudesh/Rudeš ishte përfshirë në zonën speciale të mbrojtur për Manastirin e Goriqit/Gorioć (Istog/Istok). Më pas, komuna ka ndërtuar varrezat e komunës në një pjesë të vendbanimit.

<sup>251</sup> Programi 'Kthimi dhe ri integrimi në Kosovë' i financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe e implementuar nga UNDP.

<sup>252</sup> Vendbanimi joformal Kristali, i banuar nga mbi 100 familje rome dhe egjiptiane që nga vitin 1940, ishte shkatërruar si pasojë e konfliktit të vitit 1999. Më vonë në vitin 1999, mbeturinat ishin pastruar nga komuna. Në vitin 2001 komuna e kishte përcaktuar atë si zone industriale dhe kishte penguar ndërtimin e banesave. Njëkohësisht, komuna kishte toleruar ndërtimet e paligjshme në po atë zonë. Në vitin 2003, Kristali ishte ri-klasifikuar si zonë e banimit dhe banorët e mëparshëm kishin bërë përpjekje të reja për rindërtimin e shtëpive të tyre; megjithatë, secila punë e ndërtimit e bërë gjatë ditës, ishte rrënuar gjatë natës nga persona të panjohur. Deri më tani nuk ka ndodhur asnjë kthim në lokacionin Kristali.

<sup>253</sup> Imperativi ekonomik i regjimit të privatizimit nuk duhet të mbizotërojë mbi obligimet e autoriteteve publike për të siguruar të drejtën e kthimit në vendin e origjinës (psh., Kristali në Pejë/Peć, Rudesh/Rudeš në Istog/Istok).

<sup>254</sup> Sikur që është Kolonia në Gjakovë/Đakovica dhe lagja e romëve në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica.

Ekziston nevoja e ngutshme për vlerësimin e të gjitha vendbanimeve joformale dhe për zhvillim të strategjisë për rregullimin e tyre. Vetëm në një numër shembujsh planet komunale zhvillimore kanë siguruar rregullimin.<sup>255</sup> Mungesa e pjesëmarrjes efektive të komuniteteve të prekura në procesin e rregullit është veçmas shqetësuese. Një nga pasojat është që shpesh institucionet u ofrojnë banorëve të vendbanimeve joformale risistemim në blloqet e banimit social si zgjidhje e vetme. Shpesh, komunat nuk identifikojnë dhe nuk i inkorporojnë vendbanimet joformale të shkatërruara dhe të braktisura në planet zhvillimore komunale, duke penguar kështu kthimin potencial të komuniteteve jo-shumicë, veçmas të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Strategjia për integrimin e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian nuk është buxhetuar dhe implementuar.

## 8. KONKLUZIONET

Institucionet e Kosovës kanë miratuar legjislacion gjithëpërfshirës dhe politika për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve. Megjithatë, implementimi i tyre ka mbetur pas. Krijimi i një shoqërie stabile, demokratike dhe shumetnike kërkon përkushtim të shtuar institucional dhe pjesëmarrje reale e të gjitha komuniteteve. Progresi i mëtejshëm është i nevojshëm për të implementuar rekomandimet e Këshillit të Evropës në lidhje me Konventën Kornizë.

Emërimi i Ombudspersonit vendor është arritur pas disa viteve dhe mund të mbështesë besimin e përtërirë në këtë institucion. Mungesa e qasjes së koordinuar nga policia dhe gjyqësori, mungesa e bazës së shënimeve lidhur me klasifikimin hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve ndër-etnike dhe problemet praktike në lidhje me funksionimin e gjykatave në pjesën veriore të Kosovës, përçojnë ndjenjën e vazhdueshme të mosndëshkimit për krimet që si çak i kanë komunitetet.

Përkundër përpjekjeve të shtuara për krijim të kushteve për kthim të qëndrueshëm, institucionet e Kosovës edhe më tej ndeshen me sfida në lidhje me kthimin e pronës, rregullimin e vendbanimeve joformale, dhe për të siguruar risistemimin e personave të zhvendosur në vende të tjera nga vendi i origjinës. Masat e përshtatshme dhe financimi nuk janë siguruar për të akomoduar nevojat e një numri në rritje të personave të riatdhesuar. Komunikimet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe komunave pranuese nuk janë në nivel të duhur. Ka shqetësime të veçanta për situatën e romëve të zhvendosur në kampet e kontaminuara me plumb në veri të Kosovës, për të cilët, përkundër zotimeve të fundit, nuk janë siguruar zgjidhje të qëndrueshme në dhjetë vitet e shkuara.

Zonat speciale të mbrojtura janë themeluar për të siguruar trashëgiminë kulturore të komuniteteve. Megjithatë, masat mbrojtëse konkrete janë në rrezik në rastet specifike, dhe institucionet vendore nuk kanë zhvilluar një listë gjithëpërfshirëse të lokacioneve të trashëgimisë kulturore. Mbrojtja e kulturave të komuniteteve më të vogla bazohet kryesisht në përkrahjen financiare për iniciativat kulturore, por një komunikim proaktiv dhe promovimi i kulturave në pozitë më të pafavorshme nuk është

<sup>255</sup> Me përjashtim të diskutimit të tanishëm për rregullimin e vendbanimit Kolonia, disa nga shembujt, sikur që është alokimi i tokës komunale në lagjen rome në Mitrovicë/Mitrovica, apo projekti i kthimit/risistemimit i implementuar në kuadër të kthimit dhe ri integrimin në Kosovë në lokacionin Serbobran/Srbobran, janë të lidhura me projektet e kthimit.

parashikuar. Papajtueshmëritë vazhdojnë lidhur me ofrimin e disa shërbimeve të transmetuesit publik për komunitetet jo-shumicë.

Legjislacioni gjuhësor gjithëpërfshirës ekziston por implementimi i tij është i prekur nga alokimi i resurseve joadekuate, mungesa e informimit publik dhe monitorimi i pamjaftueshëm. Kapacitetet e përkthimit dhe interpretimit kanë shënuar rënie në një shkallë shqetësuese dhe mungesa e edukimit në të dy gjuhët zyrtare e vë në rrezik ekzistencën në të ardhmen të shërbimit civil dygjuhësor. Ndonëse incidentet kanë shënuar rënie, një qasje më proaktive është e nevojshme për të promovuar tolerancën dhe përdorimin e gjuhëve jo-shumicë veçmas në zonat një-etnike.

Nxënësit shqiptarë dhe serbë vazhdojnë të vijojnë mësimin në shkolla dhe sisteme arsimore të ndara, dhe nuk janë ndërmarrë masa konkrete për të promovuar kontaktet ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve nga sistemet me plane mësimore kosovare dhe serbe. Mungesa e masave për të siguruar të mësuarit e të dy gjuhëve zyrtare ushqen ndjenjën e ndarjes në rritje ndërmjet dy komuniteteve më të mëdha. Hapat e ndërmarrë për të promovuar edukimin në gjuhët e komuniteteve dhe për të siguruar ruajtjen edukative të kulturave të komuniteteve të tjera jo-shumicë duhet të intensifikohen.

Janë bërë përpjekje pozitive për të siguruar përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike dhe në mekanizmat qendror e komunal për pjesëmarrje të komuniteteve. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejme për të mundësuar koordinimin efektiv dhe funksionimin e këtyre mekanizmave, dhe për të rritur barazinë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve në pozitat e larta.

## **9. REKOMANDIMET**

Marrë parasysh këto që u thanë më lartë, OSBE këshillon institucionet e Kosovës që ti marrin parasysh këto rekomandime.

### **Mjetet ndreqëse dhe zbatimi i ligjit**

Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, policia dhe gjykatat e Kosovës:

- Të themelojnë një sistem permanent për mbledhjen e të dhënave për hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve dhe krimeve me motive etnike;
- Të rritet besimi i të gjitha komuniteteve në gjyqësorin përmes hetimit dhe ndjekjes penale efektive të incidenteve dhe krimeve me motive etnike.

### **Procesi i kthimit dhe siguria**

Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, komunat e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Pronës:

- Të heqin pengesat ndaj kthimit të qëndrueshëm dhe të adresojnë shqetësimet rreth sigurisë, pronës dhe arsimit të të kthyerve potencial, përmes masave konkrete;
- Të sigurojnë kthimin e qëndrueshëm të shpejtë apo ri sistemimin e të gjithë romëve të zhvendosur në kampet e kontaminuara me plumb në pjesën veriore të Kosovës dhe të sigurojnë trajtimin shëndetësor adekuat;

- Të implementojnë strategjinë për ri-integrim të personave të riatdhesuar përmes financimit adekuat, koordinimit ndërinstucional dhe shërbimeve të planifikuara.

#### **Çështjet e kulturës dhe medias**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Transportit dhe Komunikacionit, Instituti i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve dhe Këshilli i Kosovës për trashëgiminë kulturore:

- Të kompletojnë listën gjithëpërfshirëse të objekteve të trashëgimisë kulturore e religjioze, të themelojnë mekanizma për ruajtjen e zonave të mbrojtura, dhe të shtojnë ndërgjegjësimin për trashëgiminë kulturore dhe të promovojnë tolerancën ndëretnike dhe religjioze;
- Të mundësojnë qasje të barabartë të komuniteteve jo-shumicë në shërbimet e transmetuesit publik në gjuhët dhe kulturat e tyre, në përputhje me ligjin.

#### **Përdorimi i gjuhëve**

Zyra e Kryeministrit, Komisioni për gjuhët, Ministria e Punëve të Brendshme dhe komunat e Kosovës:

- Të sigurojnë resurse adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar implementimin e legjislacionit për përdorimin e gjuhëve, qasjen e barabartë në shërbimet publike shumë-gjuhësore dhe pjesëmarrjen efektive nga përdoruesit e gjuhëve jo-shumicë;
- Ti japin mundësinë Komisionit për gjuhët që të bëhet një mekanizëm efektiv i monitorimit dhe zhvillimit të politikave;
- Të dënojnë incidentet dhe të promovojnë përdorimin e gjuhëve jo-shumicë në vendet publike nëpër Kosovë, veçmas në rajonet një-etnike.

#### **Arsimi**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Zyra e Kryeministrit, Zyra për qeverisje të mirë, Ministria për Komunitete dhe Kthim, dhe Ministria për Ekonomi e Financa:

- Të hartojnë plane mësimore dhe të sigurojnë tekste shkollore për të siguruar qasjen në edukim në të gjitha gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve të tjera, dhe të përmirësojnë mundësitë për trajnime të diplomës për mësuesit në gjuhët e komuniteteve;
- Të ofrojnë mundësi për edukim në të dy gjuhët zyrtare për të gjithë dhe të promovojnë heqjen e barrierave linguistike dhe fizike që shkaktojnë ndarjen e fëmijëve që u takojnë komuniteteve të ndryshme;
- Të sigurojnë integrimin edukativ të fëmijëve të komunitet rom, ashkali dhe egjiptian përmes resurseve adekuate dhe masave të planifikuara;
- Të përcaktojnë si prioritet qasjen e plotë në edukim në gjuhën zyrtare të zgjedhur dhe integrimin në shkollat me më shumë plane mësimore për fëmijët goranë.

#### **Pjesëmarrja në jetën publike**

Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Ministria për Komunitete dhe Kthim, dhe Komunat e Kosovës:

- Ndjekja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të shtuar të komuniteteve jo shqiptare në shërbimin civil dhe në procesin e vendimmarrjes, duke respektuar të drejtën e

vetë-identifikimit si dhe mbrojtjen të dhënave personale të ndjeshme në lidhje me përkatësinë e tyre etnike;

- Ndërmarrja a masave konkrete dhe alokimi i resurseve për të promovuar përfshirjen e komuniteteve jo shqiptare në jetën ekonomike dhe publike, duke siguruar qasjen e barabartë në procesin e privatizimit, rregullimin e vendbanimeve joformale dhe implementimin kredibil të strategjisë për integrim të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

ANEKSI 1. Përbërja etnike e Kosovës



Legjenda: Kjo hartë nuk është dokument zyrtar dhe ofrohet vetëm për referencë.